

Rrëfimet më të mira

- 2 -



AMËR ISTREFI

Redaktor gjuhësor

Elhaid Alija

Faqosja

Bledar Xama

Kontakt

+355 67 54 94 055

*Merjemes, Jahjas,
Ejubit, Is'hakut, Ismailit
dhe jo veç...*



Parathënie

Falënderimet janë për Allahun, Dhuruesin e çdo mirësie, të Madhërishmin, pa kurrëfarë të mete apo mangësie. Lavdia i qoftë Zotit që adhurohet me shpresë edhe drojë, Atij që mbarë krijesat i drejtohen për çdo nevojë. Lartësia i takon të Vetmit, pa ortak dhe pa rivalë, Atij që s'ka prind, as bashkëshorte apo djalë, Krijuesi nuk ka të ngjashëm dhe s'i përngjet asgjë, në qiej as në Tokë nuk ka të barabartë me Të. Salavatet e selamet qofshin mbi zotërinë e njerëzimit, mbi sahabet e pasuesit e tyre deri në Ditë të Gjykimit!

Në një transmetim të vërtetë na përcillet se Pejgamberi Muhamed, bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, ka thënë: *"Kush nuk falenderon robin, nuk e falenderon as Zotin."* Në përputhje me porosinë pejgamberike dëshiroj të falenderoj mësuesin fjalëpak, urtakun, i cili nuk pati dëshirë t'ia përmend emrin. Ky burrë i nderuar i qytetit tonë pasi lexoi librin "rrëfimet më të mira" ku hidhej dritë mbi historitë e Pejgamberëve, më dha kurajo e më nxiti të hidhja në letër historitë e mbetura të Kur'anit Famëmadh. I jam mirënjohës hoxhës tim shumë të nderuar që pati durimin ta shfletonte dorëshkrimin dhe të më këshillonte. I jam borxhli edhe mikut tim bujar që nuk kurseu asgjë për botimin e dy vëllimeve.

Kështu pra, iu përvësua punës. Ditë për ditë, pak e nga pak, sikurse bleta që fluturon nga lulja në lule në kërkim të nektarit, kalova nga surja në sure që t'i mbledh këto histori të bekuara.

Ama, populli thotë se nuk mund ta mbledhësh detin në shishe. Po ashtu historitë e Kur'anit dhe sidomos dobitë që përfitohen prej tyre janë pafund e s'mund të përmbliiden në dy vëllime, prandaj, megjithë përpjekjen time modeste, ka shumë për t'u thënë e për t'u shkruar.

Lexues fisnik, vlerat njerëzore si bujaria, çiltërsia, trimëria, besnikëria, nderi, sjellja e mirë me prindin, kujdesi për familjen, përkrahja e nevojtarit e të tjera të ngjashme me to, janë të pajtjetërsueshme sado të kalojnë motet e të zhvillohet teknologjia, sepse burojnë nga fjalët e Allahut që nuk ndryshojnë.

Të gjitha këto vlera i përmban lumi i moralit të mirë, uji i bekuar i të cilit i fal jetë filizave të shoqërisë njerëzore. Nëse filizi ujitet me ujë të pastër e të kulluar, forcohet kërcelli i tij, drejtohet, rritet e lëshon shtat duke u shndërruar në trung të qëndrueshëm, të cilin, me ndihmën e të Madhit Zot, nuk e rrëzon dot stuhia e dëshirave të këqija dhe as tufani i paturpësive. Ngjashëm me bimën, nëse fëmijët dhe rinia do të rrisin shtatin me historitë e Kur'anit Fisnik dhe tregimet e Profetit besnik do bëhen besimtarë të palëkundur, drita udhëzimi dhe burime mirësie për shoqërinë që i rrethon.

Kushdo që mediton mbi këto histori i bëhet e qartë se përfundimi i lavdishëm do të jetë gjithmonë për besimtarët, për punëmirët, për njerëzit e dëlirë dhe sado që të ngrihet lart e t'i thuren lavde të pavërtetës, do të zbardhë herët a vonë agimi që do ta zhdukë errësirën.

Lexues fisnik, në librin që po shfleton, rrëfimeve Kur'anore të papërmendura në librin e parë mendova t'ja bashkangjis tregimet kuptimplota të Profetit, alejhis-salam, meqë burimin e

kishin të përbashkët. Kështu, nga tregimi “Haruti dhe Maruti” e deri tek “Elefanti” kam renditur rrëfimet Kur’anore sipas renditjes së sureve, ndërsa nga tregimi “Tre shokët” e deri tek “Pendimi” kam vendosur rrëfimet që përcillen nga Profeti Muhamed, alejhis-selam. Në fakt, tregimi “Shpirti” dhe “Gjykimi” nuk konsiderohen prej historive të Kur’anit, por për shkak të njohurive të fshehta dhe dobive që përmbanin vendosa t’i përmend. Kështu ajetet e sures “Fussilet” i gërshetova me hadithin e Bera’së, ndërsa ajetet e sures “El Hak-kah” me hadithin e Abdullah ibn Amër, Allahu qoftë i kënaqur me të dy.

Për të shpjeguar historitë kuranore jam mbështetur tek tefsiri i alimit të madh, Ibn Kethirit, tefsiri i Abdurrahman es-Sa’dit, dhe shpesh herë tek ligjërimet e Abdullah Shinkitit. Ndërsa për historitë pofetike jam mbështetur tek libri “Ngjarjet e popujve të hershëm” nga Mesh’hur Hasen, tek libri “Histori të bukura” nga Abdullah Nabolli dhe rrallëherë edhe nga librat e siras si, “Jeta fisnike e të dërguarit”, etj.

Në komentin e disa prej historive të Kur’anit jam mbështetur në israiliate, të përmendura nga Ibn Kethiri dhe mufesirinë të tjerë, Allahu i mëshiroftë të gjithë. Hollësitat në lidhje me lajmet e përfuara përmes israiliateve i kam cekur të përmbledhura në parathënien e volumit të parë, ndaj nuk e pashë të arsyeshme t’i përmend përsëri.

Lexues fisnik! Gjithsa ja kam qëlluar të vërtetës është mirësi nga Allahu i Lartësuar, e kudo ku mund të kem gabuar është dobësi nga unë. Ndaj shpresoj mirëkuptimin tënd për dobësitë e mia dhe një dua të çiltër për përpjekjen modeste!

Haruti dhe Maruti

Biri im! Siç të kam treguar, babai i njerëzisë, Ademi, alejhis-selam, ishte besimdrejtë, musliman. I adhuruari i tij ishte Allahu dhe feja e tij Islami. Njerëzit asokohe ishin të çiltër, të drejtë dhe shpirtmirë. Ata adhuronin Zotin e Vetëm e të Pashoq. Mirëpo pas disa brezash, nxitur nga Iblisi dhe shpura e tij, u shfaq e keqja, idhujtaria, shtrembërimi i fesë dhe shpirtligësia. Atëbotë u përhap magjia, magjistarët dhe magjistricat.

Thuhet se ndër popujt më të hershëm që ushtruan magjinë ishin babilonasit. Shumë kohë para nesh, sot e kushedi sa mot më parë, Lartmadhëria e Tij urdhëroi dy melekë, Harutin dhe Marutin të zbrisnin në Babiloni. Me të zbritur, u dha melekëve pamje njerëzore që të mos i njihte kush. Ata të dy kishin për detyrë t'ua shpalosnin vendasve marifetet e magjisë dhe t'ua tërhiqnin vërejtjen për dëmet e saj me qëllimin e mirë që njerëzit ta njihnin të keqen e kështu t'i largoheshin. Kështu u përzien me babilonasit dhe u bënë të njohur në mesin e popullit. Ama, sa herë që dikush u trokiste në derë për t'i mësuar hilet e magjisë, ata e paralajmëronin dhe e këshillonin duke i thënë: *"Mos u mashtro, o njeri! Ruaju magjisë, se ta helmon zemrën dhe ta largon imanin!"*

Mirëpo ç'ndodhi? Babilonasit mirë që nuk zunë mend, por e përvetësuan magjinë dhe e trashëguan brez pas brezi. Prej tyre e mësuuan magjinë egjiptianët e lashtë. Më pas indianët, grekët e kështu e keqja mori dheun. U përhapën librat e magjisë, hajmalitë me vija, me numra, me shkrime dhe simbole të

mistershme anembanë. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhërishëm nuk la popull pa u dërguar Pejgamber që t'i urdhëronte të adhuronin vetëm Allahun, të braktisnin adhurimin e çdo gjëje veç Tij, qoftë statujë, xhind apo njeri, t'i largoheshin magjisë dhe të përudheshin në rrugën e mirësive...

Megjithëse të gjithë librat qiellorë e dënonin magjinë, me kalimin e moteve, benu israilët i shtrembëruan mësimet e fesë së tyre, e mësuuan, e ushtruan dhe e përhapën magjinë kudo. Madje, në mënyrë që të fitonin besimin e popullit, hapën fjalë se edhe Sulejmani, alejhis-selam, na kishte qenë magjistar... se pushetin mbi xhindët nuk e arriti veçse nëpërmjet magjisë. Madje edhe sot mundohen t'i veshin magjisë dhe magjistarëve petkun e mirësisë, e urtësisë dhe të mençurisë. Sikur të pyesësh librashitësit se sa libra fetarë, shkencorë apo letrarë blihen dita-ditës në krahasim me librat që flasin për magjinë, magjistarët dhe për demonët, do të befasonesh... Kushedi se sa e sa filma, sa e sa emisione, sa e sa videogejm përplot me marifete magjish, me magjistarë dhe magjistrica përhapen dita-ditës që t'u hijeshohet njerëzisë e liga. Magji e bardhë, magjistar fisnik, mjekërhirtë dhe i urtë, shtrigë bujare, e shumë të tjera... si e si t'u zbukurohet bijëve të Ademit e keqja.

Prandaj të porosis, o bir! Mos u mashtro me fjalët e botës! Së pari, nuk i takonte Sulejmanit, alejhis-selam, dhe asnjë Pejgamberi të mësojë apo të ushtrojë magjinë. Larg nga kjo shpifje dhe të pafajshëm nga kjo gënjeshtëri janë të Dërguarit e Allahut. Së dyti, nuk ka magji të bardhë dhe magjistar mirëbërës. Magjia ka qenë dhe do të jetë kurdoherë e zezë dhe e ligë. E si të jetë ndryshe kur ajo nuk realizohet veçse në bashkpunim me Iblisin, me armikun e përбетuar të njerëzisë dhe burimin e çdo ligësie.

A e di ti se kush janë magjistarët, o bir? A e di se ç'është magjia dhe si realizohet ajo?

Allahu i Lartmadhërishëm me urtësinë e Tij, krijoi të mirën dhe të keqen; dritën dhe errësirën; Xhenetin dhe Xhehenemin; ujin dhe zjarrin; kënaqësinë dhe dhimbjen; jetën dhe vdekjen; shëndetin dhe sëmundjen... Sikur të mos kish të keqe nuk do vlerësohej e mira; sikur të mos kish vdekje, nuk do të kish rëndësi jeta; sikur të mos ishte sëmundja, s'do t'i dihej kimeti shëndetit e kështu me radhë. Me fuqinë e Tij dhe me urtësi madhore Allahu i Lartësuar ka krijuar krijesa që punojnë vetëm mirësi, e këta janë melekët, nga ana tjetër ka krijuar krijesa që punojnë vetëm keq, e këta janë shejtanët. Ndërmjet tyre janë njerëzit; nëse janë mirëpunues, fitojnë nder e lavde porsia melekët, por nëse i jepen të ligave, meritojnë mallkimin sikur të ishin shejtanë. Ta dish pra, se ndër njerëzit më të ligj në fytyrën e tokës janë magjistarët. Nëse sheh thellë në sytë e tyre do vësh dinakëri. Errësira ua mbulon fytyrat. Ata janë shëmbëllyra e përçudnimit, e së keqes dhe e shpirtligësisë. Ata janë të gatshëm të bëjnë krime, të zhyten në gjynahe dhe paturpësi. Magjistarët zhvishen nga morali i mirë dhe virtytet e larta. Ata bëhen armiq të fesë dhe librave qiellorë; hyjnizojnë dhe adhurojnë shejtanët, yjet, planetet, idhujt ose njerëzit e ligj; murmurisin fjalë të pakuptueshme, lidhin nyja, shkruajnë nuska dhe hajmali ku vendosin simbole yjesh, shumëkëndësja, shkronja, numra, vija dhe shprehje me anë të të cilave kërkojnë ndihmën e xhindëve shejtanë.

Me të drejtë ti mund të pyesësh: pse u binden xhindët magjistarëve? Dëgjo, o bir! Nuk zë fill ligësia e magjisë veçse përmes xhindëve. Ama, xhindët nuk u shërbejnë magjistarëve vetëm nëse këta të fundit i madhërojnë dhe i hyjnizojnë. Xhindët e ligj i shtyjnë magjistarët në humnerat e shirkut me qëllim që në Ahiret të bëhen banorë të Xhehenemit e kurrë mos të dalin prej tij. A nuk na ka lajmëruar Allahu i Lartësuar në Kur'an se Ai nuk e fal kurrsesi shirkun dhe përveç tij fal çfarë të dojë?! Nëse magjistari nuk i adhuron, ata nuk i shër-

bejnë. Kështu magjistarët për të kënaqur shejtanët dhe për të plotësuar dëshirat e tyre të liga bëjnë idhujtari dhe gjithfarëlloj fëlliqësirash: madhërojnë Iblisin, u luten idhujve, therin kurbane për nder të tij ose për nder të idhujve, ushqehen me papastërti dhe veprojnë lloj-lloj gjynahesh. Kështu shejtanët bëhen ortakë të magjistarëve në gjynahe dhe magjistarët bashkudhëtarë të shejtanëve drejt zjarrit të Xhehenemit. Me dëshirën e magjistarit shejtanët ndikojnë në imagjinatën e njerëzve duke magjepsur sytë e tyre. E tillë ishte edhe magjia që bënë magjistarët në praninë e Musait, alejhis-selam, nëse të kujtohet. Ata përmes magjisë mund të ndikojnë edhe në imagjinatën e një bashkëshorti, ose t'ia magjepsin sytë, në mënyrë që bashkëshortja t'i duket e shëmtuar, e ligë dhe dashakeqe, e kështu të ndahet prej saj dhe të shpëputen lidhjet familjare. Pikërisht kjo është magjia për të cilën i patën tërhequr vërejtjen njerëzisë Haruti dhe Maruti.

Për këtë arsye, Profeti Muhamed, alejhis-selam, na ka lajmëruar se shirku bashkë me magjinë janë prej gjynaheve shkatërruese, që t'u rrimë larg dhe t'u ruhemi siç i ruhemi gjarprit. Madje ai, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin kurdoherë mbi të, na ka mësuar se: *"Kushdo që shkon te një fallxhor dhe i beson asaj që thotë, e ka mohuar atë që i është shpallur Muhamedit."*

Besimdrejti nuk i druhet as magjisë dhe as magjistarëve. Ai është i bindur se nuk ndodh asgjë në qiej dhe as në Tokë pa lejen e Allahut, prandaj e përforcon lidhjen me të Madhin Zot. E adhuron Allahun me çiltërsi dhe i lutet ta mbrojë nga çdo e keqe, mbasi nuk zë fill magjia veç nëse do Zoti. E nëse e prek belaja, qëndron i palëkundur si malet me shpresë se Allahu do t'ia largojë të keqen, do ta shpërblejë për sabrin gjatë sëmundjes dhe për falënderimin pas shërimit prej saj. Kështu i fisnikrohet shpirti në jetën e dynjasë dhe i rritet nami në jetën e jetëve.

Ringjallja

Biri im! Pas vdekjes së Jusha bin Nunit, çlirimtarit të Pa-
lestinës, i pari i benu israilëve u vendos Kalib bin Jofni, shoku
i tij i ngushtë, trimi që e nxiti popullin një kohë e një mot të
luftonte për çlirimin e Tokës së Shenjtë. Historia tregon se pas
Kalibit udhëheqjen e pasardhësve të Jakubit e mori Hezekieli.
Ky burrë njihet si Pejgamberi që e luti Allahun t'i ringjallte
banorët e krahinës Davurdan. A ke dëgjuar ndonjëherë për
popullin e kësaj toke të largët?

Thuhet se një mot kur në Davurdan ra murtaja, shumica
e banorëve u larguan nga qyteti. Pjesa më e madhe e atyre
që qëndruan u prekën nga sëmundja dhe ndërruan jetë... Pasi
kaloi murtaja, ata që kishin ikur u kthyen përsëri në vend-
lindje. Vendasit që i pritën i njohën: *"Këta janë treguar më
të mençur se të afërmit tanë,"* menduan. *"Sikur edhe ata të
largoheshin nga qyteti, sot do të ishin gjallë në mesin tonë.
Gjithsesi, nëse edhe një herë bie murtaja mbi qytet, edhe ne
do të largohemi."*

Për një urtësi madhore i Lartmadhërishmi e goditi edhe
një herë krahinën me sëmundjen e rëndë. Sapo filloi të për-
hapej murtaja, banorët e Davurdanit u larguan me të shpejtë
nga qyteti dhe u vendosën në një luginë të gjerë dhe pjellore.
Kur menduan se janë të sigurt nga rreziku, mjaftoi një fjalë e
Sunduesit Fuqiplotë *"Vaisni!"* dhe ndërruan jetë të gjithë sa hap
e mbyll sytë... Veç i Madhi Zot e di sa kohë qëndruan trupat
e vdekur në mesin e luginës.

Pas shumë kohësh andejpari kaloi Hezekieli, i Dërguari i Allahut tek beni israilët. Kur pa mijëra trupa pajetë që mbulonin luginën, u trondit. U ndal afër tyre dhe u krodh në mendime. Tek shihte përreth me habi, papritmas dëgjoi një zë.

– *A do të dëshiroje të shihje se si i ngjall Allahu të vdekurit?*

– *Si jo!* – tha i Dërguari.

– *Thirri, pra, të vdekurit!* – iu tha.

– *O trupa, Allahu ju urdhëron që të ngriheni!* – u thirri Pejgamberi.

Në çast eshtrat filluan të bashkoheshin derisa u formuan skeletet, që nuk vonoi dhe u veshën me mish. Shpirtrat u rikthyen në trupa dhe gjaku filloi të rridhte në vena. I mahnitur, Hezekieli shihte se si ngriheshin me fytyra të zbehta, sikur të ishin zgjuar nga një gjumë i stërgjatë. Allahu thotë në Kur'an: *"A nuk ke dëgjuar për ata që me mijëra ikën nga vendi i tyre nga frika e vdekjes?! Allahu u tha "Vdisni", e pastaj i ringjalli ata. Allahu është me të vërtetë mirëbërës i njerëzve, por shumica e tyre nuk janë falënderues."*

Biri im i shtrenjtë, kudo që të ndodhesh, do të të gjejë vdekja edhe nëse strehohesh në kështjella të fortifikuara. Frika nuk ta zgjat jetën, thonë të urtit, dhe as guximi nuk ta shkurton atë. Allahu i Urtë dhe i Gjithditur ia ka caktuar çdokujt ditën e lindjes dhe ditën e vdekjes 50 mijë vite përpara se të krijoheshin qiejt dhe Toka. Çdo gjë është e shkruar në *Leuhi Mahfudh*, edhe numri i frymëmarrjeve, edhe numri i përplasjes së qepallave. Askush nuk mund ta shtyjë exhelin apo ta përshejtojë atë. Ama i mençuri nuk i fshihet vdekjes, por përgatitet për të, natë e ditë. Ai është i bindur se jeta në këtë botë nuk është fundi i njeriut, por stacioni i parë dhe më i rëndësishmi në udhëtimin e stërgjatë drejt Ahiretit. Ai e di se dynjaja i përngjan arës, ndaj besimtari përpiqet, sa të ketë frymë, të mbjellë farën e mirë-

sive, që të korrë kallinj me sevape pafund në ditën e takimit me Zotin e Madhërishëm.

Nuk dihet sa ka jetuar Hezekieli në mesin e beni israilëve. Shkruhet se pas vdekjes së tij, benu israilët e braktisën rrugën e Pejgamberëve duke u zhytur në gjynahe dhe idhujtari... Për të mirën e tyre Allahu i Lartmadhërishëm u dërgoi Pejgamber Iljasin dhe pas tij El'jesean, por përsëri israilitët nuk iu nënshtruan shpalljeve hyjnore dhe humbën në errësitat e devijimit... Kaq shumë e tepruan saqë nuk e kursyen as gjakun e Pejgamberëve. Pasi e nxitën hidhërimin e Allahut, Ai në vend të Pejgamberëve u dërgoi sundimtarë tiranë në mesin e tyre, sundimtarë që derdhnin gjak dhe bënë padrejtësi. E sikur të mos u mjaftonte kjo, i Lartmadhërishmi u dërgoi edhe armiq gjakatarë që ua shtypën kokat, ua plaçkitën pasurinë, ua morën tokat dhe ua robëruan të afërmit... E gjithë kjo, që të zinin mend, të pendoheshin dhe t'i ktheheshin së mbarës.

Uzejri

Bir i dashur! Thuhet se një mrekulli të ngjashme me atë të Hezekielit e ka përjetuar edhe një njeri i mirë, nga pasardhësit e Harunit. Uzejr i thonin. Tregohet se tek kthehej në shtëpi nga udhëtimi, e zuri zhegu, ndaj mendoi të pushonte pak nën hijen e disa gërmadhave buzë rrugës. Me të zbritur nga gomari, u shtri në shpinë. Këmbët i mbështeti në murin gjysmë të rrëzuar të një avllie dhe hodhi shikimin nga shtëpitë e rrënuara. Përveç myshkut, një pëlhurë fshehtësie që mbulonte këtë vend e bëri të zhytej në mendime. Jo se nuk besonte, por nga habia thoshte me vete: *"Si mundet vallë, ta ringjallë Allahu këtë qytezë pas vdekjes së saj?"* Tek ishte i shtrirë, Allahu ia dërgoi melekun e vdekjes, i cili ia mori shpirtin menjëherë. Plot njëqind vite mbeti trupi pajetë i Uzejrit, shtrirë në mes të vendbanimit të rrënuar.

Pasi kaluan njëqind vite, Allahu dërgoi një melek tjetër dhe e urdhëroi t'ia frynte shpirtin edhe një herë trupit pajetë të Uzejrit. Meleku e zbatoi urdhrin e Mbretit të Qiejve dhe ja, Uzejri u rikthye në jetë. E drejtoi shpinën dhe bëri të ngrihej nga vendi, ndërkohë meleku i rrinte krejt afër.

- Sa kohë mendon se ke qëndruar i shtrirë në këtë vend?
- e pyeti meleku, pasi e zgjoi nga vdekja njëqindvjeçare.

Uzejri pa diellin të perëndonte në horizont, ndaj iu përgjigj:

- Një ditë ose një pjesë të ditës... Jam shtrirë në kohë dreke dhe ja tash ... po bie muzgu.

– Jo! Ke qëndruar njëqind vite, megjithatë shih ushqimin dhe pijen tënde! – i tha meleku.

Uzejri u hodhi shikimin, ndërkohë ushqimi dhe pija dukeshin akoma të freskët. Mirëpo meleku, kur vështroi dyshimin tek vërtitej në sytë e Uzejrit, i tha:

– Nëse nuk beson, shiko gomarin tënd!

Ktheu kokën Uzejri, por ç'të shihte! Asgjë nuk kish mbetur nga gomari veç eshtrave të shkapërderdhura... Kështu, meleku filloi të mblidhte eshtrat e gomarit. I vendosi pranë e pranë dhe me rend filloi t'i mbërthente ato duke i veshur me mish. Pasi e formësoi krejt trupin, pasi e veshi me lëkurë dhe qime, meleku ia fryu shpirtin. Me t'i hyrë shpirti në trup, gomari u ngrit në këmbë dhe filloi të pëlliste. Uzejri u mrekullua... Kur pa atë që pa, tha i mahnitur: *"Unë u binda se Allahu i ngjall të vdekurit dhe se ka mundësi për çdo gjë."*

Biri im! Allahu ka mundësi t'i ngjallë të vdekurit. Kjo gjë për Allahun është e lehtë. Mjafton urdhri i Tij dhe njeriu vdes, një urdhër tjetër dhe ai ngjallet sërish.

O bir, njeriu është i gatuar nga trupi dhe shpirti. Kur ai vdes, shpirti braktis trupin i cili venitet në dhé. Mishi tretet, kockat kalben dhe bëhen pluhur përveç një rruaze në fundin e shtyllës kurrizore.

Mirëpo, shpirti nuk venitet dhe as nuk shuhet, por gjallëron në jetë të jetëve. Ai pret ditën e rikthimit në trup, ditën e ringjalljes, Ditën e Madhe kur Israfili për të dytën herë urdhërohet t'i fryjë *surit*. Po kush është Israfili mund të pyesësh ti, e çfarë është *suri*? *Suri* i përngjan bririt si ai që përdorej moti për të dhënë kushtimin. Ama formën dhe madhësinë e tij nuk e di asnjëri. Ndërsa Israfili është një ndër melekët më të dalluar në mbretërinë e qiejve. Profeti Muhamed, alejhis-salam, na lajmëron se ky melek e ka vendosur *surin* në gojë, kokën e mban ulur, në shenjë robërie ndaj të Madhit Zot, por shikimin

e hedh lart për nga Arshi i të Plotfuqishmit, duke pritur urdhrin për t'i fryrë.

Dëgjo bir! Para ringjalljes, Lartmadhëria e Tij do të urdhërojë retë të lëshojnë shi si kurrë më parë. Mbasi ujitet Toka, trupat e bijve të Ademit do fillojnë të mbijnë nga dheu sikur bimët. Siç del filizi i njomë nga fara e thatë, ashtu ndodh edhe me njeriun. Nga një rruazë e vogël kurrizi krijohet njeriu, krejt siç ishte para se të vdiste. Me t'u formësuar trupat, urdhërohet Israfil i fryn *surit*. Atëherë shpirtrat kërkojnë trupat e dikurshëm. Me nxitim bashkohen me ta dhe e gjithë njerëzia ngrihet në këmbë duke pritur me frikë se ç'do ndodhë.

Thuhet se Uzejri u ngrit menjëherë, shaloi gomarin dhe u nis për udhë. Pas një udhëtimi të gjatë mbërriti në qytezën e tij. Si shtegtar i drobitur ecte rrugicave që gjarpëronin nëpër lagjet e qytetit. Njerëz kishte plot, ama askush s'e njihte dhe askënd nuk njihte. Kur mbërriti afër shtëpisë së dikurshme, takoi një plakë të verbër, e cila që në vajzëri kishte qenë robërëshë në derë të tij.

– *A mos është kjo shtëpia e Uzejrit, moj nënoke?* – e pyeti plakën. Asaj iu mbushën sytë me lot...

– *Po, mor bir, kjo është... Po kush je ti? Ku e njihke ti Uzejrin? Kushedi sa vite ka që s'e përmend më kush emrin e tij.*

– *Unë vetë jam Uzejri. Allahu më bëri të vdes për njëqind vite e sot më ngjalli sërish!*

– *Eh, mor shtegtar...* – psherëtiu plaka, – *trupi i Uzejrit ka humbur e është tretur tashmë.*

– *Unë jam Uzejri, o loke,* – ia ktheu shtegtari, – *a nuk beson?*

– *Mirë,* – i tha plaka, – *nëse je Uzejri, lutju Allahut që të ma kthejë shikimin, se Allahu i përgjigjej Uzejrit sa herë që lutej... Nëse je vërtetë ai, unë do të të njoh.*

Atëherë Uzejri e luti Allahun dhe ia fërkoi sytë me duart e tij, kur ja... Plaka filloi të shihte. E mallëngjyer, lokja ngriti shikimin. Pasi e vështroi një copë herë e njohu burrin. *"Lavdia i qoftë Allahut! Unë dëshmoj se ti je Uzejri!"* tha plaka. U ngrit në këmbë, e mori Uzejrin për dore dhe së bashku me të mbërriti në vendtubimin e beni israilëve. Me të mbërritur i tregoi turmës se çfarë i kish ndodhur. Të gjithë brofën dhe po e soditnin me vëmendje shtegtarin...

U ngrit në mesin e tyre një plak 118-vjeçar e tha: *"Unë jam bir i Uzejrit dhe mbaj mend se baba kishte një nishan goxha të madh mes dy shpatullave... Nëse je me të vërtetë ai që thua, zbulona shpinën të ta shohim!"* Me të shpejtë shtegtari zbuloi shpatullat dhe ja: mes tyre dallohej qartë nishani i zi. Por beni israilët nuk e lanë me kaq: *"Uzejri e ka ditur të gjithë Teuratin përmendsh,"* i thanë, *"ndaj nëse je vërtetë ai që thua, na e shkruaj Teuratin fillim e mbarim!"* Pas këtyre fjalëve, udhëtari u ul nën hijen e një peme e filloi të shkruante... Thuhet se, dy rreze drite zbritën nga qielli dhe hynë në trupin e tij, e sërish iu kujtua Teurati, fillim e mbarim. Për këtë arsye disa mendjelehtë e quajtën bir i Zotit, mbasi edhe vetë Musai, i Dërguari i Allahut, thonin se nuk e dinte Librin përmendsh. Allahu Fuqiptotë e bëri këtë burrë argument për beni israilët që të mos kishin kurrfarë dyshimi në ringjallje.

Veç sikur ta shihnim! Uzejri 40 -vjeçar, shëndosh si kurrë më parë, tek çmallej me bijtë e tij, tashmë të kërrusur e mje-kërbardhë...

Dëshira e Ibrahimit

Thuhet se Ibrahim, alejhis-selam, pasi ngadhënjeu mbi mbretin babilonas, u largua nga pallati mbretëror. Me sa duket diçka e trazonte mikun e Allahut. Pa e ndalur hapin mbërriti në skaj të qytetit dhe atje, larg syve të botës, filloi të lutej:

– O Allah! O Zoti im, ma mundëso ta shoh me sy se si i ringjall të vdekurit!

– A nuk e beson se e bëj këtë, o Ibrahim? – i shpalli Allahu.

– Sigurisht që besoj, o Zot, por dua të më shtohet edhe më shumë bindja, e të më qetësohet zemra. – tha Ibrahim, alejhis-selam.

Atëherë Allahu e urdhëroi Ibrahimin: *“Gjej katër shpendë të ndryshëm. Silli këtu dhe copëtoji ata. Pasi t'i kesh copëtuar, merr pjesë nga trupi i secilit dhe shpërndaji nëpër kodrat përreth teje. Pastaj thirru, dhe ata do të të kthehen me nxitim tek ti. E të jesh kurdoherë i bindur se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”*

Me një frymë Ibrahim, alejhis-selam, i gjeti katër shpendët. I solli aty ku qe urdhëruar dhe i theri që të gjithë. Ua zhveshi pendët e puplat, ua copëtoi trupat dhe i përzieu copat, mirëpo kokat ua la mënjanë. Mandej, mishin e ndau në katër pjesë dhe e vendosi në katër kodra. Me të zbritur në luginë, i mori katër kokat e zogjve, i shtrëngoi në duar dhe filloi t'u ndjellë.

Atëherë, me urdhrin e Allahut të Lartësuar, nga kodra në kodër, si në ëndrra, filluan të fluturonin copa mishi që pikonin gjak, lloj-lloj pendësh dhe puplash ngjyra-ngjyra. Për mrekulli pjesët e secilit shpend i njihnin simotrat që u mungonin e kështu rrokeshin mes vete. Bashkohej mishi, thahej gjaku e formohe-shin shpendët një nga një. Sapo u veshën me pendë e pupla, trupat pa kokë filluan të rrahin flatrat dhe nxitimthi fluturuan drejt Ibrahimit, alejhis-selam. Ndërsa miku i Allahut vështonte i mahnitur se si bashkoheshin kokat me trupa bashkë, shpendët filluan t'i çukisnin shuplakat Ibrahimit, alejhis-selam, në kërkim të lirisë. Atëherë, Pejgamberi fisnik hapi duart, zgjidhi gishtërinjtë dhe i mallëngjyer ngriti shikimin drejt zogjve që fluturonin të lirë lart e më lart në qiell. Me të vërtetë Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.

Bir i dashur! Allahu i Lartmadhërishëm do t'i ringjallë njerëzit në Ditën e Kiametit. Kjo gjë për Allahun është e lehtë. A nuk i sheh gjurmët e mëshirës së Zotit se si e zbret shiun dhe e ringjall tokën pas vdekjes dhe shkretimit të saj?! Kështu do ta rikthejë përsëri jetën, duke i ringjallur të vdekurit. A nuk na ka krijuar i Madhi Zot për të parën herë?! A mos vallë krijimi për së dyti është më i vështirë për Të?! A nuk ka fuqi Ai, që krijoj qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak, të krijojë krijesa të vogla si njerëzit?! Posi jo! Ai është i Gjithëditur dhe i Plotfuqishëm.

A nuk e nxjerr Allahu filizin e njomë nga fara e thatë kur zhytet në thellësi të tokës?! Ashtu do e rikrijojë edhe njeriun nga një rruazë e vogël kërbishti. Mandej, a mendon se qiejt, Toka dhe njerëzia janë krijuar kot e pa qëllim? A mendon se i keqi dhe i miri, i drejti dhe i padrejti, besimtari dhe mohuesi do kenë të njëjtin përfundim? Barazia ndërmjet tyre është padrejtësi që kurrë s'mund t'i mvishet Zotit të Lartmadhërishëm. Përkundrazi, Allahu i Lartësuar nuk do ua humb mundin mirëpunuesve. Pasi t'i ringjallë, i Lartmadhërishmi do të shpërblejë gjithë njerëzinë pa përjashtim; bamirësit besimdrejtë me Xhenete të bekuara ku

rrjedhin lumenj të kulluar, ndërsa jobesimtarët, shkatërrimtarët që u zhytën në të keqe dhe poshtërsi me Xhehenem, zjarri i të cilit do jetë strehë e përjetshme për ta.

O bir! Sikur të mos bëhet ringjallja, vetë jeta nuk do të kishte kuptim...

Dy bijtë e Ademit

Thuhet se gjynahu i parë që ka ndodhur mbi tokë ka qenë vrasja e të pafajshmit. Kushedi sa shekuj para nesh, kur Ademi dhe Havaja kishin ngritur folenë në Tokë, Allahu i Lartmadhërishëm u fali shumë pasardhës, bij e bija sa kumi i detit. Thuhet se Havasë në çdo lindje i dhuroheshin binjakë, djalë e vajzë. Kështu ishte shkruar... Ama, për shkak që të shtohet e të mos shuhej njerëzia, Krijuesi i Gjithëditur e urdhëroi Ademin t'i martonte bijtë me bijat e tij mes veti. Djali i një barku martohet me vajzën e barkut tjetër. Ky ishte urdhri i Zotit dhe si i tillë duhej zbatuar medoemos. Mirëpo ç'ndodhi?

Hajde ditë e shko ditë, fëmijët lëshuan shtatin dhe arritën pjekurinë. Kështu kur Habili, njëri nga djemtë e Ademit, u bë burrë, kërkoi lejen për martesë dhe bekimet e të atit. Ademi u gëzua, ia lejoi martesën dhe e uroi të shtohet e të trashëgohet sa yjet në qiell. Mirëpo vëllai i tij, Kabili, iu bë pengesë. Pse vallë mund të thuash ti? Po ja, motra e Habilit që i binte për hise Kabilit nuk ishte edhe aq e pashme. Ndërsa motra e Kabilit që i takonte Habilit ishte më e bukur se lulja e pranverës, ndaj ai deshë ta mbante për vete...

Me t'i rënë lajmi në vesh, Ademi u përpoq ta shuante zjarrin e zilisë në zemrën e Kabilit, por më kot. Atëherë i udhëzoi dy djemtë e tij të flijonin nga një kurban, dhe kujt t'i pranohej kurbanin do t'i takonte vasha. Shenjë e pranimit të këtij fljimi do të ishte një zjarr që zbriste nga qielli dhe shkumbonte kurbanin e pranuar. Mirëpo ç'ndodhi? Zjarri zbriti, por dogji

vetëm kurbanin e Habilit. E si t'i pranohej kurbanit smirëziut që theu urdhrin e Allahut dhe porosinë e të atit?! Kabili gati sa nuk plasi nga marazi.

Bir i dashur! Fike zjarrin e zilisë që ndizet herë pas here në gjoksin tënd, sepse ai ta përcëllon zemrën dhe ta humb arsyen. Fisnikun nuk e varfëron pasuria e tjetrit. Largoje smirën, o djalë, e kurrë mos harro se ajo që ka caktuar Allahu për ty është më e hajrit sesa ajo që do dëshiroje për vetveten.

– *Unë do të të vras!* – i tha Kabili.

– *Çfarë po thua, o vëlla?* – tha Habili, teksa mendohej ta qetësonte. – *A më kërcënon se m'u pranua kurbanit? Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve.*

Kabili u ngrys edhe më. Iu afrua vëllait e nuk i vuri fre vetes.

– *Nëse ti e zgjat dorën kundër meje, për të më vrarë, unë nuk do ta kthej. Jo se të kam frikë ty, por i druham Allahut, Zotit të botëve,* – iu drejtua përsëri Habili.

– *Nëse më vret do bartësh barrë të rëndë gjynahesh, o Kabil! Do bartësh gjynahun e vrasjes sime, bashkë me gjynahet e të kaluarës tënde, e do të bëhesh banor i zjarrit. Ky është shpërblimi i keqbërësve!* – vazhdoi Habili për ta frikësuar.

Biri im! Kurrë mos harro se vrasja është një krim i tmerrshëm. Të tillë e ka edhe ndëshkimin. Allahu i Plotfuqishëm na bën me dije, se kushdo që vret një musliman qëllimisht dhe padrejtësisht, në botën tjetër do digjet në zjarr. Allahu zemërohet me këtë njeri, e mallkon dhe përgatit për të një dënim të papërballueshëm.

Me të drejtë ti mund të pyesësh, po nëse vret një jomusliman? Profeti Muhamed, alejhis-selam, na mëson se kush e vret një jomusliman padrejtësisht dhe në pabesi, mirë se nuk do hyjë në Xhenet, por as që do e nuhasë aromën tij. Mjerë

për atë që ngre dorën për t'i marrë jetën një të pafajshmi.

Megjithatë, shpirtligësia ia hijeshoi Kabilit vrasjen e vëllait të vet. Iu vërsul si një kafshë e tërbuar dhe e vrau. Habili ra pa frymë përdhe. Atëherë zilia sikur iu shua pak, por zemra e Kabilit nuk u qetësua. Përkundrazi, e kaploi pikëllim dhe mërzi e madhe. Shejtani, që i frynte zjarrit të zilisë, duke ia hijeshuar vrasjen e Habilit, e braktisi. Mashtguesi ishte ai që e shtyu drejt të keqes. Mirëpo, pasi e bëri krimin, e bindi se tashmë nuk kish kthim pas, se do ishte i mallkuar për sa të kishte jetë. *"Vëllanë e humbe,"* i pëshpëriste, *"babë e nënë i pikëllove dhe mallkim mbi mallkim meritove."* Kështu, Kabili e humbi shpresën dhe u zhyt edhe më thellë në errësirat e ligësive. I përhumbur kërkonte rrugëdalje. Nga të shkonte? Ku të strehohej? Si ta fshihte fajin?

Vdekje me sy kurrë s'kishte parë, ndaj nuk dinte se si të bënte me trupin e Habilit... Tek përpiqej të largohej, Allahu i Lartësuar dërgoi dy korba qymyr të zi. Tek fluturonin, shpezët krakëllinin e bënin poterë. Me të zbritur filluan të kacafyten aq keq saqë njëri e mbyti tjetrin. Për çudi, korbi që mbijetoi filloi të gërmonte tokën me sqep e me kthetra. Gërmo e gërmo, e hapi një gropë të thellë. Mandej hop-hop iu afrua korbit të ngordhur dhe e tërhoqi me sqepin e gjatë për tek gropa. Pa një pa dy e hodhi dhe e mbuloi me dhé mandej i dha krahëve dhe fluturoi lart.

"I mjeri unë!" tha me vete Kabili tek shihte shpendin, *"Si nuk e mbulova edhe unë trupin e vëllasë ashtu siç bëri korbi?"* Kështu pra, që nga ajo ditë njerëzia varrosin të vdekurit si korbi-korbin, që të mos kalben mbi dhé e të bëhen burim sëmundjesh për njerëzinë dhe poashtu të afërmve mos tua shtojë mërzinë.

Biri im! Profeti Muhamed, alejhis-selam, na tregon se sa herë që derdhet gjak i pafajshëm mbi tokë, qysh nga dita kur

Kabili vrau vëllanë e deri në Ditën e Kiametit, Kabili ka hisen e tij nga gjynahu i kësaj gjakderdhjeje. Besoj se e kuptove mësimin: Kush i drejton të tjerët për nga e mira do të shpërblehet me sevapin e të mirës kurdoherë që ata bëjnë mirë. Ama, edhe kush bëhet shembull për ligësi (e nuk pendohet) do marrë hise nga gjynahu i gjithkujt që e pason shembullin e tij.

Ndaj përpiku të jesh shembull i mirë në mesin e njerëzve që të rrethojnë, që së bashku me ta të udhëtosh në karvanin e të dalluarve, e të shpërblehesh me kodra sevapesh sa të jesh gjallë, por edhe pas vdekjes. Mundohu të bëhesh çelës mirësie me të cilin hapen dyert e hajrit dhe mbyllen dyert e sherrit kudo që të jesh. Kështu do të marrësh bekimin e njerëzisë, nderimin e banorëve të qiellit dhe shpërblimet nga Zoti i Gjithësisë.

Dita e shtunë

Bir i dashur! Profeti ynë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na mëson se dita më e vlefshme e javës, dita më e mirë në të cilën shkëlqen dielli, është e dita e xhuma. Të xhumanë u krijua Ademi, atë ditë hyri në Xhenet dhe po atë ditë doli prej tij. Madje edhe Kiameti do të ndodhë ditën e xhuma.

Allahu i Lartësuar e nderoi umetin tonë me këtë ditë dhe na e bëri festë të përjavshme. Ndërkohë që hebrenjtë parapëlqyen të shtunën, ndërsa të krishterët ditën e diel, Lartmadhëria e Tij, e bëri ditën e xhuma të bekuar, e caktoi si festë për ne dhe e radhiti atë para të shtunës dhe të dielës. Ashtu siç u prin dita e xhuma të shtunës dhe të dielës, ashtu do t'u prijnë muslimanët hebrenjve dhe të krishterëve në Ditën e Gjykimit. Ne jemi umeti i fundit në jetën e dynjasë, por të parët që do gjykohej dhe do shpëtojmë nga tmerri i Ditës së Kiametit.

Biri im! E shtuna, megjithëse ditë e bardhë për hebrenjtë, bart me vete një ndodhi jo fort të këndshme për ta. Na ishte qëmoti, atje larg, në brigjet e Detit të Kuq një qytezë e moçme që quhej Ejle e mbahej me peshkim. Vendasit ishin peshkatarë të palodhur, bënin punën e robit dhe hanin bukën e Zotit. Gjashtë ditë peshkim, kurse e shtuna pushim dhe adhurim. Kështu ishte shkruar për të parët e tyre, gjysha e stërgjysha, Pejgamberë dhe bij Pejgamberësh. Mirëpo, pas kushedi sa brezash, shumica e tyre e lanë në harresë Librin e Zotit. U prish njerëzia dhe u shtua e keqja. Në vend që të falënderonin Allahun

e Lartësuar, e të ishin mirënjohës, për bollëkun e peshkut që u vinte natë e ditë, iu dhanë gjynaheve dhe i shkelën kufijtë. Në vend që t'u përmbaheshin porosive të Pejgamberëve, pasuan urdhrat e shejtanëve dhe u bënë mjeshttra të mashtrimit. Shenjtëronin pasurinë dhe pozitën e lartë, ndërsa mësimet e fesë i hodhën pas shpine. Këdo që i këshillonte për mbarë e shihnin si armik, ndërsa armikut të vërtetë ia kishin drojën dhe i ruheshin si luanit...

Kur e tepruan me të liga, Allahu i Lartmadhërishëm i sprovoi, që të dallohej i miri nga i keqi, i drejti nga dredharaku që të ishin shembull për vendbanimet përreth tyre dhe përkujtim për brezat që erdhën pas. Po ç'u ndodhi vallë dhe ç'u bë me ta?

Gjashtë ditët e punës peshku filloi të rrallohej e nuk vinte si dikur, ndërsa të shtunën peshku vù. Tufa-tufa u vinte krejt afër bregut. Lëvrinte pa pushim nën ujin e kthjellët si loti dhe ua çonte vendasve zemrat peshë tek e shihnin peshkun luspëbardhë të sillej e përdridhej si për inat. Si t'ia bënin vallë? Të shtunën nuk u lejohej peshkimi. Si të vepronin se? U mbledhën burrat në kuvend, peshkatarë e mendarë tok. U ngrit njëri dhe e tha të tijën. U ngrit i dyti, i treti... por askush nuk ia qëlloi. Kur mori zjarr kuvendi një dinak e mori fjalën: *"O burra! Meqë Zoti e ka shkruar të mos punojmë të shtunën, ne ashtu do bëjmë. Ama, rrjetat i hedhim që të premtën, pak para se të ngryset. Të shtunën as nuk i prekim me dorë, por të dielën herët i mbledhim plot e përplot. Edhe mishi piqet edhe helli nuk digjet. Ne nuk i kapim, ata vetë ngatërrohen me rrjetën. Si mendoni?"* U ngritën faqezinjtë e ia mbajtën krahun dinakut. *"Të lumtë goja!"* i thanë, *"Burrë i mençur paske qenë."* E mbajtën me të madh dhe ia morën fjalën. U hodhën urtarët dhe folën me zë të trashë: *"Mos u mashtroni o burra! Nuk luhet me fenë e Zotit. Më mirë pak e me hallall sesa shumë e me haram. Nuk mund të mashtrohet i Lartmadhërishmi, o*

vëllezër: *E pakta pastë bereqetin, o peshkatarë!*" U munduan t'i këndellnin zemrat e peshkatarëve, por më kot... fjalët ranë në vesh të shurdhër.

Hajde javë e shko javë... Të premteve vonë, para se të zbriste muzgu, peshkatarët vozitnin varkat dhe çanin valët drejt thellësive. Atje vendosnin me mjeshtri rrjetat, që i shtrinin në vijë të drejtë deri afër bregut. Rrjetat fillonin e dridheshin, ama askush nuk i ngrinte... gjoja për të ruajtur shenjtërinë e të shtunës. Gjatë ditës nuk preknin punë me dorë, ama sapo niste të ndahej e shtuna nga e diela i turrëshin bregut përsëri. I përvisheshin punës shpejt e shpejt. Duart flakë, ngrinin velat, vozitnin rremat, tërhiqnin rrjetat, merrnin peshkun, peshku mal. *"Eh, sa mbarësi o peshkatarë!"* i thërritnin njëri-tjetrit me gëzim, *"Këtiq i thonë peshkim. Kush e di se sa do fitojmë?!"*

Mirëpo, sapo preknin bregun, i prisnin përherë një grup burrash të urtë dhe i këshillonin të hiqnin dorë nga ky avaz, ama peshkatarët as që ua vinin veshin. Ua tërhiqnin vërejtjen në treg, kur mblidheshin për të blerë e për të shitur, por më kot. Këshillo natën e këshillo ditën. Porositi veçmas e porositi në grup, por as që u bëhej vonë. Bollëku dhe pasuria ua kishin verbuar shikimin dhe ua kishin marrë dëgjimin.

Mjerë për ta! A mashtrohet Allahu?! E si mund t'i bësh hile Atij që i dëgjon edhe pëshpëritjet e fshehta të zemrave?! A nuk e dinin ata se pasuria hallall, e fituar me djersë, është e bekuar edhe nëse është pak, ndërsa pasuria e fituar me dredhi, hile dhe padrejtësi është e mallkuar dhe fundin e ka të hidhur.

Puno me ndershmëri, o bir, le të jetë qëllimi yt kënaqësia e Allahut dhe jo mbushja e xhepave. Kështu Allahu i Lartësuar do të ta mbushë zemrën përplot me lumturi edhe nëse s'ke pasuri të madhe.

Sot kështu e nesër ashtu, populli u nda në tri grupe. Shumica e shkelën porosinë e Zotit. Një grup i këshillonin dhe i

qortonin sa më s'ka. Ndërsa grupi tjetër, megjithëse e urrenin punën e peshkatarëve, u drejtohej këshilluesve: *"Përse lodheni me këta faqezinj që kanë marrë guximin të shkelin ligjin e Zotit? A nuk e shihni se si sillen me ju?! As që ua vënë veshin këshillave dhe qortimeve tuaja. Përse i këshilloni ata që Allahu do t'i ndëshkojë ashpër, herët a vonë?"*

Këshilluesit u thonin: *"I këshillojmë, për të kryer detyrën tonë para Zotit dhe me shpresë se do heqin dorë nga e keqja. Nuk lodhemi kollaj, jo. Mbase këshillat tona do ua prekin zemrat."*

Biri im! Këshillo për mirë dhe ndalo nga e keqja, e mos e humb shpresën. Fjala që buron nga thellësia e zemrës godet në zemra. Mendo mirë për tjetrin! E kurrë mos harro se: Allahu i Lartësuar përmes fjalës së mirë, mund të nxjerrë nga shtëpitë e mosbesimit dhe të gjynaheve, njerëz të devotshëm dhe besimtarë. Ama, nëse heq dorë nga këshilla dhe shembulli i mirë, ka mundësi që nga shtëpitë e besimit dhe të devotshmërisë, të dalin njerëz të prishur dhe jobesimtarë.

Javët u bënë muaj dhe muajt ikën një nga një... Peshkatarët i hodhën pas shpine këshillat dhe vazhduan rrugën e keqe. Kur e harruan Allahun, Ai ua hapi portat e bollëkut dhe të mirësive të dynjasë, që të zhyteshin thellë e më thellë në gjynahe. Mirëpo, kur ata po u gëzoheshin mirësive, i Lartmadhërishmi i goditi në befasi dhe nuk patën asnjë mundësi shpëtimi.

Teksa flinin të qetë i goditi vala e mallkimit. Mjaftoi një urdhër nga Mbreti i Qiejve dhe të gjithë faqezinjtë u shndërruan në kafshë. U ngrysen njerëz dhe u gdhinë majmunë të përbuzur si të kishin lindur në savanën afrikane: të mbuluar me qime të trashë e të zezë, fytyrë ngrysur e të zhubravitur, me sy të kuq si të ishin rubinë. Gungaç, këmbëshkurtër dhe krahleshtorë u ngritën nga shtretërit të lebetitur. Bënë të flisnin, por iu lidh gjuha. Bënë të qanin, por nuk nxirrnin veçse

klithma majmuni. Të përçudnuar filluan të kërcenin sa andej këndeje, filluan të thyenin e të shkatërronin ç'tu dilte para, por kthim pas nuk kishte. Familjarët u tmerruan. Me vaj në sy, goditnin fytyrat me shuplaka, por më kot. Të pështirosur dhe të gërditur nga majmunët, të afërmit e tyre jetuan bashkë me ta, me shpresën se mund të shndërroheshin edhe një herë si më parë, por ishte vonë. Thuhet se majmunët e mallkuar e të përçudnuar jetuan vetëm tre ditë. Pas kësaj kohe secili vdiq. Allahu i Lartësuar i dënoi, hilen e tyre ua ktheu me mallkim dhe tregtia nuk u pati kurrfarë suksesi. Dita e shtunë u bë e zezë për ta, ditë kobi e pikëllimi.

Kur e tepruan me gjynahe dhe i hodhën pas shpine këshillat e mendarëve, Allahu i Madhëruar i ndëshkoi, por nga ana tjetër Ai i ruajti këshilluesit nga dënimi. Kështu është shkruar: Ata që urdhërojnë për mirësi dhe ndalojnë nga e keqja janë të dashurit e Allahut dhe Ai nuk i dënon të dashurit e Tij.

Po me grupin që u thoshte këshilluesve: përse i këshilloni ata që Allahu do t'i ndëshkojë ashpër, herët a vonë, ç'u bë mund të thuash ti? Edhe ata i ruajti Lartmadhëria e Tij nga përfundimi i keq, mbasi edhe ata e urrenin hilen e peshkatarëve madje ishin të bindur se faqezinjtë do të poshtëroheshin. Kështu pra, i miri shpëtoi dhe i keqi u mallkua, por historia e të shtunës mbeti në kujtesë dhe kurrë s'u harrua.

Banorët e Shpellës

Biri im! Në rrugën e besimit vështirësitë janë të lloj-llojshme, ama kush sakrifikon për hir të Allahut, i Madhi Zot e ndihmon dhe e bën të qëndrueshëm. Përgjatë historisë Lartmadhëria e Tij i ka nderuar besimtarët nëpërmjet mrekullive të ndryshme, një prej të cilave na e shpalos në Kur'anin Famëmadh.

Njëherë e një mot, na ishin disa djelmosha në lulen e moshës. Thuhet se vinin nga dyer të mëdha, princër e bij princërish. Gjysha e baballarë i kishin fisnikë e kaluar fisnikëve, burra me peshë që u dëgjohej fjala e që i kishin dhënë besë mbretit se do ta ndihmonin e do t'ia mbanin krahun sa herë të ish nevoja. Mirëpo mbreti e mbretëresha, populli dhe paria e atij vendi ishin idhujtarë. Këtë besim e kishin trashëguar brez pas brezi. Nuk hiqnin dorë nga adhurimi i statujave prej guri e druri, madje kushdo që braktiste fenë e të parëve syrgjynosej ose gurëzohej deri në vdekje.

Thuhet se një ditë prej ditësh, krejt njerëzia, i madh dhe i vogël, burra e gra, mbret e mbretëreshë dolën në sheshin e madh të qytetit. Ishte ditë e madhe, ditë feste, në të cilën lavdëronin idhujt dhe thernin kurbane për ta. Disa luteshin, disa i puthnin idhujt, të tjerë i përkëdhelnin me frikë-respekt, ndërsa paria e vendit u përulëshin këtyre statujave pa jetë, të skalitura nga duart e tyre, në kërkim të mirësive dhe bereqetit.

Në mesin e turmës, një djalosh, i zhytur në mendime shih-te të afërmit e tij tek përlëvdonin statujat prej guri. "Sa çudi,"

mendonte djali, *"Si nuk mendon njerëzia vallë? Si mund ta adhurojë krijuesi krijesën që e skaliti me duart e veta?"* Pa rënë në sy, u përvodh dhe zuri vend nën hijen e një peme, mbi një kodrinë, në skaj të sheshit. Ngriti pëllëmbën si strehë mbi sy dhe nisi të shikonte njerëzinë. Djersë të ftohta si vesa e mëngjesit ia mbuluan ballin. *"Si nuk mendon njerëzia vallë?"* thoshte djali me vete, *"Si mund të të ndihmojë një gur pa jetë, që nuk flet dhe as nuk dëgjon?"*

Pa pritur e pa menduar erdhi e zuri vend nën hije edhe një i ri tjetër. E përshëndeti djaloshin dhe u ul pranë tij. Kështu erdhi edhe i treti, i katërti, i pesti dhe i gjashti se pema ish e lartë dhe me degë shumë, ndaj hijen e kish të gjatë e të gjerë. Veç t'i shihje gjashtë djelmoshat! Si ta desh e bardha zemër. Të veshur e të stolisur, të pashëm e të lidhur mirë në trup, s'e kishin moshën sa e kishin shtatin, sikur të ishin rritur bjeshkëve. Kot s'u thonë bij fisnikësh!

Diç u mat t'u thoshte njëri, por e gëlltiti fjalën. Kështu edhe i dyti e i treti, por nuk folën. U ngrit e mori fjalën ai më i madhi, më fisniku e më trimi.

– *E ç'e mirë ju solli nën këtë hije o shokë,* – u tha, – *Dielli apo halli?*

Drita që ua rrethonte fytyrat djelmoshave iu shua menjëherë, por s'thanë gjë.

– *Flisni o djem, e mos tuteni nga unë! Ja, edhe unë si ju jam: mishit e gjakut, fisnik e bir fisniku.*

– *Po ja o vëlla,* – ja priti njëri, – *nuk munda të duroj dot, teksa shihja të afërmit e mi të adhuronin statujat pa jetë, shtatoret që nuk sjellin dëm dhe as dobi. M'u helmua shpirti, ndaj erdha nën hijen e kësaj peme të flladitem pak, e ta marr veten.*

– *Edhe unë për këtë iu largova turmës.*" – ia priti i dyti.

– *Edhe unë si ju,* – i treti, dhe i katërti. Ashtu edhe i pesti e i gjashti, ai më trimi e më fisniku.

Kështu, zunë djelmoshat të bisedojnë shtruar njëri me tjetrin.

– Ja pra, – u ngrit trimoshi dhe e mori fjalën për së dyti, – populli ynë adhuron zota pa vlerë duke e harruar Zotin e vërtetë, Krijuesin e qiejve dhe Tokës, ndërsa ne e urrejmë fenë e tyre. Kush ma zgjat dorën për besa–besë se nuk do adhurajë idhujt për sa të ketë jetë, por vetëm Krijuesin Fuqiptotë, se do t'i mbajë krahun shokut e do t'i gjendet pranë kur ta lypë nevoja?

Kur dëgjuan fjalët e trimit të pesë djelmoshat brofën në këmbë e i dhanë besën shoku–shokut. U përqaftuan si të ishin miq të vjetër e morën rrugë për në kështjellat e tyre.

Prej asaj dite, djelmoshat kurrë më nuk u përzien me idhujtarët. Asnjëherë nuk iu përulën idhujve që përlehtësonin baballarët e tyre, madje filluan të thërrasin edhe të tjerët në adhurimin e një Zoti të vetëm, Krijuesit të qiejve dhe të Tokës.

Mosbindja e tyre i ra në vesh mbretit. Kur ia dhanë lajmin, ky u hodh përpjetë sikur të kishte shkelur gjarprin. “Çfarë?” bërtiti makuti, “Robërit e mi, bijtë e robërve të mi adhurojnë Zot tjetër veç zotave tanë? T'i qjeni sa më parë e të m'i sillni menjëherë në pallat!” dha urdhër. U bë si ish fjala e mbretit. I gjetën djelmoshat dhe i sollën në pallat. Ashtu së bashku, hynë tek mbreti, mjekërgjatë e buzëvarur, me kurorë mbi kokë e me gishtërinj përplot unaza që shkëlqenin. Ai qëndronte mbi një fron të madh, të veshur me kadife të kuqe, rrethohej nga shërbëtorë, oborrtarë dhe disa rreshta të palëvizshëm me roje, por kjo nuk i frikësoi djelmoshat. Dyshemeja prej mermeri shtruar me qilima e sixhade lloj–llojesh, kolonat e gdhendura, abazhurët dhe shandanat që llamburitnin, as që u hynin në sy besimdrejtëve. Me krenari shkuan tok drejt mbretit. Ai mblodhi vetullat dhe u kthye e shikoi sikur desh t'i përpinte me sy.

– Më kanë ardhur fjalë se disa fisnikë, bij princërish, nuk i përulen dhe as nuk i lavdërojnë zotat e mi, – tha me zë të

trashë. – *Mos vallë jeni ju djelmoshat që keni ngritur krye ndaj urdhrit të mbretit tuaj?*

Allahu ua përforcoi zemrat me trimëri dhe ua largoi frikën nga gjoksi. Kështu, ai më trimi e mori fjalën e shokët ia mbajtën krahun. Nuk kërkuan falje dhe, megjithëse kjo do t'i kushtonte shtrenjtë, brohoritën njëzëri:

– *Zoti ynë është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, o mbret. Ndërsa idhujt që adhuroni ju janë krijesa dhe jo krijues. Ata nuk sjellin as dëm dhe as dobi. Ata që adhuroni nuk mund të krijojnë asgjë, nuk sjellin kurrfarë bereqeti, nuk falin jetë dhe as që mund ta marrin atë. Ata janë gurë që i ka skalitur njerëzia, ndaj ne kurrë nuk do të adhurojmë gjësende pa vlerë.*

Allahu i Lartmadhërishëm ia zbuti zemrën mbretit, e kështu ai iu kthye e u tha:

– *Mirë, mirë. Ju jeni të rinj, në lule të moshës, jeni bijtë e robërve të mi besnikë, ndaj po ju jap pak afat. Shkoni dhe mendohuni edhe një herë... përndryshe...*

– *Përndryshe*, – tha mbreti, me shpresën se do t'i frikësonte, – *do të dënoheni me vdekje!*

Djelmoshat ishin të mençur, të matur e të duruar. Kur e panë se fjalët u ranë në vesh të shurdhër ikën për të mos u kthyer kurrë më tek mbreti. Si një trup i vetëm dolën nga pallati mbretëror dhe e lanë qytetin. Nuk morën me vete veçse disa monedha prej ari dhe argjendi, që të shtynin udhën. E lanë nënë e babë. E lanë pasurinë dhe salltanetet, rehatinë dhe pallatet e stolisura, shërbëtorë e shërbëtore, kuajt dhe karrocet, për të ruajtur fenë e tyre, për të ruajtur imanin në gjokse, për ta adhuruar Allahun të lirë kudo të ishte e shkruar.

Bisedonin djelmoshat me shoqi-shoqin t'u shkurtuhej rru-
ga, ama nga do të shkonin nuk e dinin. Rrugë më rrugë e
shteg më shteg, mbërritën rrëzë një mali të gjelbëruar. Nga

larg e panë një çoban tek u shkonte pas bagëtive. Morën e iu afruan, kur ç'të shihnin... një djalosh i pashëm, lëshverdhë e hijerëndë, me faqe të rreshkura nga vapa e ditës tek bënte roje me qenin e tij.

– Ç'e mirë ju solli në këto anë o djelmosha? – u thirri bariu sapo i pa. – Nga sa shoh princër e bij princërish më qenkeni, mirëpo pasanikët nuk para vijnë këndeji pari. Po edhe nëse vijnë, nuk ecin në këmbë, por kalëruar.

– Ah more lum miku, – ia ktheu ai më i madhi, – princër e bij princërish jemi, por e lamë pas shpine gjithë çfarë patëm, o bari bujar!

Kështu u ulën tok e kuvenduan me bariun, i cili ishte njeri i thjeshtë, por me zemër të madhe. Ai i pyeti hollë-hollë se kush ishin e pse e kishin lënë qytetin dhe këta ia treguan historinë e tyre fill e për për, sikur ta njihnin qëmoti.

– Po edhe unë jam në fenë tuaj o djelmosha, ndaj më keni mik e kaluar mikut. – ia ktheu bariu me gjuhë të hollë, ndërkohë që era ia përkëdhelte balluket.

– A njeh ndonjë vend të fshehtë, që të strehohemi e të pushojmë pak, o njeri i mirë? – i thanë.

– Ejani pas meje, – u tha bariu, – tua tregoj një shpellë për të shtrirë kockat e për të kaluar natën! E njoh mirë atë shpellë. Atje tej fshihet, në skaj të luginës Rrakiim. Sa herë që na zinte shiu tek kullotnim gjënë e gjallë, strehoheshim atje bashkë me babën tim. Meqë jeni larguar që ta ruani fenë tuaj qëndroni në shpellë, se Zoti juaj do t'ju dhurojë nga mëshira e Tij e gjerë dhe do t'ua lehtësojë punën tuaj."

E me të vërtetë ashtu ndodhi... Allahu i mbuloi me mëshirën e Tij, ua ruajti fenë, shëndetin dhe i bëri shembull që do kujtohen për mirë sa të ketë jetë. Po ç'ndodhi më pas?

Me të mbërritur tek shpella hynë në brendësi të saj, zunë vend, e filluan të luten. "O Allah, o Zoti ynë! Na dhuro mëshirë

prej mëshirës Tënde dhe na udhëzo në rrugën e drejtë!" iu përgjigjuran të Madhit Zot t'i ndihmonte dhe ashtu u bë. Rrugat e gjatë i kishte lodhur e i kishte sflitur djelmoshat, ndaj një nga një i koti gjumi. Po çfarë gjumi se?! Plot 309 vite. I Gjithëmëshirshmi ua mbylli veshët e ranë në gjumë të thellë, ua qetësoi zemrat dhe i ruajti nga populli idhujtar për më se tre shekuj.

Veç t'i shihje tek flinin! Kur agonte dielli anonte nga e djathta e shpellës dhe kur perëndonte largohej nga e majta. Allahu Fuqiptotë i mbrojti nga rrezearti dhe u kujdes që të mos i digjte trupat e tyre e t'ua prishte gjumin. Kështu rrezet ua gudulisnin trupat veçse një pjesë të ditës që të mos ftoheshin e ta humbnin nxehtësinë, teksa flinin në zemër të shpellës. Djelmoshat preheshin në një hapësirë të gjerë, që t'u fladiteshin trupat dhe të mos u mykeshin nga qëndrimi i gjatë në një vend të ngushtë dhe të mbyllur.

Nëse do t'i shihje do mendoje se janë zgjuar, sepse sytë i përpëlitnin here pas here, që të mos u verboheshin nga gjumi shekullor. Për më tepër, Allahu i Lartësuar ia rrotullonte trupat sa nga e majta e sa nga e djathta, si e si që toka të mos ua hante dhe as t'ua prishte trupat, siç e ka zakon ajo.

E çuditshme ishte, se edhe qenin që shoqëronte bariun e mudi gjumi i stërgjatë, gjatë kohës që ruante të zotin dhe djelmoshat. Me krifën si një luan savane dhe me këmbët leshtore të shtrira për së gjati në hyrje të shpellës, ia kalte datën kujt do që kalonte andej pari. Kushdo që e shihte mbushej me tmerr dhe largohej me frikë në palcë. Kjo bëri që ata të qëndronin me shekuj në shpellë, të paprekur dhe të pazbuluar nga askush edhe pse ishin shumë pranë qytetit. A nuk është kjo një nga mrekullitë e Allahut të Lartmadhërishëm që dëshmon për fuqinë dhe urtësinë e Tij?!

Ditët u bënë javë, javët muaj dhe muajt vite. Shkuan e

rrodhën tre shekuj e kusur shpejt e shpejt, si uji i kroit. 309 vite pasi i kishte kapluar gjumi, shkrep dielli mbi shpellë ua gudulisi fytyrat, kur ja, u zgjua i pari, i dyti, i treti e me radhë. U dukej djelmoshave sikur i kishte mundur gjumi dje, se dielli dhe shpella po ato ishin, e asgjë përreth nuk kish ndryshuar. Mirëpo trupat i ndjenë fort të lodhur dhe barku u ish bërë një me shpinën. Rrobat u kundërmonin aromë dheu e myku, sikur të ishin ngritur nga varret, megjithatë ishin fort të lumtur. As që u shkonte ndër mend se sa kishin fjetur... Kështu njëri prej tyre foli e u tha:

– *Sa kohë mendoni se kemi kaluar në gjumë, o vëllezër?*

– *Ndoshta një ditë ose një pjesë të ditës, – ia kthyen disa prej tyre. U ngrit ai më trimi, më fisniku dhe më i urti e tha:*

– *Allahu, Zoti ynë e di më së miri se sa mot kemi kaluar në këtë shpellë... Nuk është tani, koha e përshtatshme të kuvendojmë se sa kemi fjetur. Të gjejmë pak ushqim hallall, o vëllezër, se po na fiket shpirti nga uria!*

– *Po si t'ia bëjmë o vëlla?*

– *Po ja, le të shkojë vjedhurazi njëri nga ne në qytet, t'na e zgjedhë ushqimin më të mirë dhe të na e sjellë. Ama le të sillet urtë e butë dhe të jetë i kujdesshëm që të mos bie në sy. Kam frikë se po na zbuluan do na vrasin me gurë, ose do na kthejnë me forcë në fenë e tyre, e kështu e humbim dynjanë dhe Ahiretin.*

– *Si të thuash ti u bëftë pra, o vëlla i madh. – u përgjigjën njëzëri.*

Përzgjedhën njërin në mesin e tyre dhe ky s'ua bëri fjalën dysh. Mori qesen me monedha, u dha këmbëve, shpejt e shpejt zbriti në qytet e shkoi drejt e në treg. Mirëpo, me të hyrë në qytet djaloshi u habit... Iu duk si qytet tjetër, por s'bëri zë. Atje ku dikur kish pasur ara, sot kishte rrugë me kalldrëm e shtëpi

guri. Edhe njerëzit ishin veshur ndryshe. Hej, bela! Ai çuditej me ta dhe ata çuditeshin me të.

– *Sa monedha kushton kjo bukë e ngrohtë, o njeri i mirë?*
– i tha djaloshi një shitësi. – *Po ky ushqim i shijshëm sa kushton?*

– *Nuk janë shtrenjtë, jo, o lum djali, – ia priti plaku, – Ti sa më jep për ta?*

– *Nuk kam shumë, o plak bujar, – iu kthye djali, – ja, shihi vetë sa kam.”*

Me ta hapë qesen djali, shkëlqyen monedhat e u mahnit plaku.

– *A ma jep njërrën, o djalë fisnik,* – i tha plaku, – *se e huaj po më duket?*

Ja dha djali monedhën plakut, e ky u mahnit edhe më shumë.

– *A s’ma thua se ku i gjete këto monedha, o djalë fisnik?*
– i tha plaku ëmbël e ëmbël.

– *Të miat janë, o plak bujar, as nuk i vodha dhe as nuk i gjeta.*

– *Të paça more bir, po kjo páre ishte e katragjyshave tanë, shekuj më parë e sot nuk përdoret më,* – foli plaku, – *A s’ma thua se kush je e nga vjen?*

– *Mirë o plak bujar, – ia ktheu djali, – a s’më tregon për mbret e për mbretëri, për popull e fisnikëri? Mandej në zemër të qytetit rashë, por idhujt nuk i pashë!*

– *Çfarë idhujsh mor djalë i mbarë, mbreti ynë adhuron Allahun dhe është besimtar!*

I farfurinë faqet djalit dhe zemra iu mbush me gaz, por prapë s’kuptonte. E pyeti hollë-hollë plakun për mbret e mbre-

tërshë, por ky i tregoi se këta emra nuk i njeh askush sot, janë harruar qëmoti.

– *Kushedi sa mbretër e sa mbretëresha kanë kaluar e janë shuar pas tyre!* – tha plaku.

Tek bisedonin plaku e djali, kaloi njëri e i dëgjoi. Ky i pari e thirri të dytin, i dyti të tretin e kështu u mbloodh njerëzia rreth tyre. Të shushatur nga monedhat e arit, e morën djalin e panjohur dhe ia dërguan mbretit për gjykim. Mbreti asokohe ishte besimdrejtë, njeri i urtë dhe zemërbardhë. Kur ia sollën djalin, mbreti e pyeti se si quhej e nga vinte. Djali ia tregoi emrin dhe ia rrëfeu historinë e tij. Teksa dëgjonte, mbretit iu ngrohën sytë dhe iu mbushën me lot. *"I madhëruar qoftë Allahu!"* thirri mbreti i mrekulluar. *"E tani, a s'na tregon shpellën se ku fshiheshit, o djalë besnik?"* foli për së dyti.

Kështu pra, Allahu i Lartësuar e largoi vellon e fshehtësisë dhe i zbuloi djelmoshat që të mahniteshin njerëzit dhe ta kup-tonin se premtimi i ringjalljes është i vërtetë dhe se Kiameti do të vijë patjetër.

Mbreti bashkë me parinë e tij si dhe krejt populli i shkuan pas djaloshit, për të takuar vëllezërit e tij të besimit. Kur mbërritën afër luginës Rrakim, djaloshi i tha mbretit: *"O mbret fisnik e besimdrejtë, a më lejon ta shpejtoj hapin e t'i lajmëroj shokët se po vini, mos frikësohen kur t'na shohin e largohen?"* Mbreti i dha leje e ky vrapoi drejt shpellës. Hyri me një frymë dhe u rrëfeu vëllazërisë për mrekullinë e Allahut, u tregoi se si i Madhi Zot i kishte bërë shembull për mirë ndër breza duke ua ruajtur trupat për shekuj me radhë. Me ta marrë lajmin, thuhet se djelmoshat u hodhën në përqafim shoku me shokun, e lavdëruan Allahun e Lartmadhërishëm mandej e lutën t'ua merrte shpirtat, të preheshin në shpellë e të mos dilnin më prej saj. E kështu që shkruar, pra; ashtu siç ishin, mbyllën sytë së bashku për të mos u zgjuar më... Gjurmë më i bardhë e më i

lehtë s'ishte parë ndonjëherë. Emrat e djelmoshave u harruan, ama bëmat e tyre përmenden edhe sot e kësaj dite.

Atëherë, njerëzia e kuptoi se ringjallja është e sigurt dhe se Allahu i Lartmadhërishëm ka fuqi për çdo gjë. Historia e djelmoshave besimdrejtë mori dhenë, madje brezat që erdhën pas e tepruan me nderimin dhe respektin ndaj tyre. Disa thanë: *"Ndërtoni për nder të tyre një ndërtesë."* Kurse pasanikët e vendit, ata që kishin pushtetin thanë: *"Do të ndërtojmë një tempull në hyrje të shpellës."* Qëllimi i tyre ishte të tregonin se sa i nderuan, por sigurisht që gabuan. Profeti, alejhis-selam, na e ka ndaluar diçka të tillë pasi është derë prej dyerve të shirkut, që nëse hapet mashtrohet njerëzia dhe u venitet imani. Prandaj, janë të mallkuar ata që ngrejnë tempuj, tyrbe dhe xhamia mbi varret e njerëzve të mirë.

Sidoqoftë, historia e banorëve të shpellës na mëson se kush përpiqet ta ruajë fenë e tij, Allahu ka për t'ia ruajtur imanin dhe ka për ta ndihmuar kudo qoftë. Kushdo që duron vuajtjet dhe sprovat për hir të të Madhit Zot, herët a vonë do të arrijë krenarinë dhe nderimin e madh. Mandej, ajo që e pret te Allahu në Ahiret është shumë më e mirë dhe e përjetshme...

Dy komshinjtë

Bir i dashur, jeta e kësaj bote është e stërmbushur me sprova, kështu e ka caktuar i Madhi Zot... si e si të dallohet i miri nga i keqi, bujari nga koprraci, trimi nga frikacaku e kështu me radhë. Ndër sprovat e mëdha në këtë jetë janë pasuria dhe varfëria. Shumica e njerëzve nuk u bëjnë ballë ashtu si duhet e rrëshqasin, me përjashtim të atyre që pasojnë udhëzimet e Pejgamberëve. Për këtë arsye do të të rrëfej një ndër historitë e bukura të Kur'anit Fisnik, me shpresën se do marrësh mësim e në të ardhmen do të triumfosh përballë provës së pasurisë dhe varfërisë, ndaj dëgjo me kujdes!

Na ishin dy komshi. Njëri i varfër e tjetri i pasur. Ky i varfri ishte burrë fisnik dhe i devotshëm. Trupin e kishte të lidhur, faqet e rreshkura nga dielli, pëllëmbët me kallo nga puna dhe një familje mbi shpinë që i priste të gjitha nga duart e tij. Një thes me halle mbante fisniku. Megjithatë, zemrën e kishte të mbushur plot me gaz dhe iman. Priste e përcillte mysafirë me ç'i kishte dhënë Zoti.

Komshinë e kishte pasanik, të kamur, me gjë e mall shumë, me shërbëtorë, robër, fëmijë e nipëri. Edhe flori kishte plot. Burimi i pasurisë së tij ishin dy bahçe përplot fruta e hardhi me kalaveshë rrushi që kacavareshin deri poshtë. Rreth e për-qark kishte palma hurmash arabe dhe mespërmes bahçeve gjarpëronin kroje me ujë të kulluar si loti, prandaj mos pyet për frutat... si ia donte zemra: të mëdha, të paprekura nga krimbi e sëmundja, të ëmbla mjaltë e me bollëk, vareshin gati

për t'i këputur. Mirëpo pasuria e madhe e kish dehur dhe ia kish marrë mendjen. Në vend që të falënderonte Zotin, për mirësitë e bereqetin e bahçeve, filloi të krekosej e të mbahej me të madh, duke harruar Allahun dhe Ahiretin.

Sot kështu, nesër ashtu... Një ditë pasaniku, ndërkohë që kthehej nga pazari, pa nga larg komshinë e tij. E thirri në emër e ky iu afrua. U përshëndetën e morën rrugën për shtëpi. Pasaniku, duke u mbajtur me të madh, zuri ta thumbonte me fjalë.

– *Eh more komshi! - iu drejtua të varfrit. - Unë kam pasuri më shumë se ti dhe kam krah më të fortë se ti, kam fis të madh e s'më prek kush kollaj.*

Komshia i varfër vuri buzën në gaz, por nuk ia prishi. "I mjeri ky, – mendoi me vete, – E ka marrosur ari dhe argjendi të shkretin. Veç sikur ta dinte se çfarë është pasuria e vërtetë!"

Teksa po mbërrinin, pasaniku e mori për krah komshinë e varfër dhe i tha me krenari:

– *Eja, eja! Mos ik ashtu, eja shih mrekullitë e kopshtit tim! Eja të shohësh kalaveshët me rrush, frutat e hurmat e Arabisë! Eh more mik, sa bereqet kam pasur sivjet!"*

– *Lum për ty ore mik! - ia priti komshia i varfër, - Mirësi të madhe të paska dhënë i Madhi Zot.*

Pasaniku vërejti ballin e trashi zërin:

– *E cili Zot? Kopshtin e kam punuar me dorën time. Kushedi sa djersën e kam nxjerrë, e ti më përmend Zotin.*

– *Po kush ta dhuroi forcën, o i mjeri ti? Kush e urdhëroi farën të mbijë, filizin të rritet, sythin të shpërthejë, pemën të hedhë shtatin e të lidhë frutat? Kush i urdhëroi burimet të shpërthejnë mes e mes bahçeve tuaja? - mendonte i varfri, - Mandej kushedi sa e sa të tjerë janë më të fortë se ti, mu-*

ndohen më shumë dhe kanë tokë më të gjerë se zotrote, ama nuk e kanë këtë bereqet. E gjithë kjo është mirësi e Allahut të Lartësuar.

Biri im! Pasuria e madhe është sprovë, sepse njeriu fillon e ndjehet i pavarur nga Zoti i Lartmadhërishëm. Sa më shumë i jep Allahu, aq më shumë ndjen se nuk i vyen më Krijuesi dhe Furnizuesi i tij. Këtij pasaniku Allahu i kishte dhënë pasuri marramendëse, mirëpo pasuria e kishte magjepsur. E ndjente veten të plotfuqishëm dhe as që i shkonte ndër mend t'ia shtrinte dorën e ndihmës atij që kishte nevojë. Mjerë për ty po u bërë i tillë, o bir!

Pasuria është mjet nëpërmjet të cilit njeriu duhet të bëhet rob më i përkushtuar ndaj Allahut dhe më i mëshirshëm ndaj krijesave të Tij. Ç'të duhet pasuria nëse bëhesh mendjemadh, nëse në emër të pasurisë e harron Zotin dhe i nënçmon të varfrit?!

Kurrë mos harro! Fisnikut të vërtetë sa më shumë t'i shtohet pasuria aq më shumë i shtohet kujdesi karshi Allahut dhe nevojave të atyre që ka përreth. Dije se kush jep dhe falënderon Allahun, Ai ia shton të mirat dhe i dhuron bereqet. Ndaj të porosis të bëhesh bujar, të falënderosh të Madhin Zot e të mbash kokën ulur para punëtorit që e fiton bukën e gojës me djersën e ballit.

Ec e ec dy burrat hynë thellë e më thellë në kopsht. Ndërsa dëgjonte bilbilat tek ia kishin shtruar këngës mbi degë dhe burimet që gurgullonin për shtatë palë qejfe, ndërsa shihte kopshtin e veshur me gjelbërim, vesën që kishte mbuluar barrin e njomë, hardhitë me rrush të freskët, pemët përplot fruta dhe hurmat që vareshin nën palma, pasaniku mori vrull për të dytën herë e i tha komshisë:

– Eh more mik! Unë nuk besoj se do të bëhet ndonjëherë Kiameti.

I varfri uli shikimin, vrenjti ballin, por përsëri nuk foli.

- Sidoqoftë, - ia priti pasaniku, - edhe nëse kthehem i ndonjëherë te Zoti, s'do mend se andej do të gjej mirësi e pasuri pafund, më shumë se ç'kam sot.

I mjeri pasanik! Kështu mendon mendjelehti. Vallë, kush gëzon të mira në këtë botë duhet t'i ketë edhe në Ahiret?! Përkundrazi, Pejgamberi, alejhis-selam, na mëson se dynjaja, me gjithçka në të, nuk ka peshë tek Allahu as sa flatra e një mushkonje. Sikur të kishte vlerë më të madhe se kaq i Lart-madhërishmi as ujë për të pirë s'do i kish dhënë jobesimtarit, të ligut e mendjemadhit. I Madhi Zot ia hap dyert e dynjasë besimtarit e jobesimtarit, të mirit e të keqit, fisnikut dhe faqeziut, mirëpo mirësia e Ahiretit do të jetë vetëm për besimdrejtët, mirëpunuesit dhe bujarët.

O bir! Mos harro se një hapësirë toke sa një bastun në Xhenet është më e mirë se dynjaja me ç'ka në të. A e ka pasur ndokush në histori të njerëzimit krejt dynjanë?! Paramendo sa i pasur je ti! Kështu na mëson Profeti, alejhis-selam.: "Pasuria e vërtetë është pasuria shpirtërore." Kushedi sa njerëz i kanë xhepat plot, por janë të varfër. Sa e sa të tjerë janë të varfër, nuk i kanë as dy grosh, ama janë të pasur, pasi nuk lakmojnë, nuk shiten dhe as nuk blihen me ar e me argjend.

- A po tregohesh mosmirënjohës ndaj Atij që e krijoi njerëzinë nga dheu? - ia ktheu besimtari - Si është e mundur të mos ia dish për nder Atij që të krijoi nga një pikë uji dhe u përkujdes për ty, derisa u burrërove?

Pasaniku bëri të fliste, por komshia ia mori fjalën dhe iu drejtua për së dyti:

- Si ke kurajo ta mohosh ringjalljen dhe guxon të tallesh kur thua se Ahireti do jetë edhe më i mirë për ty?

- O komshi!, - i foli me zjarr të zemrës, - Pasuria dhe kopshti yt as që më hyn në sy, mor mik. Allahu, Zoti im ma

ndriçoi zemrën me iman, e kjo është mirësia e mirësive veç sikur ta dije! Kopshti yt me gjithçka ka në të nuk krahasohet as me një pëllëmbë toke nga kopshtet e Xhenetit të Adnit që i Madhi Zot i ka përgatitur për besimdrejtët!

Subhanall-llah! Shiko krenarinë e besimtarit, o bir! Nuk është e lehtë që një njeriu shumë të pasur e shumë të fuqishëm t'i drejtohesh në këtë mënyrë.

Mbaje mirë në mend këtë që po të them: Krenaria është ndjenjë e vazhdueshme në zemrën e njeriut, por nganjëherë është e lëvduar e nganjëherë jo. A e ke pyetur veten se nga buron krenaria e jobesimtarëve? Mot dhe sot, krenaria e tyre buron nga pasuria dhe kallaballëku që kanë. A nuk e dëgjove pasanikun se si u mburr me pasuri dhe krah të fortë?! Sa më shumë kanë, aq më të fortë ndihen.

Ndërsa krenaria e besimtarit buron nga feja dhe adhurimi i Allahut, nuk ka rëndësi në ka shumë apo pak. Të jesh i varfër nuk është turp, por turp është ta keqpërdorësh atë që ta ka dhuruar Zoti.

– O mik!, – i tha i varfri, – *Përse nuk thua para se të hysh në kopshtin tënd: Ma sha Allah. La haule ue la kuvete il-la bil-lah! Pasi vetëm Allahu bën ç'të dëshirojë e nuk ka fuqi apo lëvizje, veçse me lejen e Tij. Nëse jam më i varfër se ti dhe kam më pak fëmijë, unë shpresoj se për mirënjohjen time ndaj Tij, Allahu do më japë shpërblim më të vyer se kopshti yt.*

Ky i varfër na mëson se si t'i bëjmë ballë sprovës së varfërisë, sepse nganjëherë ajo është më e rëndë se sprova e pasurisë. Ai nuk e lakmonte pasurinë e komshisë. Asnjëherë nuk i tha *"i lumi ti për kopshtin që ke!"*

Kështu edhe muslimani tregohet krenar dhe nuk e lakmon pasurinë e tjetrit, veçse në një rast... kur e sheh dikë, që begatitë e Zotit po i shfrytëzon për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe mirësinë e Ahiretit. Asgjë tjetër nuk guxon të jetë objekt lakmie. Nëse e lakmon je sprovuar me sëmundjen e varfërisë.

Ushqeje zemrën me mendim të mirë për Allahun e Lartësuar. Bindja se Allahu na paguan për çdo nijet, fjalë apo vepër të mirë na bën të pasur, o bir.

– O mik! – iu drejtua i varfri për të fundit herë, – *Kam frikë se për shkak të mosmirënjohjes e mendjemadhësisë, kopshtin tënd mund ta godasë dënim nga qielli, që do ta bëjë tokë të djerrë, do të shkatërrohen të mbjellat, uji do të fshihet në thellësitë e tokës dhe krojet do të shteren!*

Pasaniku mbeti pa fjalë. Ndërsa i varfri e përshëndeti, doli nga kopshti dhe u largua.

Me sa shihet ky besimtar me të vërtetë ishte i varfër, ama kishte njohuri të thellë mbi ligjet e Allahut Fuqiplotë. E dinte mirë se kush e konsideron veten të pamposhtur e ka fundin afër.

Nuk kaloi shumë dhe ajo që pati frikë besimtari u realizua. Një natë prej netësh thuhet se filloi një stuhi e llahtarshme. Fërshëllente nëpër qiell dhe lëvizte retë gjigante si të ishin anije në det.

Shkrepëtinin vetëtimat si gjarpërinj dhe krisnin bubullimat sa vrungullonin kodra e male. Stuhi dhe shi i tillë nuk ish parë as nuk ish dëgjuar. U tmerrua njerëzia dhe u strukën me frikë në shtat. “*Natë si kjo mos ardh të kurrë në botë!*” dëgjoheshin zërat e shkretë të fshatarëve.

Mirëpo, kur u venit nata e lindi dita, rrezet e diellit i shqyen retë dhe ia kthyen gazin përsëri njerëzisë. “*Kopshti!*”, briti pasaniku, “*Ç’do t’i ketë ndodhur kopshtit tim?*” U vesh me të shpejtë dhe u nis fluturimthi drejt bahçeve. Ç’të shihte se? I gjithë kopshti, me fruta e pemë, kishte gdhirë si i kositur e i shkretë, duke mos mbetur asgjë nga mirësitë e tij. I tillë është dënimi për çdo mosmirënjohës që nuk i frikësohet Allahut të Lartësuar. Ama ndëshkimi i Ahiretit do jetë shumë herë më i madh, veç sikur ta dinin!

Kur e pa se çdo gjë kishte marrë fund iu ftoh zemra. I penduar përplaste shuplakat, por kopshti s'kthehej më. *"Ah i mjeri unë, i mjeri!",* thoshte miku. *"M'u shua pasuria."*

"Ah i mjeri unë, i mjeri, sikur t'i besoja Zotit tim, e të mos e mbaja shpresën te krahët dhe shërbëtorët e mi!"

Kështu pra, askush nuk e mbrojti nga dënimi, ndërkohë që më parë i krekoj komshisë së tij për pasuri dhe krah të fortë. E kush mund të ngadhënjejë mbi fuqinë e Zotit të Lartmadhërishëm?!

Gjithsesi, mëshira e Allahut është e madhe. Thuhet se pasaniku u kthjellua nga kjo goditje, u pendua dhe u përudh në rrugën e drejtë. Allahu ia pranoi pendimin, ia pastroi zemrën, ia largoi mendjemadhësinë dhe ky u përmirësua.

Dhulkarnejni

Biri im! Kur të bëhet Kiameti, malet e larta do të thërrmohen e do bëhen hi e pluhur, detet do të avullojnë dhe do të thahen, yjet do ta humbin ndriçimin e do veniten, pemë e gjelbërim nuk do të ketë më, toka do të shndërrohet në një tjetër; e bardhë dhe e pastër, e do t'i nxjerrë të vdekurit e të varrosurit që ka mbajtur në barkun e saj, sikurse bimët. Qiejt do shndërrohen në të tjerë qiej, e njerëzia do të llahtariset. Sytë do të shtangen tek vështrojnë qiellin, shikimet do shuhen nga tmerrri dhe zemrat do ftohen nga lemeria. Qielli do pëlçasë, do zbresin melekët dhe do rreshtohen për qark skajeve të Tokës, duke pritur fillimin e llogarisë. Njerëzit do rendin të hutuar sa andej këndej si grumbull insektesh. Atë ditë do ta zbresin Arshin e Allahut tetë melekë madhështorë. *"Nga t'ia mbathim për të shpëtuar?!"*, do të bërtasë njerëzia. Mirëpo, kot e kanë, atë Ditë nuk mund të fshihet askush. Ndërkohë, dielli do u afrohet krejt pranë, një milje mbi koka aspak më shumë. Trupat do rreshken dhe do mbulohen nga djersa. Atëbotë nuk ka hije tjetër veç hijes së Arshit Madhështor. Ama, askush nuk mund të strehohet në hijen e Arshit pa dëshirën e Allahut... melekët nuk bëjnë lëshime. A e di ti o bir, se cilët do jenë njerëzit që do kenë fatin të fladiten, Ditën kur njerëzia do të zhytet në djersë? Kush do të jenë ata që do shpëtojnë nga dënimi vallë? Ndër fatlumët e asaj Dite, ndër të nderuarit nën hijen e Arshit do jenë prijësit besimdrejtë, ata të cilët nuk u mbajtën me të madh dhe vendosën drejtësi në mesin e popullit. Pikërisht për

njërin prej tyre na rrëfen Allahu i Lartësuar në suren “Kehf”, që të marrin mësim njerëzit me pozitë e të jetë shembull i mirë për këdo që lexon historinë e tij.

Po kush është ky burrë, bëmat e të cilit i përmend i Madhi Zot në Kur'anin Famëmadh? Ky është Dhulkarnejni. Mbreti që mbushi Tokën me drejtësinë e islamit. Burri me hijen e rëndë që ia kalte datën armikut. Fisniku, emri i të cilit mori dhenë, që ku lind dielli e deri ku perëndon. Të kam pasë rrëfyer edhe më parë për të. Besoj se e mban në mend se si e ngriti digën e madhe kundër vërshimit të Jexhuxh-Mexhuxhëve, apo jo? Gjithsesi, tash do të të rrëfej edhe për të tjera bëma të këtij mbreti fisnik, për tri udhëtimet e tij rreth e përqark botës në përhapjen e të mirës, madje edhe më shumë se kaq.

Biri im! Dhulkarnejni ishte burrë mendjendritur dhe i guximshëm, gjithmonë në krye të ushtrisë, përherë ballë për ballë armiqve. Ishte njeri i devotshëm, prijës i drejtë dhe i çiltër. Miq e armiq e çmonin dhe kërkonin gjykimin e tij. Kushdo që ulej me të për ndonjë hall, e dëgjonte me kujdes e kurrë nuk ia ndërprente të folurin. I dashur me ushtarët, ulej së bashku me ta si të ishte njëri prej tyre. Nëse i kërkonin diçka që e kishte ia jepte e nëse nuk kishte i ngushëllonte me fjalë të mirë. E ruante gjuhën nga fjalët boshe. Kur fliste, të tjerët heshtnin dhe e dëgjonin me vëmendje, derisa mbaronte. Ishte i matur dhe i palëkundur në vendim. Nxiste për mirë dhe e urrente të keqen, ndaj të gjithë ushtarët e donin dhe ishin të gatshëm ta jepnin jetën për të.

Dhulkarnejni kishte ushtri të stërmadhe e të mirëorganizuar, të gjithë trima të paepur, të armatosur gjer në dhëmbë. Mos pyet për sundimin e tij? Nga lindja në perëndim. Allahu ia mundësoi t'i thyente armiqtë, t'i nënshtronte perandoritë anembanë botës dhe t'i mposhte idhujtarët. Ia mundësoi të udhëtonte në çdo skaj të rruzullit dhe njerëzit t'i bindeshin.

Marshoi në përhapjen e islamit drejt perëndimit, gjersa pa brigjet e oqeanit, atje ku dielli dukej sikur po zhytej në një burim me lym të zi. Kishte marrë vesh, se në ato troje sundonte një mbret tiran, që mbahej me të madh, një gjakatar që shtypte besimtarët dhe i thërriste në mosbesim. Tek u printe ushtarëve shaluar mbi gjokun e tij, papritmas ia tërhoqi fort frerët dhe kali e ndali trokun. Seç kishte parë tej. Nuk vonoi shumë kur ja, një kalorës sa vinte e afrohej. Ecte me galop, derisa erdhi afër mbretit. Në dorë shtrëngonte një pergamenë të vulosur me dyllë. Dhulkarnejni u bëri me shenjë ushtarëve të qëndronin në vend e të mos lëviznin, ndërkohë vetë madhëria e tij bëri disa hapa, derisa shkoi krejt pranë ushtarit të huaj. Trimat shihnin me kërshtëri nga larg komandantin e tyre tek këmbente fjalë me të panjohurin, por asgjë nuk dëgjohej. Mandej ushtari i dha pergamenën. Komandanti e tendosi me maturi e zuri ta lexonte. Pasi e përfundoi, e përshëndeti me fisnikëri ushtarin, i ktheu shpinën dhe u kthye nga trimat e tij që prisnin me padurim.

– *Bëhuni gati o burra!* – u foli komandanti, – Do bëhet luftë e madhe.

– *Gati na ke, o kapedan!* – buçiti zëri i ushtarëve, që ia forcoi dhe ia ngrohu zemrën edhe më shumë Dhulkarnejnit.

– *Atje tej, mbas asqj kodrine,* – u bëri me shenjë komandanti, – *na pret armiku në fushë të mejdanit. Dëshirova të bisedoj me mbretin e tyre, por shkresa e tij ishte e prerë: Nuk ka kurrfarë bisedimesh mes nesh, nëse kaloni kodrën ju pres me një ushtri të pamëshirshme. Ose të ktheheni, ose luftë e gjak!*

– *Luftë kërkon e luftë do ketë, o kapedan!* – brohoriti me zjarr ushtria.

Si një trup i vetëm, me Dhulkarnejnin në krye, u nisën e nxituan që të arrinin sa më shpejt në fushë të mejdanit. Vërshtuan

muslimanët e u tërbua dushmani. U lëshua Dhulkarnejni me trima dhe çanë me shpata radhët e armikut. U nxehën gjakrat e u bë vdekja si buka e ngrohtë. U ngatërruan ushtritë e krisi lufta si mos më keq. Mirëpo muslimanët e morën para armikun. Dhulkarnejni luftoi si burrë. Kushedi sa armiq shtriu përdhe e sa të tjerë plagosi me shpatë! Nuk kaloi shumë dhe idhujtarëve u hyri frika gjer në palcë. Të vdekurit shtriheshin sa andej këndej si gjethet e vyshkura që përhap era vjeshtake, ndërsa të tjerët ia mbathën të lebetitur, po ku të iknin se?! Ushtria muslimane i kishte rrethuar nga të katër anët. Kështu, dushmani u thye dhe muslimanët ngadhënjyen. Nuk numëroheshin robërit, e nuk peshohej plaçka e luftës kaq shumë ishte.

Mirëpo Dhulkarnejni nuk ishte inatçor, as gjakatar, se ishte musliman. Megjithëse kishte mundësi t'i vriste kundërshtarët menjëherë, nuk e bëri. Përkundrazi i thirri robërit në islam, që të fitonin lirinë, të nderoheshin në dynja dhe të shpëtonin në Ahiret. Ai ishte mbret i urtë dhe gjykatës i drejtë, i cili nuk kërkonte hakmarrje, por vetëm kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

"O njerëz! – kumboi zëri i mbretit, – Atë që adhuron të tjerë veç Allahut, u bën padrejtësi besimtarëve dhe këmbëngul në idhujtari, do ta dënojmë, mandej kur të kthehet tek i Madhi Zot dënimin do ta ketë edhe më të tmerrshëm. Ndërsa ai që i beson Allahut, e adhuron të Vetëm e të Pashoq dhe është mirëpunues, në Ahiret shpërblim do ketë Xhenetin, ndërsa ne do t'i japim dhurata, lehtësira dhe do t'i drejtohem me dashuri dhe butësi."

Thuhet se ky popull e pranoi islamin dhe u përmirësua. Për sundimtar Dhulkarnejni u caktoi njërin nga komandantët e tij më besnikë, i cili përhapte drejtësinë dhe u bë i dashur në mesin e tyre.

Subhanall-llah! Sa fisnik ishte Dhulkarnejni! Nuk shfrytëzoi dobësinë e tyre për t'i plaçkitur, por u bë dritë udhëzimi dhe burim mirësie për ta. Ai nuk ishte lakmitar, as grykës e i pangopur, sikurse mbretërit dhe sunduesit jomuslimanë mot edhe sot. Këta, o bir, i shohin popujt e dobët si pré të tyren, ndaj edhe u vërsulen dhe, pasi i shqyejnë, ua zhvasin pasuritë. Kush i vrau fiset Maja dhe Acteke?! Kush i shfarosi indianët lëkurëkuq në Amerikë?! Kush ua mori tokat indigjenëve në Australi?! Kush i robëroi afrikanët duke i shitur në tregun e skllëvërve, si të ishin kafshë të egra?! Pse vallë vdesin nga uria ndërkohë që trojet e tyre janë të stërmbushura me pasuri minerale, ar dhe diamante?! Sepse sundimtarët që nuk pasojnë fenë e vërtetë e shohin këtë jetë si një sofër të shtruar, si një pasuri pa zot, ndaj o burra kush të zhvasë më shumë.

Ndërsa Dhulkarnejni e shihte këtë botë si pronë e Allahut, ku ai nuk ishte tjetër, veçse një rob i të Madhit Zot, një mëkëmbës i Allahut në tokë. Ai e shihte këtë jetë si burim mirësie, ndaj u mundua të shfrytëzonte çdo mundësi për t'i ndihmuar të shtypurit dhe për të përhapur fenë islame anekënd e kështu të fitonte kënaqësinë e Allahut të Lartmadhërishëm.

Kur u vendos rendi dhe drejtësia në Perëndim, Dhulkarnejni ia mësyu Lindjes. Ec e ec arriti, me ndihmën e Allahut, në disa troje për të cilat asnjë banor i Tokës nuk kishte dëgjuar dhe as që kish shkelur këmbë njeriu më parë. Thuhet se mbërriti në lindje të Afrikës Jugore. Atje gjeti një popull primitiv, disa njerëz të egër, që nuk kishin shtëpi, nuk mbanin petka për t'u mbuluar nga turpi dhe as për t'u mbrojtur nga dielli, por jetonin nëpër shpella lakuriq.

Bir i dashur, dihet pak për bëmat e Dhulkarnejnit në tokat e Lindjes, ama një gjë është e sigurt, ngado që shkonte qëlli-mi i tij ishte përhapja e drejtësisë. Kushedi sa male, sa lugina, sa toka të shkreta dhe sa kontinente përshkoi? Kushedi se sa është lodhur mbreti fisnik? Vetëm për t'iu bërë krah të dobët

e të shtypurit ka udhëtuar natë e ditë, vetëm për të shkukur të keqen që kanë mbjellë të tjerët, ka marshuar nga lindja në perëndim...

Po ti, o bir, sa përpiqesh ta luftosh të keqen në zemrën tënde? Duhet lodhje e sakrificë nëse dëshiron të bëhesh i mirë... të falesh, të agjërosh, të lutesh vazhdimisht. Me mijëra kilometra ka përshkuar Dhulkarnejni për ta përhapur të mirën. Ti mund të thuash se jam i vogël e nuk kam mundësi t'ua zgjidh hallat njerëzisë... Ndoshta të udhëtosh nga lindja në perëndim je i vogël, ama të luftosh të keqen që lind shpeshherë në gjoksin tënd nuk je i tillë.

Pastaj marshoi me ushtrinë e tij drejt veriut deri sa arriti ndërmjet dy maleve që shtriheshin ballë për ballë. Thuhet se ka mbërritur deri afër Liqenit Kaspik. Atje e priti një popull që nuk kuptonte ndonjë gjuhë tjetër veç të vetës. Me sa shihej ishin në hall të madh. Në fytyra u lexohej frika e trishtimi. Mundoheshin të komunikonin me mbretin, ama as edhe një fjalë të tyren nuk e kuptonte Dhulkarnejni. Kushedi se sa përkthyes angazhoi mbreti si e si të merrte vesh hallin e tyre, t'i përkrahte!

Biri i dashur, shih çfarë shembulli! Megjithëse mbreti nuk kishte kurrfarë lidhjeje me ta, megjithëse ishin jobesimtarë i ka dëgjuar me kujdes dhe i ka ndihmuar. Besimtari është i ndjeshëm ndaj padrejtësive edhe nëse i bëhen jobesimtarëve, o bir. Ai përpiket ta largojë të keqen me çdo kusht: me dorën apo me gjuhën e tij. E nëse nuk ka mundësi ta largojë të keqen e urren me zemrën e tij.

Po ti a nuk e gjen pak durim ta dëgjosh prindin, vëllanë e vogël, motrën e vetme apo shokun kur e ka ndonjë telash që t'i bëhesh krah?

Të parët e fisit kishin dëgjuar për drejtësinë e Dhulkarnejnit dhe për ushtrinë e paepur që e ndiqte, ndaj e pritën me nderime. I bënë vend në krye të sofrës ashtu si i ka hije fisnikut

dhe tek bisedonin me përkthyesit e mbretit, iu ankuan për Jexhuxhët dhe Mexhuxhët. *"O mbret, – i thanë, – Jexhuxhët dhe Mexhuxhët po bëjnë kërdrinë: na plaçkitën pasurinë dhe na vranë rininë. Ne nuk mund t'i bëjmë ballë se janë më të shumtë se rëra dhe më të egër se ujku. A mund të ndërtosh një digë ndërmjet nesh, që të shpëtojmë një herë e mirë prej tyre? Kërko sa të duash e do të ta japim!"* Dhulkarnejni u tha: *"Shpërblimi i Zotit tim është shumë më i mirë se i juaj! Do ju ndihmoj për hir të të Madhit Zot, po ju më ndihmoni me fuqi punëtore se ushtria ime nuk ia del e vetme."*

Biri im! Nuk ka punë të mirë që e bën njeriu në emër të Allahut e mos të shpërblehet nga Zoti. Ama nganjëherë ky shpërblim vonohet dhe nuk vjen aty për aty. Kështu, kur u jepet njerëzve të zgjedhin mes asaj që është e vonuar dhe asaj e që është e prekshme, ata menjëherë i japin përparësi të prekshmes. Ky mbret e mësoi njerëzinë se jo gjithmonë shpërblimet e kësaj bote duhet të jenë ato që e joshin besimtarin. *"Ajo që më jep Zoti është më e mirë për mua."* Sa e bukur është kjo fjalë, veçanërisht kur përballemi me haramin. Ndaj sa herë të të shtyjë shejtani drejt së ligës edhe pse është joshëse dhe fitimprurëse, thuaj: *"Ajo që më jep Zoti është më e mirë për mua."* Lakmia e shpërblimit të Allahu i venit të gjitha lakmitë e tjera.

Bir i dashur! Megjithëse e kishte hak dhe të lejuar të merrte shpërblim për ndërtimin e digës, hoqi dorë nga e drejta e tij, si e si t'ua fitonte zemrat jobesimtarëve e t'u fliste për Allahun. A nuk ia vlen që edhe ti të heqësh dorë nga e drejta jote e t'ua fitosh zemrat atyre që ke përreth?! Tejkaloji problemet, dhe hapi rrugë pajtimit dhe vëllazërimit, nën hijen e shpërblimit të Allahut. Mos harro premtimin e Profetit, alejhi-selam: *"Unë i garantoj shtëpi në zemër të Xhenetit atij që ia pret hovin vetes në diskutime edhe nëse ka të drejtë."*

"Më sillni copa të mëdha hekuri!" – u tha mbreti. Pasi u

grumbullua metali, Dhulkarnejni urdhëroi të vendoset me mjeshtëri ndërmjet dy maleve prej nga vërshonin Jexhuxhët dhe Mexhuxhët. Mandej dha urdhër që të ndizej një zjarr i llah-tarshëm që të shkrihej hekuri dhe të ngjiteshin copat e metalit njëra me tjetrën. *“Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedh murit prej hekuri që të bëhet i lëmuar!”* - urdhëroi përsëri mbreti dhe ashtu u bë. Për pak kohë Dhulkarnejni ndërtoi një digë kaq të fuqishme, saqë asnjë forcë njerëzore, asnjë armë dhe asnjë ushtri s’do mund ta shkatërronte, as ta kapërcente dhe as ta shponte. Ndërtoi aso dige, e cila do të mbronte jo vetëm të ngratët që i kërkuan ndihmë, por krejt njerëzinë deri pak para Kiametit nga sulmi i fiseve gjakatare Jexhuxh-Mexhuxh.

Le të luftojmë, pra edhe ne, nën dritën e këtij shembulli për brezat që vijnë pas nesh, o bir! Le të punojmë natë e ditë për ndërtimin e digave, që i mbrojnë njerëzit nga veset e ulëta dhe punët e mbrapshta! Kush me penë, kush me fjalë, kush me pasuri dhe kush me shembull të mirë. Të përpiqemi me mish e me shpirt në përhapjen e drejtësisë dhe shkuljen e të keqes. Ky është një nga qëllimet madhore të muslimanit: kudo qoftë t’i bëhet krah hallexhiut, kudo qoftë t’ia përkujtojë njerëzisë Allahun dhe Ahiretin, që të lidhen me Zotin e t’i largohen të ligës.

Kur i pa njerëzit të mrekulluar përballë digës, mbreti besimdrejtë iu drejtua dhe i tha: *“Kjo është mirësia e Zotit tim, o njerëz.”* Thuhet se më pas ra në sexhde në shenjë falënderimi, meqë Allahu Fuqiplotë ia mundësoi të shpëtonte njerëzinë nga ligësia e Jexhuxh-Mexhuxhëve. Pasi e ngriti ballin nga toka u tha për së dyti: *“E, kur të vijë urdhri i Zotit tim, diga do të shkatërrohet... Me të vërtetë caktimi i Zotit tim është i sigurt.”*

Mbretërve fisnikë, kur Allahu u dhuron pushtet, u shtohet mirënjohja dhe nënshtrimi ndaj Zotit. Besoj se të kujtohet se ç’tha Sulejmani kur ia sollën fronin e Belkizes apo jo? *“Kjo*

është dhunti nga Zoti im. Ai po më sprovon mua se a do të jem mirënjohës apo mendjemadh. E kush falënderon, për vete e ka... E kush tregohet mendjemadh, për vete e ka... Allahu është i pasur e s'ka nevojë për askënd."

Nga ana tjetër, mbretërve të padrejtë pushteti ia shton edhe më shumë mendjemadhësinë dhe tiraninë, e harrojnë Allahun dhe e shtypin popullin.

Biri im! Kushdo që lufton për famë dhe pozitë, herët a vonë harrohet. Ndërsa kush kërkon kënaqësinë e Allahut dhe lufton për të mirën e njerëzisë, Allahu ia mban emrin gjallë edhe pas vdekjes së tij. Kushedi se sa shekuj kanë kaluar nga koha e Dhulkarnejnit, ama edhe sot e kësaj dite i përmendet emri dhe u këndohet bëmave të tij...

Porosia e Babës

Na ishte dikur një njeri i mirë. Zemërbardhë, i matur e i ditur ishte fort. Lukman ia thonin emrin. Allahu i kishte dhuruar urti të madhe, e kështu Lukmani i përkushtohej të Madhit Zot dhe ia bënte shqyrrin nimetit.

“Tregohu mirënjohës ndaj Allahut për mirësitë e panumërta me të cilat të ka rrethuar dhe për urtësinë e madhe që ta ka dhuruar, - i pëshpëriste herë pas here zemrës, - sepse kush tregohet mirënjohës Zoti ia shton mirësitë. Ndërsa kush tregohet mosmirënjohës dhe bukëshkelur, veç veten dëmton. Falënderimi i robit nuk ia shton pasurinë Zotit... e mohimi nuk i pakëson Atij asgjë!”

Thuhet se një ditë, zotëria tek i cili punonte Lukmani, për të provuar urtësinë dhe mençurinë e tij i tha: *“There një dele, piqe mishin e saj e mandej më sill dy pjesët më të mira, për meze!”* Lukmani iu bind urdhrit. E theri bagëtinë, e poqi dhe i solli zotërisë gjuhën dhe zemrën. Ditën tjetër zotëria e thirri përsëri. *“Lukman, sot dua të më bësh kurban një dele tjetër, - i tha, - ta pjekësh dhe të më shërbesh dy pjesët më të këqija nga trupi i saj!”* Nuk kaloi shumë dhe erdhi Lukmani me meze, por si për çudi kishte sjellë gjuhën dhe zemrën. Kur pa zotëria përsëri gjuhë dhe zemër e pyeti burrin e urtë: *“Pse më solle zemrën dhe gjuhën edhe sot o Lukman? A nuk ishin pjesët më të mira dhe?”*

“Epo nuk ka më të mirë se zemra e bardhë dhe gjuha e drejtë, o zotëri, ashtu siç nuk ka më të keqe se zemra e zezë dhe gjuha e prishur.”

Një djalë i kish falë i Madhi Zot Lukmanit, ndaj e kishte mbi krye e sipër. Burri i urtë i rrinte kurdoherë pranë të birit, që t'i bëhej dritë udhëzimi dhe burim mirësie. E edukonte djaloshin dita-ditës nën hijen e dashurisë dhe mëshirës prindërore. Dinte si t'ia hapte zemrën të birit e t'i hynte në thellësitë e saj. Fjalët i kishte të këndshme si uji i krojeve në pranverë, melhem për të birin. Kështu e rriti shtatin djali i Lukmanit, në prehrin e një babe besimtar që e ushqente me dashuri për imanin dhe urrejtje për shirkun, me një babë që e urdhëronte për namaz dhe e këshillonte për durim e punë të mirë. Me gjithë angazhimet e tij, kurdoherë ndante kohë të ulej e të bisedonte me të birin.

Një ditë, teksa rrinte me djalin e tij, e shikoi me sytë e mallit e tha:

– O bir i shtrenjtë! Nuk do më kesh gjithmonë pranë të ta mbaj krahun, ndaj po ta lë një porosi. Vare vath në vesh e kurrë mos e harro!

– Ashtu do bëj, o babë i dashur, as mos e ki merak. – i tha i biri tek e shihte në sy të atin.

– O bir i shtrenjtë! – iu drejtua Lukmani djalit, “Mos i bëj shirk Allahut, se shirku është padrejtësia më e madhe! Nuk ka poshtërsi më të madhe se të adhurosh krijesat në vend të Atij që të ka krijuar. Nuk ka paturpësi më të madhe se të jetosh në tokë të Zotit, të shfrytëzosh të mirat e Tij e mandej të madhërosh e përlëvdosh të tjerë veç Tij. Allahu na ka krijuar për ta njohur dhe për ta adhuruar. Kush e çon në vend amanetin e Zotit do jetë përherë i nderuar, ama kush e harron Allahun e zhytet në errësirën e idhujtarisë e ka poshtëruar shpirtin e tij dhe vetvetes i ka bërë zullum. Allahu nuk e fal kurrë shirkun, o

bir. Kështu kurrë mos mendo se bashkë me Allahun mund të ketë zota të tjerë që mund t'i adhurosh e t'i lusësh, se bëhesh i përbuzur tek i Madhi Zot, e humb dynjanë dhe Ahiretin.

– O bir i shtrenjtë, çfarëdo që të bësh, qoftë e mirë apo e keqe, sado e vogël qoftë, edhe në peshoftë sa një farë liri, e të fshihet poshtë ndonjë shkëmbi gjigant prej nga s'e sheh askush, të fluturojë diku lart nëpër qiej apo të zhytet në thellësitë e tokës, Allahu ka për ta nxjerrë në shesh, në Ditën e Gjykimit. Atë Ditë, i Madhi Zot do të vendosë peshoret e drejtësisë për të peshuar veprat e robërve. Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi duke ia pakësuar shpërblimin për të mirat apo duke ia shtuar dënimin për të ligat. Atë Ditë do të peshohet çdo vepër, edhe ajo që peshon sa fara e lirit, ndaj kujdes bir! Ruaju nga e liga, se Allahu të vëzhgon kudo! Mund t'i fshihesh njerëzisë, por jo të Madhit Zot.

O bir i shtrenjtë! Fale namazin me rregull, me ngadalë e me qetësi, mbasi namazi është shtylla e fesë. Nëse kjo shtyllë është e fortë dhe e qëndrueshme, ashtu do jetë edhe feja. Ky adhurim është burimi i fuqisë së besimtarit, prandaj Allahu i Lartësuar na e bëri obligim faljen e tij gjatë ditës dhe natës. Gjatë namazit robi kuvendon me Zotin e tij, ndaj trego kujdes të madh! Mendo me vete se kujt po i drejtohesh, mendo madhështinë e Atij që të vëzhgon teksa qëndron në këmbë, të dëgjon tek e lavdëron në ruku dhe sexhde, madje ka dituri edhe për gjithçka çfarë të pëshpërit zemra. Dije se namazi është porosia e parë, për të cilën do të pyetesh në Ditën e Gjykimit... Nëse e ke kryer me përkushtim, llogarinë do ta kesh të lehtë, por nëse namazin e ke falur shkel e shko, llogarinë do ta kesh të rëndë e të vështirë. Namazi me përkushtim të dli rëson nga sjellja e keqe dhe veset e ulëta, o bir.

Nxiti njerëzit për nga e mira dhe pengoji ata nga e keqja! Ama, të jesh ti i pari që e vepron të mirën dhe të jesh ti i pari që largohesh nga e keqja, se fjala pa vepër nuk ka peshë.

Mandej bëj durim dhe tregohu i palëkundur si mali, mbasi njerëzit mund të të kundërvihen e të të lëndojnë. Por ti mos ua merr për të madhe, mbështetu në Allahun e Lartmadhërishëm se kjo është rruga e Pejgamberëve, misioni me shpërblimin e madh, për të cilin ia vlen të sakrifikosh.

Mos ua kthe shpinën njerëzve dhe mos ua shtrembëro fytyrën me mendjemadhësi, se Allahu nuk e do mburravecin edhe nëse falet, urdhëron për mirë dhe ndalon nga e keqja! Trego mirësjellje ndaj tyre dhe shtrihe krahun e mëshirës sa herë të ta kërkojnë!

Ec i qetë dhe i matur në mesin e njerëzve, as shpejt e mos të të arrijë ai që dëshiron të të shoqërojë, por as me ngadalë. Nëse ndonjë i paditur të lëndon me fjalë, mos ja kthe me të keq, por thuaj fjalë të mira që t'ia shuajnë zjarrin e së ligës. E kur të këshillosh, fol me butësi dhe mos e ngrit zërin se nuk ta pranojnë këshillën e u dukesh veshëgjatë. E kush ia vë veshin pëllitjes së gomarit?!"

Bir i dashur! Mbas porosive të Lukmanit nuk më mbetet tjetër veç të të them se të kam si dritën e syve, ndaj kujtoji edhe ti porositë e babës tënd. Dije se babë e nënë mundohen me shpirt nëpër dhëmbë për të mirën tënde, të motrës e të vëllëzërve të tu. Dije se babë e nënë të kanë shpirt e kaluar shpirtit edhe kur të përkëdhelin edhe kur të qortojnë, ndaj tregohu mirënjohës e mos e shkel të mirën me këmbë. Kujdesu për nënën se ajo të barti me vështirësi pas vështirësie në trupin e saj për muaj me radhë, të lindi e gati nuk vdiq nga dhimbjet. Kush e di sa netë i kaloi pa gjumë duke u përkujdesur për ty. Të ushqeui me qumësht gjiri, të fali dashuri dhe të mëkoi si zogun në fole. Mos harro se i Madhi Zot e ka bashkuar mirënjohjen ndaj prindërve me mirënjohjen ndaj Tij, madje e ka porositur rininë të luten për babë e nënë: "O Allah, o Zoti ynë! Mëshiroji prindërit tanë me mëshirën Tënde, për dashurinë dhe përkujdesin që treguan ndaj nesh që në vogëli!"

Besimtari

Biri im! Për sa të ketë jetë mbi tokë, do të ketë përleshje mes dritës dhe errësirës, kufrit dhe besimit, të vërtetës dhe të kotës, udhëzimit dhe humbjes, kështu qenka shkruar. Allahu i Lartësuar çdo populli i ka dërguar nga një Pejgamber për t'i nxjerrë nga errësirat e humbjes në dritën e udhëzimit. I Madhi Zot i dhuroi Pejgamberit aftësi, fuqi dhe mundësi që i vetëm ta kumtonte shpalljen. Mirëpo, nganjëherë Allahu dërgoi tek ndonjë popull më shumë se një Pejgamber, për t'iu bërë krah njëri-tjetrit. Kështu pra, në një qytet të largët, sot e kushedi sa shekuj më parë, Lartmadhëria e Tij dërgoi dy Pejgamberë, ashtu siç dërgoi Musain dhe Harunin tek firaoni dhe populli i tij.

"O popull! – u ngritën Pejgamberët, – Adhuroni Allahun e Vetëm e të Pashoq dhe braktisini zotat e pavlerë prej guri e druri!"

"O popull! – thërrisinin, – Adhurojeni Allahun, pasi nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Tij. Frikësojuni dënimit të Ditës së Madhe!"

"O popull! – u drejtoheshin, – Ne jemi Pejgamberë besnikë, ndaj kini frikë Allahun dhe na pasoni. Ne nuk kërkojmë prej jush kurrfarë shpërblimi, shpërblimin tonë e presim nga Zoti i botëve."

"O popull! Pse i përnderoni statujat që i jepni formë me duart tuaja? A i përulet krijuesi krijesës? Si mund t'i përulet zotëria robit të tij? A nuk mendoni?!"

Pasanikët e popullit iu drejtuan Pejgamberëve me mendjemadhësi duke i thënë: *"Ju nuk jeni tjetër, veçse vdekatar si ne, që dëshironi të fitoni famë dhe pozitë të lartë në mesin tonë. Sikur të donte Allahu do të dërgonte melekë dhe jo njerëz si gjithë të tjerët. Me të vërtetë ne mendojmë se ju jeni të çmendur."* Sa herë i shihnin në rrugë talleshin me ta. I quanin gënjeshtarë, të çmendur dhe të magjepsur.

Mirëpo, Pejgamberët nuk u dorëzuan dhe as nuk lëshuan pé. Me durim këshillonin popullin natë e ditë, haptazi dhe fshehurazi, në rrugë e në tregje, vetëm për vetëm e grupe-grupe, megjithatë thirrja e tyre edhe më shumë i largoi nga e vërteta, me përjashtim të disa të varfërve që bënë jetë të thjeshtë. Me përjashtim të atyre që e fitonin bukën e gojës me djersë dhe lodhje, Pejgamberëve nuk u besoi askush.

Edhe pse u paralajmëruan me dënimin e Allahut, banorët e qytetit nuk u kushtuan vëmendje porosive të Zotit, por i kundërshtuan të Dërguarit e Allahut dhe iu drejtuan duke u thënë me përçmim: *"Njëllaj për ne: na këshilluat ose nuk na këshilluat. Këto që na premtoni ju janë vetëm përralla. Ne nuk frikësohemi aspak mbasi asnjëherë nuk do të dënohemi. Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote. Ne jetojmë e vdesim, por kurrë nuk do të ringjallemi."*

Kur të Dërguarit gati sa nuk e humbën shpresën dhe menduan se do të shpalleshin gënjeshtarë, u erdhi ndihma e Allahut. I Madhi Zot i përforcoi me një të Dërguar të tretë. Kështu të tre bashkë filluan nga e para t'i thërrisnin banorët e qytetit drejt adhurimit të Allahut të Vetëm e të Pashoq.

Biri im! Mos harro se bashkimi është fuqi, ndërsa përçarja dobësi. Muslimanët i përngajnë gurëve dhe shkëmbinjve të një muri të pathyeshëm. Secili gur apo shkëmb mban mbi shpinë gurin apo shkëmbin tjetër e kështu muri ngrihet lart e më lart. Sikur një gur, sado i vogël, të largohet nga vendi i tij

gjithsa mban mbi sup dridhet, madje krejt muri lëkundet. Të porosis t'ua mbash krahun e t'i ndihmosh besimdrejtëve. Nuk ka rëndësi a je gur i vogël apo shkëmb i madh, e rëndësishme është që muri të ngrihet lart dhe mos të dridhet.

– Ju nuk jeni tjetër, veçse njerëz si ne. Allahu nuk ju ka shpallur asgjë. Ju nuk jeni të Dërguar, por gënjeshtarë të mëdhenj. Na e sillni dënimin e Allahut nëse jeni Pejgamberët e Tij!

– Zoti ynë e di se ne jemi të Dërguar, e kjo na mjafton. – thanë njëzëri. – Detyra e jonë është t'ju kumtojmë porositë e Allahut e t'ua tërheqim vërejtjen. Shenjat, mrekullitë dhe dënimi nuk janë në dorën tonë. Nëse udhëzoheni në rrugën e drejtë, lum për ju, por nëse kundërshtoni, ne nuk mund t'ua ndriçojmë zemrat me dritën e imanit, as nuk mund t'ju ndëshkojmë.

– Qëkur keni ardhur tek ne nuk kemi parë prej jush veçse sherr dhe ligësi. Nëse nuk hiqni dorë nga thirrja e juaj do t'ju gurëzojmë dhe do t'ju ndëshkojmë rëndë. – thanë pasanikët mendjemëdhenj.

Kërcënimi, vrasja, burgosja apo tortura është gjuha e jo-besimtarëve të motit dhe të sotit. A të kujtohet se si u sollën me Nuhun, Hudin, Salihun, Lutin dhe Ibrahimin, alejhimus-selam? Në të vërtetë kjo është gjuha e të dobët, gjuha e atij që ka frikë të përballet me të vërtetën.

– E ç'të keqe ka nëse ju themi mos adhuronit gurin, por Allahun? – ua kthyen të Dërguarit, – E ç'të keqe ka nëse ju themi mbani drejtësi në mesin e njerëzve, mos vidhni e largohuni paturpësive?

– Kobi dhe e liga ju vjen si pasojë e gjynaheve tuaja. Përkundrazi ne kemi ardhur t'ua shndërrojmë dështimin në sukses, përçarjen në bashkim, bestytnitë në logjikë dhe veset e ulëta në moral të lartë. Por ju jeni një popull që tejkalon çdo kufi.

Kështu zuri fill e liga. U mblodh qyteti kundër tyre, u nxehtën gjakrat dhe plasi sherri. U përhap fjala e mori dhenë: *“Pasanikët dhe paria e qytetit gati sa nuk i vranë të Dërguarit.”*

Prej skajit më të largët të qytetit erdhi një burrë duke vrapuar. Ishte njeri i thjeshtë, por zemërbardhë, i matur, i mençur dhe i duruar. Ishte njëri nga ata që u kishin besuar Pejgamberëve, ndaj sapo i ra në vesh lajmi se i gjithë qyteti është ngritur kundër tre të Dërguarve u nis si shigjetë.

“O populli im! Pasoni Pejgamberët!” – u thirri turmës që kishin rrethuar tre të Dërguarit me qëllim të keq, ndërkohë që zëri i dridhej nga lodhja.

Në të kaluarën kushdo që ka kundërshtuar të Dërguarit e Allahut është ndëshkuar nga i Lartmadhërishmi, me gurë nga qielli, me përmytje, me britmë dhe tërmete. Kështu ka qenë e shkruar derisa i zbriti shpallja Musait, alejhis –selam. Pas tij thuhet se mori fund ky ligj. *“Kush dëshiron të besojë, le të besojë dhe kush dëshiron të mohojë, le të mohojë!”* Në dynja nuk ka më dënime gjithpërfshirëse, ngase Muhamedi, alejhis-selam, është dërguar mëshirë për mbarë njerëzinë. Ndërsa gjykimi dhe shpërblimi do të bëhet në Ditën e Kiametit, besimtarët me Xhenete dhe jobesimtarët me zjarr.

Ky burrë, që erdhi me një frymë nga skaji i qytetit, kishte njohuri për ndëshkimet e popujve të hershëm. Nuk ishte gjë e lehtë... bëhej fjalë për shkatërrimin e popullit të vet.

Ky besimtar nxitoi për te populli i tij që t'i këshillonte dhe jo t'i gjykonte, nxitoi t'i përmirësonte dhe t'i pajtonte me të Dërguarit e Zotit. Kështu, o bir, besimtari nuk nxiton në gjykim, por nxiton në këshillim, në përmirësim, bashkim dhe pajtim.

“O popull! – u thirri, – Ne jemi një. Ne ndajmë një tokë, një gjuhë dhe një ngjyrë. Jua dua të mirën, ndaj më dëgjoni! Bindjuni atyre që nuk kërkojnë shpërblim prej jush dhe janë të udhëzuar në rrugën e drejtë!”

Mirëpo fjala e besimtarit ra në vesh të shurdhër. Mirë që nuk ia pranuan porosinë, por edhe e kërcënuan me vdekje nëse do të braktiste fenë e baballarëve të tij.

– *Qepe gojën, more varfanjak!* – ia kthyen të prishurit, – *Ose të kthehesh në fenë tonë, në fenë e të parëve të tu ose do të të vrasim!*

– *O populli im!* – u foli përsëri besimtari, – *Si të mos adhuroj Atë që më ka krijuar dhe tek i Cili do të kthehem të gjithë?! A të pranoj zota të tjerë që nuk kanë në dorë as dëm dhe as dobi? Nëse i Gjithëmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë belë, a do mund të më shpëtonin këto statuja prej guri dhe druri?! A thua vallë do të mund të ndërmjetësonin për mua?! Si mendoni?*

Turma mbeti pa fjalë.

– *Nëse pajtohem me paditurinë tuaj, do të isha vërtetë i humbur. Nuk ka humbje më të madhe sesa t'i përulesh atij që nuk e meriton, duke braktisur adhurimin e të Vetmit që meriton t'i nënshtrohemi,* – ua ktheu me krenari edhe pse e kërcënuan me vdekje.

Kur dëgjuan fjalët e tij, gati sa nuk plasën nga marazi. E shtrënguan për krahësh dhe e tërhoqën me forcë. Dikush e shau, dikush e pështyu dhe dikush e goditi, ama besimtarit nuk iu drodh këmba e as dora.

“O populli im! – tha besimtari për të fundit herë. – *Unë i kam besuar Zotit që ju ka krijuar, ndaj më dëgjoni!”*

Atëherë filluan ta godisnin me gurë, kurse ai ngriti shikimin nga qielli e filloi të lutej: *“O Allah! Udhëzoje popullin tim se nuk dinë!”* Nuk reshti së luturi derisa ra shehid, kënaqësia e Allahut qoftë përherë mbi të.

Bir i dashur! Allahu i Lartmadhërishëm na e ka ndaluar të themi se shehidët kanë vdekur, sepse vdekja e tyre nuk është

si e çdokujt. Përkundrazi ata janë të gjallë tek i Madhi Zot, por ne nuk e kuptojmë, se ajo është një jetë krejt e ndryshme nga e jona. Pejgamberi Muhamed, alejhis-selam, na mëson se sapo derdhet pika e parë e gjakut nga trupi i shehidit, i falen të gjitha gjynahet. Jo vetëm kaq, por shpirtin e tij të dëlirë Allahu e ngre përmbi qiej dhe e vendos në trupin e një zogu të gjelbër, që fluturon lart e lart mbi Xhenete. Prej lartësive të qiellit të përjetësive mrekullohet shpirti i tij teksa përshkon lëndinat e stërmbushura me bar të njomë e lloj-lloj lulesh. Oh, çfarë hijeshie?! Xheneti Adn, Firdeusi me pemë që prekin kupën qiellore, lumenj me ujë të kthjellët si loti, lumenj me qumësht të bardhë si bora, lumenj mjalte të kulluar, lumenj prej vere nga kalaveshët e Xhenetit tek gjarpërojnë anëkënd tokës së bekuar, që kundërmon misk dhe shafran. Kështu edhe besimtari i historisë sonë kur e përjetoi këtë nderim të madh, kur hyri në Xhenet dhe pa jetën e pafund, mirësitë dhe mrekullitë që gjendeshin në Të, përsëri tregoi dhembshuri për popullin e tij. *“Ah, sikur ta shihte populli im këtë që po shoh unë!”* – tha me keqardhje, – *Sikur ta shihnin se sa më nderoi Zoti im, nuk do ngulnin këmbë në idhujtari dhe padituri.”*

Bir i dashur! Ka njerëz trupat e të cilëve dergjen në varre, por ata janë të gjallë. Por ka edhe të tjerë që janë gjallë, ama nuk i dallon nga të vdekurit, veçse frymëmarrja. Ka njerëz që kanë vdekur, por kanë lënë mësim të gjalla, udhëzime, porosi dhe shembuj. I tillë ishte edhe ky besimtar.

Edhe dije se sikur e gjithë njerëzia, nga i pari tek i mbra-mi, të të nderojnë në dynja, nuk krahasohet me nderin që ta dhuron Allahu. Atje është nderi dhe fisnikëria e vërtetë, ndaj mundohu me mish e me shpirt të fitosh kënaqësinë e të Madhit Zot edhe nëse hidhërohen njerëzit.

Thuhet se pas vrasjes së besimtarit populli i përçudnuar i qytetit, i vranë edhe tre të Dërguarit e Zotit. Kështu e hidhëruan Allahut dhe merituan dënimin. Nuk pati nevojë që Lartmadhëria

e Tij të zbriste ndonjë ushtri melekësh nga qielli për t'i ndëshkuar. Njerëzia është kaq e dobët përballë fuqisë së Zotit saqë mjaftoi britma e një meleku të vetëm që ta shuante jetën e qytetit, siç bën rrebeshi kur bie mbi zjarr. Nga tmerri u plasën zemrat në gjokse dhe të gjithë ranë të vdekur njëherësh.

Mjerë për ta! Kush e di sa e sa popuj para tyre qenë mallkuar e shkatërruar, në mënyrë që njerëzia të zinte mend! Asnjë prej tyre nuk u kthyen më në dynja, por në Ditën e Gjykimit do të tubohen që të shpërblehen për gjithë sa vepruan.

Shpirti i njeriut

Biri im! Siç të kam kallëzuar edhe më parë, Allahu e krijoi Ademin, babën e njerëzimit, nga dheu. Kur i dha formën që deshi, i Madhi Zot i fryu shpirtin e kështu trupi i Ademit mori jetë. Qysh prej asaj dite kështu u gatuan njerëzit: trup e shpirt. Profeti Muhamed, alejhis –selam, na ka lajmëruar se çdo njeri krijohet në barkun e nënës nga një pikë uji, të cilën Allahu e vendos në një vend të përshtatshëm për 40 ditë. Për 40 ditë të tjera uji shndërrohet në droçkë gjaku. Po për aq kohë droçka e gjakut bëhet copëz e vogël mishi. Mandej Allahu i Lartësuar dërgon një melek që fryn në këtë copëz mishi shpirtin, dhe shkruan për të katër gjëra: riskun, exhelin, veprat (të mirat e të ligat) si dhe përfundimin e tij (a do jetë prej fatlumëve apo fatzinjve).

Po ç'është shpirti mund të pyesësh ti? Shpirti është një krijesë e Allahut, por askush nuk e di të vërtetën e tij veç të Madhit Zot. Disa thonë se shpirti për trupin e njeriut është si uji për bimën. Disa të tjerë kështu e disa ashtu. Ama, dituria e mbarë njerëzisë për këtë krijesë, është thuajse asgjë, përballë dijes së Allahut të Lartësuar.

Sidoqoftë, njeriu për sa ka frymë përleshet me dallgët e dynjasë me trup e me shpirt. Ama kur ndahet nga kjo botë dhe fillon udhëtimin drejt Berzahut, është shpirti ai që e bart barrën e rëndë deri Ditën e Kiametit, kur trup e shpirt bashkohen përsëri dhe ngrihen për të dhënë llogari para Mbretit të botëve. Prandaj lum për atë që e pastroi shpirtin e tij me besim, me

pendim e adhurim dhe mjerë për atë që e poshtëroi shpirtin e tij me idhujtari, me mohim e padrejtësi! Në jetën e kësaj bote, ndoshta nuk do të vësh re ndonjë dallim ndërmjet shpirtmirit dhe shpirtkeqit, madje i keqi shpesh fiton edhe famë e pozitë më të lartë në sytë e botës. Ama, në çastet e fundit, në momentin kur i vjen shpirti në grykë askush nuk mund ta përshkruajë lumturinë e njeriut të mirë dhe tmerrin e të ligut.

Biri im! Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na ka rrëfyer se: Kur besimtarit i afrohet exheli dhe nuk i kanë mbetur veçse pak frymëmarrje, zbresin nga qielli disa melekë të bukur nûr, me fytyra më të bardha se bora dhe më të ndritshme se dielli. Me vete bartin qefinin dhe balsamin e Xhenetit, ndaj mos pyet për aromën e tij. Zbresin e zbresin derisa i afrohen krejt afër besimtarit, që po jep shpirt. Ai i sheh, ndërsa familjarët që i rrinë përreth nuk i shohin. Pa iu afruar mirë melekët e mëshirës, vjen meleku i vdekjes e i qëndron krejt afër kokës që mezi lëviz.

– O shpirt i qetë! – i thotë meleku, – Dil nga trupi drejt faljes së Allahut dhe kënaqësisë së Tij!

– O shpirt fisnik! – i drejtohen melekët e mëshirës njëzëri, – Mos u frikëso prej vdekjes dhe mos u dëshpëro për atë që le pas në jetën e dynjasë, por gëzoju shpërblimit të Xhenetit, që të është premtuar. Dije o mik, se ne, me lejen e Allahut, të kemi qenë krah në jetën e dynjasë, duke të mbrojtur dhe udhëzuar për nga e mbara. Edhe në botën e Ahiretit do të ndihmojmë e do të gjendemi pranë, për ta larguar mërzinë dhe për të përgëzuar me mirësitë e Xhenetit, ku do gjesh gjithçka dëshiron. Eh çfarë vendbanimi është ai mor mik?! I përgatitur nga vetë Gjynahfalësi e Mëshirëploti, që me bujarinë e Tij t'i fali gabimet dhe me mëshirën e Tij do të të bëjë banor të Xhenetit. E fitove të gjithë këtë mirësi për shkak të besimit të çiltër që kishe.

Kur dëgjon fjalët e mira dhe përgëzimin e melekëve del shpirti i besimtarit nga trupi i tij lehtë e lehtë, sikur uji që rrjedh nga ena kur anohet pak. Atëherë meleku i vdekjes bëhet gati ta marrë shpirtin e besimtarit, por sa hap e mbyll sytë ia rrëmbajnë nga duart melekët e mëshirës. Ata e stolisin me qefin Xheneti dhe e lyejnë me balsam. Mandej kundërmon shpirti i besimtarit aromë misku, nga ai më i shtrenjti dhe më i ëmbli mbi faqen e tokës. Kështu e bartin dhe fluturojnë me të në sferat qiellore. Sa herë që kalojnë pranë ndonjë grupi melekësh nga ata të qiellit të dynjasë, ata i pyesin të ngazëllyer:

– Nga buron kjo aromë e këndëshme misku, o melekë të mëshirës?

– Nga shpirti i filanit, të birit të filanit, o banorë të qiellit, – u përgjigjen duke ia përmendur emrat dhe llagapet më të mira me të cilat e thërrisin besimtarin për sa qëndroi në dynja. Fluturo e fluturo, mbërrijnë në kufirin mes qiellit të dynjasë dhe qiellit të dytë. Atje kërkojnë leje nga rojtarët e qiellit të dynjasë për t’u ngritur drejt qiellit të dytë. Kur marrin vesh se me kë po ngrihen melekët e mëshirës, rojtarët hapin portat e qiellit të parë, e kështu fluturojnë lart e më lart drejt qiellit të dytë. Atje i pret një grup melekësh fisnikë që i bashkangjiten melekëve të mëshirës duke fluturuar tok me ta drejt qiellit të tretë. Në kufi u kërkojnë leje rojtarëve t’ua hapin portat dhe t’ua lejojnë të fluturojnë edhe më lart. Kur marrin vesh se kush po ngrihet, rojtarët hapin portat e qiellit të dytë, e kështu ngrihen drejt qiellit të tretë. Atje i presin melekë të tjerë dhe i përcjellin me bujari deri në kufirin e qiellit të katërt. Fluturo e fluturo nën përkujdesjen e melekëve, mbërrin shpirti i besimtarit, me gaz e hare, deri në qiellin e shtatë. Atje kumbon zëri i të Lartmadhërishmit: “Shkruani të gjitha veprat e robit Tim në Iljin (në një regjistër të ruajtur nga melekët ku shkruhen veprat e xhenetlive) dhe zbriteni robin tim në Tokë! Nga toka i krijova, duke filluar me babën e tyre, Ademin. Aty kanë për

t'u kthyer, për t'u varrosur pas vdekjes, mandej prej saj do t'i nxjerr edhe një herë, duke i ringjallur Ditën e Gjykimit."

Kështu fillon zbritja e shpirtit të besimtarit, nën përkujdesjen e melekëve, nga qielli i shtatë drejt Tokës. Mbasi e zbresin lehtë e lehtë, e vendosin në varr aty ku njerëzia kanë varrosur tashmë edhe trupin, pastaj largohen dhe e lënë vetëm. E rrethon shpirtin errësira dhe e kaplon trishtimi. Papritmas i shfaqen dy melekë: Nekiri dhe Munkeri. Dy melekët e marrin dhe e ulin për të dhënë llogari. Trishtimi i shtohet, por Allahu i Lartmadhërishëm e përforcon dhe frika i venitet.

– *Kush është Zoti yt?* – e pyesin Nekiri dhe Munkeri.

– *Zoti im është Allahu,* – përgjigjet besimtari.

– *Cila është feja jote?* – e pyesin njëherësh.

– *Feja ime është Islami,* – përgjigjet besimtari.

– *Kush është njeriu që u dërgua në mesin tuaj?* – e pyesin përsëri.

– *Ai është Muhamedi, i Dërguari i Allahut,* – ia kthen besimtari.

– *Ku mbështetet dituria jote?* – i thonë.

– *Lexova Librin e Allahut, i besova Atij dhe i qëndrova besnik këtij besimi.*

Pa e mbaruar mirë fjalën buçet një zë nga qielli: "Të vërtetën tha rob i Im. Shtrojani varrin me shtroja të Xhenetit, visheni me rroba të Xhenetit dhe hapini dritaren prej nga mund të shohë vendbanimin e tij në Xhenet!"

Kështu i hapet një dritare, prej nga hyn flladi i këndshëm i Xhenetit. I zgjerohet varri deri ku mbërrin shikimi i tij. Gëzohet besimtari sa më s'ka. Mandej i vjen një njeri i hijshëm. Fytyrën e ka fisnike, rrobat e stolisura bukur e mirë, e mos fol për aromën e këndshme që kundërmon.

– Përgëzohu me atë që të do e bardha zemër! Kjo është dita që të premtohej, o njeri i mirë. – ia pret fisniku.

– Kush je ti, o fisnik? Fytyra jote i ngjan atij që sjell myzhde nga larg, – thotë besimtari i mahnitur.

– Unë jam puna e jote e mirë. Kam ardhur të të bëj shoqëri e të mos mërzitesh, – i përgjigjet fisniku me përzemërsi.

Bir i dashur! Përkushtoj Allahut me adhurim, sillu mirë me njerëzit dhe tregohu bamirës ndaj tyre! Le të jenë adhurimi dhe bamirësia shoqëruesit e tu në jetën e dynjasë që të të bëhen mik në jetën e Berzahut, atëherë kur të mbetesh fill i vetëm, pa babë e nanë, pa vëlla e motër, larg shokëve e njerëzisë.

Kur sheh përtej dritares hijeshinë e Xhenetit dhe bukuri-
në e vendbanimit të tij në tokat e përjetësisë, besimtari i lutet
Lartmadhërisë së Tij: “O Allah! Përshejtoje Kiametin, o Zot,
përshejtoje Kiametin!”

Ndërsa, kur i afrohet exheli jobesimtarit dhe nuk i kanë
mbetur veçse pak frymëmarrje, zbresin nga qielli disa melekë
të vrenjtur, me fytyra të zeza katran. Me vete bartin pëlhura
Xhehenemi. Zbresin e zbresin, derisa i afrohen jobesimtarit,
që po jep shpirt. Ai i sheh, ndërsa familjarët që i rrinë përreth
nuk i shohin. Pa iu afruar mirë melekët e dënimit, vjen meleku
i vdekjes e i qëndron krejt afër kokës që i rëndon si mali.

*– O shpirt i keq! – i thotë meleku, – Dil nga trupi drejt
hidhërimit të Allahut dhe dënimit të Tij!*

Veç sikur ta shihje, kur e kaplon keqbërësin agonia e
vdekjes! Melekët ia nxjerrin shpirtin duke e goditur fort në
fytyrë dhe në shpinë. E torturojnë dhe i drejtohen me vrazh-
dësi: “Nxirre shpirtin se nuk mund të shpëtosh dot! Sot do të
marrësh ndëshkim poshtërues, për shkak të mendjemadhësisë
tënde ndaj besimit në Zot.”

Kur dëgjon kërcënimet e melekëve dhe sheh llahtarinë që e pret, shpirti i jobesimtarit mundohet të fshihet në skutat e trupit, por meleku i vdekjes e tërheq me forcë e kështu e nxjerr nga trupi siç nxirret krëhëri nga leshi i lagur e i ngatërruar.

Sa hap e mbyll sytë ia rrëmbejnë nga duart melekët e dënimit. Ata e lidhin me pëlhurë xhehenemi. Shpirti i tij kundërmon erë cofëtime, nga era më e qelbur mbi fytyrën e tokës. Kështu e bartin dhe fluturojnë me të në sferat qiellore. Sa herë që kalojnë pranë ndonjë grupi melekësh nga ata të qiellit të dynjasë, ata i pyesin të neveritur: *“Ç’është ky shpirt i fëlliqur, o melekë të dënimit?”*

“Shpirti i filanit, të birit të filanit, o banorë të qiellit. – u përgjigjen duke ia përmendur emrat dhe llagapet më të poshtra. Mandej fluturojnë me të, derisa mbërrin në kufirin mes qiellit të dynjasë dhe qiellit të dytë. Atje kërkojnë leje nga rojtarët e qiellit të dynjasë për t’u ngritur drejt qiellit të dytë. Kur marrin vesh se me kë po ngrihen, rojtarët nuk i hapin portat e qiellit të parë. Atëherë kumbon zëri i të Lartmadhërishmit: “Shkruani të gjitha veprat e tij në Sixhin (në një regjistër të ruajtur nga melekët ku shkruhen veprat e njerëzve të ligj!” Kështu shpirtin e tij e flakin nga lartësitë qiellore drejt Tokës.

Mbasi bie nga qielli i dërrmuar, e vendosin në varr aty ku njerëzia ia kanë varrosur tashmë edhe trupin, pastaj largohen dhe e lënë vetëm. E rrethon shpirtin errësira dhe e rrok trishtimi. Papritmas i shfaqen Nekiri dhe Munkeri. Dy melekët e marrin dhe e ulin për të dhënë llogari. Trishtimi i shtohet, por Allahu i Lartmadhërishëm nuk e përforcon shpirtin e lig dhe e kaplon tmerri.

– *Kush është Zoti yt? e pyesin Nekiri dhe Munkeri.*

– *Eh, eh, nuk e di, – përgjigjet.*

– *Cila është feja jote? – e pyesin njëherësh.*

– Eh, eh, nuk e di, – përgjigjet i frikësuar.

– Kush është njeriu që u dërgua në mesin tuaj? – e pyesin përsëri.

– Eh, eh nuk e di, – ia kthen i tmerruar.

Pa e mbaruar mirë fjalën, buçet një zë nga qielli: “Gabo, ndaj shtrojani varrin me shtroja të Xhehenemit, visheni me rroba të zjarrit dhe hapjani dritaren prej nga mund të shohë vendbanimin e tij në zjarr!”

Kështu i hapet një dritare, prej nga hyn tymi përvëlues i Xhehenemit. I ngushtohet varri aq sa brinjët i afrohen njëra me tjetrën e gati sa nuk thyhen. Tmerrohet jobesimtari sa më s’ka. Mandej i vjen një njeri i frikshëm. Fytyrën e ka të ngrysur e mos fol për rrobat dhe erën që kundërmon.

– Mjerë për ty! Kjo është dita që të premttohej, o njeri i keq – ia pret fytyrëngrysur.

– Kush je ti? Fytyra e jote i ngjan atij që sjell kob e mallkim, – thotë jobesimtari i lebetitur.

– Unë jam puna e jote e keqe, – i përgjigjet me ashpërsi.

Pastaj merr një çekan të hekurt... që sikur të godiste me të një kodër, do ta thërrmonte, e ngre lart dhe e godet me fuqi jobesimtarin, i cili klith aq shumë sa e dëgjon gjithçka ndërmjet lindjes e perëndimit, përveç njerëzve dhe xhindëve.

Ndoshta ti do të pyesësh: e si qenka e mundur që dy melekë të të pyesin pas vdekjes? Si u ngritka shpirti në qiellin e shtatë e për pak kohë zbritka edhe njëherë në tokë, ndërkohë që hapësira mes Tokës dhe qiellit të shtatë është e pallogaritshme? Si mund të ngazëllehesh shpirti me flladin e Xhenetit kur trupin e ka të varrosur në Tokë? E shumë e shumë të ngjashme me këto....

Dëgjo bir! Jo vetëm ti, por kushdo habitet kur dëgjon se i vdekuri jepka llogari, apo se si përjetoka kënaqësi ose mundim. Ama, për t'ia lehtësuar kuptimin e jetës së varrit i Madhi Zot, ia mundësoi njerëzisë të përjetojë ëndrrat. Në varësi të ëndërrës njeriu ngazëllehët, lumturohet, frikësohet, tmerrohet, madje nganjëherë edhe ndjen dhimbje prej vërteti në trup. Shpesh e gjen veten në troje të largëta drejt të cilave do duheshin kush e di se sa ditë udhëtim, megjithëse ëndrra më e gjatë nuk zgjat vetëm se pak sekonda.

Me pak fjalë, megjithëse jeta e varrit i përket gajbit, të cilën e besojmë edhe pse është mister për ne, ajo na sjell ndër mend ëndrrat. Njeriu në ëndërr nuk është krejt i gjallë mbasi nuk reagon si të jetë zgjuar, ama nuk është as krejt i vdekur, sepse edhe pak do zgjohet. Njësoj ndodh me njeriun kur është në varr dhe pret të rizgjohet Ditën e Gjykimit. Prandaj, edhe populli i thotë gjumit “vdekja e vogël” dhe vdekjes “gjumi i madh”.

Pronarët e kopshtit

Bir i dashur! Të jesh i bindur se sadakaja s'ta pakëson pasurinë, përkundrazi bujaria ta shton bereqetin dhe të fal lumturi. Profeti ynë, alejhis-selam, na ka lajmëruar se çdo ditë, sapo shkrep drita, nga lartësitë qiellore zbresin dy melekë fisnikë. Flasin e u dëgjohet fjala, luten e u pranohet lutja. Sapo i afrohen Tokës, i lutet njëri prej tyre Mbretit të qiejve me këto fjalë: *"O Allah i Lartmadhërishëm, zëvendësoja bujarit pasurinë që ua fal të tjerëve!"* Ia pret tjetri: *"O Allah i Lartmadhërishëm, rrënoja koprracit pasurinë e mos i fal bereqet!"*

Thuhet se një kohë e një mot, diku larg në Abisini jetonte një njeri i mirë. Ky kishte trashëguar tokë të madhe nga gjyshërit. Vit për vit e mbillte me lloj-lloj fidanësh, Allahu i dhuronte bereqet të mbjellave e ky ia bënte shyqyrin: një hise e mbante për ushqim, një e ruante për familje dhe tjetrën për të varfër. Shkonin vitet, por gazi dhe e mira nuk i ndahej. U rritën fëmijët e u bënë burra, krijuan familje e shoqëri. Ndërkohë burrin e kaploi pleqëri e thellë, mjekra e koka iu bënë bardh si bora. Kur e ndjeu se nuk i kish mbetur edhe shumë në këtë botë, mblodhi djemtë dhe u la porosi të adhuronin Zotin, të punonin tokën dhe të kujdeshin për nevojtarin.

Sot mirë e nesër mirë, vëllezërit i mashtroi dynjaja dhe u hyri në gjak pasuria.

– *Babës tonë i pati marrë koka erë, – u ngrit e tha njëri. – Më kujtohet se sa shumë kujdesej për të varfrin dhe*

skamnorin. Sikur ta shiste hisen që ua ndante të varfërve vit për vit, edhe më të kamur do ishim sot. Ama ne s'do bëjmë të njëjtin gabim... hisen e tyre do e shesim e të ardhurat i ndajmë mënjanë për fëmijë e nipëri. Si mendoni?

– Nuk e ke keq ti vëlla. – tha një tjetër, – Ama, si t'ia bëjmë se? Koha e vjeljes është afër, e nevojtarët janë mësuar të marrin hisen e tyre... Ditën e vjeljes i ke aty, nuk shkulen nga vendi... i kemi peshqesh nga babai.

– Falëndero zotin, o vëlla, dhe bëja shyqyrin! – ia priti tjetri, ai më i urti dhe i maturi. – Po a s'ju kujtohet gazi e lumturia që s'na ndahej?! Unë them, t'ia përmbushim amanetin babës e mos t'ia ndalojmë hisen nevojtarit.

– Ne nuk e mendojmë si ti, o vëlla. – u përgjigj vëllazëria.

– Do të dalim me natë, pa zbardhur, e do t'i vjelim pemët tona, që të mos na zërë mëngjesi e të na mblidhen fukarenjtë! – thanë njëzëri.

Kështu natën para vjeljes u zgjuan herët. Akoma me terr nisën t'i bëjnë zë njëri-tjetrit, ama lehtë-lehtë, që të mos dëgjoheshin e zbuloheshin. "Nxitoni për tek kopshti! Nxitoni para se të dynden të varfrit!" flisnin nën zë dhe zemrat u hidheshin përpjetë nga halli.

Dolën me të shpejtë si shigjetat nga harku, të bindur se ishte e drejta e tyre t'i pengonin nevojtarët, por kur mbërritën tek gardhi u shastisën, sytë i mbetën të shtangur dhe zërat iu mbytën në grykë. E gjithë pemëtaria me lloj-lloj frutash, kish gdhirë e shkretuar gjer në rrënjë. U kish shkuar kopshti, fitimi dhe lëmosha e nuk u mbeti asgjë. Allahu i Lartmadhërishëm kish dërguar një vorbull mbi kopshtin e tyre... një vorbull që nuk la gjethe pa krehur e frut pa prekur, ndërkohë që njerëzia flinte. Kopshti ishte shkretuar dhe vëllezërit mbetën me gisht në gojë. Ky është fundi i dorështrënguarve, që e pengojnë të varfrin, të ngratin dhe nevojtarin nga e drejta e tyre në pasuri.

– Oh mjerë për ne! – thanë vëllezërit, tek shihnin kopshtin që kishte marrë fund, – Paskemi qenë fatkeq e të humbur!

– Oh mjerë për ne! U tret kopshti e gjithçka dëshironim!

– A nuk ju thashë të falënderoni Allahun e t'ia bënit shqyrin?! – iu drejtua ai më i maturi.

– I Lartësuar dhe larg nga çdo e metë qoftë Zoti ynë! – thanë vëllezërit. – Ne paskemi qenë të padrejtë, kur menduam se sadakaja do na pakësonte bereqetin e pasurinë.

Mandej iu kthyen njëri-tjetrit. Filluan të qortonin e të haheshin shoqi me shoqin, por kopshti s'kthehej mbrapa.

– Oh, mjerë ne! – thanë të penduar. – Paskemi qenë të humbur vërtetë, kur harruam se i Madhi Zot dëshiron t'u bëjmë mirë nevojtarëve, dhe se e mira nuk ta humb bereqetin!

– Këtë vit do ta punojmë sërish tokën, – thanë njëzëri, – shpresojmë se Zoti do të na dhurojë të vjela edhe më shumë se të sivjetshmet, ngase u penduam dhe kurrë nuk do ia pengojmë skamnorit hisen e tij!

Bir i dashur! Bëji mirë tjetrit, ashtu si të bëri mirë ty Zoti, se Allahu të sheh e të dëgjon. Kurrë mos harro se për besimtarin gëzimi i të dhënit është më i madh se gëzimi i të marrurit, prandaj jep që Allahu të ta shtojë pasurinë e xhepit dhe lumturinë e zemrës.

Gjykimi

Biri im! Ditën e Gjykimit, kur të jetë ringjallur njerëzia, kur t'i jetë afruar dielli përmbi koka, kur t'u jenë rreshkur lëkurat e djersa të bëhet lumë, do të vërshojnë grupe-grupe drejt të Dërguarve të Allahut për ndërmjetësim. Do të shkojnë tek Ademi, alejhis-selam, e do i thonë të pikëlluar: *"O Adem! Ti je baba i njerëzisë, Allahu të formësoi me Duart e Veta, ka hedhur tek ti shpirtin, si dhe i ka urdhëruar melekët të të bien në sexhde. Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt, a nuk e sheh sa në hall jemi?!"* Ademi, alejhis-selam, do u përgjigjet: *"E si t'i lutem Zotit kur e kam thyer urdhrin e Tij?! Si t'i lutem Zotit kur kam ngrënë frutin e ndaluar?! Shkoni tek Nuhu!"*

Sapo mbaron Ademi fjalën, njerëzit vërshojnë drejt Nuhut, alejhis-selam. *"O Nuh!", e thërrasin të pikëlluar, "Ti je Resuli i parë, Allahu të nderoi e të quajti rob falënderues, a nuk ndërmjetëson për ne tek i Madhi Zot?! A nuk e sheh sa në hall jemi?!"* Nuhu, alejhis-selam, do u përgjigjet: *"E si t'i lutem Zotit për ndërmjetësim kur dikur iu luta për shkatërrimin e faqezinjve nga populli im?! Shkoni tek Ibrahimimi, të cilin Allahu e mori për mik të afërt!"*

Me të mbaruar Nuhu, vërshojnë drejt Ibrahimimit, alejhis-selam. *"O Ibrahim!", e thërrasin të pikëlluar. "Ti je miku i afërt i Allahut, a nuk ndërmjetëson për ne tek i Madhi Zot?! A nuk e sheh sa në hall jemi?!"* Ibrahimimi, alejhis-selam, do u përgjigjet: *"E si t'i lutem Zotit për ndërmjetësim, kur në dynja kam bërë gabim?! Shkoni tek Musai, atij që Allahu i zbriti Teuratin, i foli dhe e nderoi!"*

Pasi mbaron Ibrahim i fjalën, njerëzit vërshojnë drejt Musait, alejhis-selam. *"O Musa!", e thërrasin të pikëlluar, "Ti je i përzgjedhuri i Allahut. Ty të foli Zoti drejtpërsëdrejti dhe ta zbriti Teuratin, ndaj a nuk ndërmjetëson për ne?! Shih në çfarë halli jemi!"* Musai, alejhis-selam, do u përgjigjet: *"E si të lutem për ndërmjetësim kur në dynja kam bërë një krim?! Shkoni tek Isai, tek njeriu shpirtmirë, që me urdhrin e Allahut e lindi, si mrekulli, Merjemja e dëlirë."*

Sapo mbaron Musai fjalën vërshojnë drejt Isait, alejhis-selam. *"O Isa!", e thërrasin. "O Isa, ti je i nderuari i Allahut. Të krijoi Allahu pa babë dhe të dhuroi shpirt të çiltër, ndaj a nuk ndërmjetëson për ne?! A nuk e sheh se në çfarë halli jemi!"* Isa, alejhis-selam, do u thotë: *"Nuk më takon mua të ndërmjetësoj, por shkoni te Muhamedi, tek ai që i janë falur të gjitha gjynahet, të parat e të mbramet!"*

Sapo mbaron Isai fjalën ngarendin tek Muhamedi, alejhis-selam. *"O Muhamed!", thërrasin njëzëri. "Ti je robi i dalluar i Allahut. Ty të janë falur të gjitha gjynahet, të parat e të mbramet. A nuk ndërmjetëson për ne tek i Madhi Zot? Të zbresë e të na gjykojë, se jemi në hall të madh e nuk mund të durojmë."*

Atëherë Profeti Muhamed, alejhis-selam, i lutet Allahut, i kërkon leje për ndërmjetësimin e madh. Lartmadhëria e Tij ia dëgjon fjalën dhe ia lejon të ndërmjetësojë. Zbresin melekët dhe rreshtohen në skajet e Tokës. Qielli çahet. Tetë melekë zbresin Arshin e Zotit nga lartësitë.

Kur e sheh Allahun, Pejgamberi, alejhis-selam, bie në sexhde dhe e përlëvdon të Madhin Zot më mirë e më bukur se kurrë. Mandej i thuhet: *"Ngrije kokën, o Muhamed! Lyp dhe do të të jepet! Fol dhe do të të dëgjohet fjala! Ndërmjetëso se do të të pranohet!"* Atë ditë do e marrë vesh njerëzimi mbarë se kush ishte Profeti Muhamed, alejhis-selam, por do jetë vonë... Lum

për ata që pasuan hapat e tij në jetën e dynjasë! Të shpëtuar e të nderuar për jetë të jetëve.

Dëgjo, bir! Nuk janë njësor besimtari, që u përpoq për mirë dhe flijoi rehatinë e vet për hir të Zotit, me njeriun e prishur, që iu dha ligësisë dhe gjynaheve në jetën e dynjasë?! Kurrresi, nuk janë njësor! Edhe mbas vdekjes nuk janë kurrë të barabartë.

Sa u përket atyre që kanë besuar dhe të mira kanë punuar, strehim do të kenë kopshtet e Xhenetit, ku do qëndrojnë për jetë të jetëve, të stolitur me byzylykë ari dhe të veshur me petka mëndafshi të butë. Ndërsa ata që nuk e besuan Allahun dhe Ditën e Gjykimit që u zhytën në ligësi dhe gjynahe do hidhen në zjarr, ku do qëndrojnë përgjithmonë. As nuk do të vdesin e të rehatohen nga ndëshkimi dhe as nuk do t'u lehtësohet ndonjëherë dënimi.

Kështu, kur të fillojë gjykimi, Allahu i Lartmadhërishëm do thërrasë emrin e besimtarit për gjykim. Besimtari frikësohet dhe ka të drejtë të frikësohet, kushedi si do të shkojë puna e tij? Mandej turpërohet dhe ka të drejtë të turpërohet, e gjithë njerëzia do marrë vesh gjynahet e tij. Fatmirësisht, Lartmadhëria e Tij urdhëron melekët që ta ndajnë nga turma që të mos koritet dhe ashtu bëjnë. E dërgojnë në një vend ku askush nuk e dëgjon gjykimin e tij. I frikësuar, i shkreti ul shikimin.

– *O robi im! – i drejtohet Allahu, – A të kujtohet gjynahu që bërë në filan vend, në filan ditë?*

– *Po, o Zot, më kujtohet.* – përgjigjet besimtari, kokulur.

– *Po gjynahu që e bërë në fshehtësi, në filan vend e filan ditë?*

– *Po, o Zot, më kujtohet.* – përgjigjet besimtari me frikë në shtat.

– *Po ky gjynah? Po ai gjynah?*

– Të gjitha më kujtohen dhe i pranoj, o Zot. – përgjigjet i shkreti dhe mendon se do e hedhin në zjarr.

– O rob i im! – i thotë Allahu, ndërkohë që besimtari e humb shpresën për shpëtim, – Nuk do ta humb përpjekjen tënde në dynja, jo. Më besove dhe Pejgamberin tim pasove, ndaj mos ki frikë! Ashtu si t'i fsheha gjynahet në dynja, do të t'i fali sot.

Atëherë i jepet libri i punëve të tija nga e djathta. Oh, lum për besimtarin! Mos pyet për gëzimin e tij! Shend e verë kthehet edhe një herë në sheshin e madh ku pret njerëzia.

“Ja, o njerëz!”, bërtet nga larg. “Ky është libri im! Lexojeni vetë po deshët! Allahu ma pranoi mundin, se gjithmonë e kam pasur frikë Ditën e Gjykimit. Kurdoherë jam munduar për mirë, por edhe kur gaboja i kërkoja falje Zotit tim.”

Kështu do të jetojë i lumtur për jetë të jetëve në Xhenetet e bekuara.

Më pas thirret për gjykim jobesimtari, ai që nuk i besoi Allahut dhe nuk e pasoi Profetin Muhamed, alejhis-salam. Ama melekët nuk e ndajnë nga turma. Ai gjykohet në mesin e të gjithë njerëzisë, që të turpërohet e t'i nxihet faqja.

– O rob i im! – i drejtohet Allahu, – A të kujtohet gjynahu që bërë në filan vend, në filan ditë?

Njerëzia dëgjon, e shikimet kthehen nga ai.

– Jo, o Zot, kurrë nuk e kam bërë këtë të ligë. – përgjigjet jobesimtari.

– Po gjynahu që e bërë në fshehtësi, në filan vend e filan ditë?

– Jo, o Zot, nuk e kam bërë. – përgjigjet përsëri.

– Po ky gjynah? Po ai gjynah?

– Asgjë nuk kam bërë dhe nuk i pranoj, o Zot.

– A ke dëshmitarë o njeri?

– A nuk mjafton që unë të dëshmoj për vetveten, o Zot?!
– përgjigjet dhe mendon se ia hodhi.

Atëherë, Allahu ia vulos gojën. Jobesimtari bën të flasë, por nuk flet dot. Mandej i Madhi Zot, urdhëron të flasin duart e tij, këmbët, madje edhe lëkura. Sa herë që pyeten dëshmojnë kundra tij. Nuk lënë gjynah të tij pa e nxjerrë sheshit, prej më të voglit te më i madhi. E gjithë njerëzia, nga i pari tek i mbrami, i ngulin shikimet mbi të me neveri.

Melekët, dhe krejt të pranishmit do të thonë njëzëri: “Ky është ai, që gënjente në emër të Allahut, duke thënë se Allahu ka fëmijë dhe ortakë në sundim. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët!”

Kur e kupton se nuk ka shpëtim, jobesimtari i drejtohet gjymtyrëve dhe lëkurës, i tmerruar: “Po pse dëshmuat kundër meje, kur unë po përpiquesha t’ju shpëtoja nga zjarri i përflakur!”. “Ishte Allahu që na detyroi të flisnim, o njeri. Ai na detyroi të flisnim veç të vërtetën. Nëse dëshiroje të na shpëtoje sot, pse na detyrove të bënim gjynahe në dynja? Ti nuk e largove dorën nga e keqja, nuk e ruajtë shikimin, as dëgjimin, as lëkurën tënde nga paturpësitë, se mendoje që Allahu nuk ka dijeni për shumë nga ajo çfarë bëje. Ky mendim i keq për Zotin, ta solli dështimin në dynja dhe poshtërimin në këtë ditë të madhe.”

Atëherë i vjen libri i punëve të tija pas shpine dhe i jepet nga e majta.

– Ah i mjeri unë! – rënkon jobesimtari, – Sikur të mos më ishte dhënë libri aspak, e të mos merrej vesh puna ime! Pasuria ime, ari dhe argjendi, nuk paska sot vlerë aspak. Për pozitën e pushtetin që kisha në dynja nuk pyet askush sot. Ah i mjeri unë, i mjeri!”

– Merreni! – urdhërohen melekët, – Mbërthejeni me pranga! Hidheni në zjarr dhe përcëllojeni! Atje lidheni me zinxhirë, 70 parakrahë të gjatë! Ai nuk i pat besuar Allahut të Lartmadhërishëm dhe as nuk nxiti për bamirësi ndaj të varfërve. Ai nuk la njeri që të ketë dhembshuri për të, prandaj sot nuk ka ushqim për të, vetëm qelb që rrjedh nga lëkurat e djegura. Ky është ushqimi i gjynahqarëve të mëdhenj, se mohuan Allahun dhe ia kthyen shpinën të Dërguarve të Tij.

Ndërkohë, besimtarët do jenë mes kopshteve dhe vreshtave të përjetësisë. Në Xhenete i zgjasin gotat njëri-tjetrit përplot gaz e lumturi. Atje nuk do të dëgjojnë fjalë të kota dhe as gënjeshtër, por vetëm selam mbas selami, nën hijen e pemëve të sidrit të butë, pa gjemba, nën gurgullimën e ujit të ftohtë që nuk ndalon, mes frutave lloj-lloj që s'kanë të sosur... Shpërblim për punët e mira që bënë në dynja.

Xhindët

Teksa bisedonin njëri me tjetrin, nëna e besimtarëve, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, e pyeti të Dërguarin e Allahut, alejhis-selam: *“O Pejgamber i Zotit, a ke kaluar ditë më të vështirë se dita e betejës së Uhudit?”* Profeti, alejhis-selam, u përgjigj: *“Shumë vështirësi kam kaluar nga Kurejshët, ama kurrë nuk e harroj zorin që përjetova në Taif, kur u takova me Ibn Abdi Jelilin. Ai nuk iu përgjigj thirrjes sime për në Islam. Mandej u largova i brengosur. Kam qenë i përhumbur derisa arrita në një vend të quajtur Karn el Menezil. Aty ngrita kokën dhe pashë një re të vogël tek më bënte hije. Hodha vështrimin drejt saj dhe vështrova Xhebrailin, i cili m'u drejtua e më tha: “Allahu ka dëgjuar çfarë u the atyre dhe si ta kthyen. Allahu të ka dërguar melekun e kodrave, të cilin mund ta urdhërosh ç'të duash.” Pastaj dëgjova zërin e melekut, që më tha: “O Muhamed, ja ku jam. Ç'dëshiron të bëj me banorët e Taifit? Nëse ke dëshirë, ia rrëzoj këto dy kodra mbi koka, ti vetëm urdhëro.”*

“Jo, jo!” ia ktheu Pejgamberi, alejhis-selam, *“Shpresoj se Allahu do të bëjë nga pasardhësit e tyre, të tillë që e adhurojnë të Vetëm e të Pashoq!”*

Kur e përgënjeshtroan shpalljen dhe i torturuan pasuesit e tij si mos më keq, Profeti, alejhis-selam, filloi të kërkonte troje të tjera ku mund të përhapte dritën e udhëzimit. I Dërguari,

alejhis-selam, përzgjodhi Taifin. Fisi i Profetit, beni hashim, kishin lidhje të ngushta me banorët e Taifit, ndaj ai shpresonte të gjente strehë dhe mbështetje nga vendasit.

Për të mos rënë në sy të hasmit, Profeti, alejhis-selam, doli nga Meka në këmbë. Asokohe askush nuk ndërmernte udhëtime të gjata pa kafshë bartëse, për shkak të të nxehtit përvëlues. Kështu askujt nuk i shkonte në mendje se Muhamedi ishte nisur drejt Taifit, meqë rruga ishte shumë e gjatë dhe e lodhshme. Profeti u nis bashkë me Zejdin, djaloshin besnik që kishte rritur shtatin nën përkujdesjen e tij. Me gjithë vështirësitë që u përballën gjatë rrugës, me ndihmën e Allahut mbërritën.

Me të shkelur Taifin, Profeti, alejhis-selam, ia mësyu derës më të madhe të fisit Thekif, kryeparëve të familjes El-Ehlef, të cilët u mbanin krahun fisit Kurejsh. Ata ishin tre vëllezër, bijtë e Abdi Jelilit. Mirëpo ata, jo vetëm nuk e pranuan thirrjen e të Dërguarit, alejhis-selam, por edhe u sollën si mos më keq me të. Kryetarët e fisit urdhëruan robërit dhe mendjelehtit nga mesi i tyre ta tallnin Muhamedin kudo që t'i shkelnin këmbët në Taif. Kështu, u qepën pas të Dërguarit... kush e shau, kush e talli, kush e shtyu e kush e gjuajti me gurë. Këmbët iu çanë sikur të kish kaluar mbi ferra. Trupin ia goditën dhe gjaku i tij i pastër rrodhi rrugicave të Taifit, teksa përpiqej të largohej nga turma e jobesimtarëve që nuk i ndahej. Kushedi si do të shkonte halli i tij, sikur mos ta kishte Zejdin, që mundahej me mish e me shpirt ta mbulonte trupin e Pejgamberit me trupin e vet, nga rrebeshi i gurëve që fluturonin mbi ta.

Të prishurit e ndoqën të Dërguarin, alejhis-selam, deri në të dalë të Taifit. Mbasi u shkëput nga turma, Muhamedi, alejhis-selam, u ndal ta merrte veten nën hijen e një peme. I lodhur e i sfilltur, Pejgamberi, alejhis-selam, ngriti duart nga qielli dhe filloi të lutej: *"O Allah, o Zoti im! Unë të lutem të më dhurosh fuqi e të dal nga vështirësitë që më kanë kapluar! Të lutem të më mbrosh nga poshtërimi! O Mëshiruesi i mëshiruesve, Ti je*

Kujdestari i të dobët. Ti je Kujdestari im. Të lutem mos më lër në mëshirën e të huajve që më pritën me armiqësi! O Zoti im, mos më lër në duart e tyre! O Krijuesi im, nëse Ti nuk je i hidhëruar me mua, unë nuk mërzitem për gjithë vuajtjet e mia. Kujdesi yt ndaj meje është tejet i madh. Kërkoj strehim tek Ti, duke iu mbështetur dritës së Fytyrës Tënde, me të cilën ke larguar errësirat dhe sundon këtë botë dhe botën tjetër! Të lutem ta largosh hidhërimin Tënd prej meje dhe t'më dhu-rosh mëshirë derisa të arrij kënaqësinë Tënde! La haule ue la kuuete ila bilah!"

Posa e mbaroi lutjen, Allahu iu përgjigj dhe i dërgoi Xheb-railin Fisnik dhe melekun e kodrave i cili ishte gati t'i ndësh-konte banorët e Taifit, por Pejgamberi nuk pranoi se shpresa ia ngrohte akoma zemrën.

Teksa, rrinte nën hije si zog i drobitur nga fluturimi i gjatë, dy burra nuk ia ndanin sytë. Ata e shihnin prej nga Profeti s'i shihte. Kush ishin vallë? Bash, Utbeja dhe Shejbeja, dy djemtë e Rebias, bijtë e njërit prej kokave të fisit Kurejsh. Megjithëse e quanin armik të Kurejshve, Allahu ua zbuti zemrat, kur e panë Muhamedin në pikën e hallit. Kështu, i thanë Adasit, robit të tyre që ishte i krishterë: "Merre shpejt një tabaka, mbushe me hurma të freskëta, mandej shko me ta dhe shërbeji dy udhëtarëve që pushojnë nën pemë!" Ashtu bëri djaloshi. Me t'iu afruar dy të panjohurve, i përshëndeti me bujari, ua uli tabakanë përpara dhe u tha: "Urdhëroni! Hani o shtegtarë!" Pejgamberi, alejhis-selam, ktheu kokën lehtë, e pa në sy me përzemërsi dhe zgjati dorën drejt kalaveshit me hurma. "Bis-milah!", tha dhe filloi të përtypte mishin e njomë të hurmës. Adasi ia nguli shikimin fytyrës së të Dërguarit, alejhis-selam, dhe i tha me habi:

– *Pasha Allahun, banorët e këtyre krahinave nuk e për-mendin këtë fjalë që thatë ju!*

– Po pse, – ia ktheu i Dërguari, alejhis-selam, – Prej nga je ti djalosh dhe cila është feja e jote?

– Unë jam i krishterë, – tha djaloshi, – dhe jam nga banorët e Ninevës.

– Nga qyteti i njeriu të mirë, Junus ibn Metah? – e pyeti Pejgamberi, alejhis-selam.

– Po ku e njihni ju Junus ibn Metan? – ia ktheu me habi djaloshi.

– Ai është vëllai im në fe, – i tha Pejgamberi, alejhis-selam. – Ai ishte Pejgamber sikurse unë.

Me të dëgjuar këto fjalë Adasi u përul kah Pejgamberi, alejhis-selam, dhe zuri t'ia puthte kokën, duart dhe këmbët. Tek shihnin nga larg, vëllai i tha vëllait: “Muhamedi e mori në qafë edhe robin tënd me sa shihet. Edhe pak dhe do të të kundërvihet edhe ty.”

Kur u kthye djaloshi tek bijtë e Rebias, dy vëllezërit i thanë:

– I mjeri ti more Adas! Pse ia puthte kokën atij njeriu?

– O zotërinjtë e mi, nuk ecën mbi tokë njeri më i mirë se ai. Pak më parë më tregoi për gjëra që nuk i di askush veç një Pejgamberi.

Biri im, me të drejtë mund të pyesësh se ç'lidhje ka udhëtimi i Profetit, alejhis-selam, me xhindët? Kur i Dërguari, alejhis-selam, po kthehej i lodhur e i trishtuar nga Taifi, u ndal në një vend të quajtur Nahle. I rraskapitur, vendosi të kalonte natën aty. Ndërsa errësira mbuloi Nahlen, ai u ngrit për namaz. Kështu filloi të lexonte Kur'an, e mos pyet për leximin e tij?! Zëri i Pejgamberit ua tërhoqi vëmendjen disa xhindeve që udhëtonin andejpari.

– Ç'është ky zë njeriu në zemër të natës? – tha njëri prej tyre.

– O burra, shpejtoni të marrim vesh kush këndoka në errësinë!”

Ishin shtatë xhindë që jetonin në tokat e Nusejbinit. Sa hap e mbyll sytë u afruan andej nga vinte zëri. *“Heshtni që ta dëgjojmë se ç’po këndohet!”*, ia priti njëri. *“Mos bëni zhurmë e të biem në sy!”*, tha tjetri. Fjalët e Kur’anit i goditën thellë. Të mahnitur nuk lëvizën nga vendi, derisa dha selam i Dërguari i Allahut, alejhis-selam. Aty për aty e përqaftuan Islamin. Mesazhi që u refuzua nga banorët e Taifit, u pranua nga banorët e padukshëm të një krahine tjetër. Ata mësuan porositë e Islamit nga i Dërguari i Allahut, pastaj u kthyen si shigjeta në tokat e tyre, thirrës, pasues të Muhamedit, alejhis-selam.

Kur mbërritën, nuk ishin më të njëjtët. Imani ua kishte ndriçuar mendjet, ndaj u ngritën në mesin e popullit dhe thanë: *“O populli i ynë! Mbrëmë dëgjuam një Pejgamber tek lexonte në errësirën e natës ajetet e një libri qiellor, të zbritur pas Teuratit. Fjalët e tij na mahnitën. Porositë e tij të udhëzojnë nga e mbara dhe e vërteta, ndaj ne u bëmë muslimanë.”*

“O populli ynë!”, thanë njëzëri, *“Përgjigjuni edhe ju thirrjes së këtij Pejgamberi, i cili thërret për tek Allahu dhe besojini atij, që i Madhi Zot t’ua falë gjynahet dhe t’u shpëtojë nga dënimi i tmerrshëm, i përgatitur për mohuesit! Kush nuk i përgjigjet këtij Pejgamberi, le ta dijë se herët a vonë do të dënohet. E kush mund t’i fshihet Allahut?! Ata që mendojnë se mund t’i shpëtojnë të Madhit Zot, janë të humbur e të dështuar.”*

Bir i dashur, këto xhindë të urtë na mësojnë se Islami na nxit për t’i ftuar edhe të tjerët tek kjo fe e dëlirë, duke u treguar të matur e të duruar, siç u treguan të Dërguarit e Allahut dhe pasuesit e tyre prej njerëzve dhe xhindeve.

Paramendo gëzimin e Pejgamberit, alejhis-selam, kur pranuan islamin ky grup xhindësh. Tashmë ai e kuptoi se nuk është vetëm. Tashmë edhe krijesa të një bote tjetër e morën përsipër përhapjen e Teuhidit dhe kundërshtimin e shirkut.

Allahu i Lartësuar i shpalli të Dërguarit të Tij suren “Xhin”, për t’ia ngrohur zemrën dhe për t’i treguar se munda i tij në përhapjen e thirrjes nuk shkoi kot: *“Thuaju njerëzisë o i Dërguar: Allahu më ka shpallur se një grup xhindësh më besuan dhe të mrekulluar thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kur’an (lexim) të mahnitshëm, që udhëzon për nga e mira ndaj i besuam, e pas këtij besimi kurrë s’do t’i bëjmë shirk Zotit tonë. U lartësoftë madhështia e Zotit tonë, nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Tij! Ndryshe nga ç’thonë idhujtarët për Të, Ai nuk ka as bashkëshorte dhe as fëmijë. Këto gënjeshtër i sollën të paditurit nga mesi ynë, ndërsa ne mendonim se as njerëzit dhe as xhindët nuk mund të shpifnin gënjeshtër për Allahun. Ama, ky Kur’an e nxori të vërtetën në shesh, ndaj ne nuk zmbropsemi më nga rruga e drejtë.”*

Bir i dashur, më dëgjo me vëmendje se kjo që po të them ka rëndësi të madhe! Dije se melekët janë robërit e vërtetë të të Madhit Zot. Ata janë ushtria e Allahut, nëpërmjet të cilëve zbatohen urdhrat e Zotit në qiej e në Tokë. Ngaqë kanë fuqi dhe aftësi të jashtëzakonshme, disa prej tyre kanë për detyrë të bartin Arshin e Allahut, disa zbresin shpalljet hyjnore, disa shkruajnë veprat e njerëzisë, disa ua marrin shpirtat, disa ruajnë portat e qiejve, disa fluturojnë mes qiellit dhe Tokës duke shtyrë retë përplot me shi, disa ruajnë Xhenetin, disa ruajnë zjarrin, një tjetër i fryn *Surit*, të tjerë u bëhen krah në luftë besimtarëve, disa kështu e të tjerët ashtu. Sa herë që Allahu i Lartmadhërishëm vendos të bëhet diçka lajmëron disa prej melekëve e këta e përcjellin urdhrin nga njëri tek tjetri, prej njërit qiell në tjetrin: *“Sot t’i falet shpirti filanit! Sot t’i merret jeta filanit! Nesër të zbritni reshjet këtu e mbasnesër atje! Sot kjo e nesër qjo!”*

Motmoti xhindët e kishin zakon të ngjiteshin lart në sferat qiellore dhe të përgjonin diç nga lajmet dhe urdhrat që u përcillnin melekët njëri-tjetrit. Pasi vidhnin lajmet e të ardhmes,

zbrisnin në Tokë dhe ia tregonin magjistarëve dhe fallxhorëve se ç'do ndodhte me filanin ose me fistekun, kujt do i merrej jeta sot e kujt nesër, mbi tokën e kujt do zbriste shiu sot, nesër e mbasnesër... Magjistarë e falltarë mbaheshin me të madh në mesin e njerëzve se gjoja e njihnin gajbin. Kështu njerëzia menduan se magjistarë e fallxhorë na e ditkan të ardhmen. Mandej u dyndën dyerve të tyre duke u dhënë gjithçka që u kërkonin si e si të merrnin vesh diç nga ajo që mund t'u ndodhte nesër. Mirëpo magjistarë e falltarë nuk dinin veç ndonjë lajm tek-tuk e jo më shumë, ndaj atij lajmi i vishnin edhe njëqind gënjeshtër dhe mashtronin njerëzinë.

Prandaj kur xhindët besimtarë e thirrën popullin e tyre në rrugën e besimit të drejtë u thanë: *"O populli i ynë! Ne u ngritëm lart në qiell, të merrnim haber për këtë libër, por e gjetëm të stërm bushur me melekë të ashpër që bënë roje anëkënd dhe përplot shkëndija të zjarrta meteorësh, tamam siç përmendej në Kur'an. Dikur ne fshiheshim nëpër skutat e qiellit për të dëgjuar prej melekëve se ç'do ndodhte në Tokë, për t'ua përcjellë lajmet fallxhorëve, mirëpo kush përgjon sot goditet me shkëndija të përflakura meteorësh."*

Duke parë këtë ndryshim në sferat qiellore, e kuptuan se diçka e jashtëzakonshme po zbriste në Tokë, ndaj thanë: *"Ne, as vetë, nuk e dimë nëse po u afrohet shkatërrimi banorëve të Tokës, apo Zoti i tyre dëshiron t'i udhëzojë për nga besimi?!"*

"O populli i ynë!", iu drejtuan farefisit, "Me të vërtetë prej nesh ka xhindë punëmirë ashtu siç ka edhe të prishur, ama gjithmonë e kemi ditur se kurrë nuk mund t'i shpëtojmë Allahut. Askund nuk mund t'i fshihesh Zotit, as në qiej dhe as në Tokë. E pamundur është të largohesh nga pushteti i të Lartmadhërishmit. Nuk ka skutë që të mbron prej të Madhit Zot, veç nënshtrimit ndaj Tij. Prandaj, ne, sapo e dëgjuam Kur'anin që lexonte i Dërguari i Allahut, i besuam pa mëdyshje, sepse kushdo që u beson fjalëve të Zotit do i dhurohet mbarësia dhe do jetë i mbrojtur nga e liga."

"O populli ynë!", u thanë xhindëve të tjerë. "Tashmë në mesin tonë ka muslimanë, por ka edhe të pabindur. Ama, lum për muslimanët që pasuan rrugën e nënshtrimit ndaj Zotit. Ata dhe vetëm ata ia kanë qëlluar të vërtetës, ndaj do jenë të bekuar në dynja e të shpëtuar në Ahiret. E mjerë, për të pabindurit që ia kthyen shpinën Kur'anit... në dynja të mallkuar dhe në Ahiret të djegur e përjetësisht të dënuar."

Disa muaj më pas, tek Pejgamberi, alejhis-selam, erdhi një grup edhe më i madh xhindësh, për të dëgjuar fjalët e Allahut. Një natë, disa sahabë dolën me të Dërguarin, alejhis-selam, nga Medineja për të kuvenduar. Pas kuvendit ai u largua nga sheshpushimi dhe sikur humbi në errësirën e natës. Kaloi pak kohë, ndaj sahabët filluan ta kërkonin rreth e përqark, ama nuk i gjendej nami as nishani. *"Mos ta kenë marrë xhindët?"*, mendonin shokët e tij, *"Apo, mos u thëntë, ta kenë mbytur!"* Natë më të keqe nuk kishin kaluar ndonjëherë. Kur ja, në të zbardhur Pejgamberi, alejhis-selam, u kthye.

– *Ku na humbe, o i Dërguari i Allahut?* – i thanë sahabët,
– *Kërkuam gjithandej për ty, por nuk mundëm të të gjenim.*

– *Kur u largova pak nga ju,* – tha i Dërguari, alejhis-selam,
– *m'u afrua një xhind dhe më kërkoi të lexoja Kur'an për të dhe shokët e tij. Kështu unë e shoqërova deri tek vendstrehimi i tyre dhe u lexova Fjalën e Allahut.*

Mandej, Pejgamberi, alejhis-selam, i mori shokët e tij dhe u tregoi gjurmët e tyre dhe gacat e zjarrit rreth të cilit kuvendonin.

Xhindët i kishin kërkuar ushqim dhe Pejgamberi, alejhis-selam, u ishte përgjigjur duke u thënë: *"Çdo kockë që bie në duart tuaja, mishi i të cilës është ngrënë nga njerëzit me bismillah, Allahu do ta veshë edhe një herë me mish për ju, dhe bajgët e kafshëve tona do t'i shndërrojë në ushqim për kafshët tuaja."*

Biri im! Xhindët nuk janë fantazma dhe as vegime, por janë krijesa. Siç të kam mësuar më parë, Allahu i ka krijuar nga zjarri, por ata nuk janë zjarr. Edhe njerëzia është e krijuar nga dheu, por nuk është dhé. Ashtu si njerëzit, edhe xhindët hanë e pinë, sëmuren e shërohen, martohen e trashëgojnë, jetojnë dhe vdesin. Allahu i ka urdhëruar ta adhurojnë të Vetëm e të Pashoq, ashtu siç na ka urdhëruar edhe ne. Shumë të paditur nuk besojnë te xhindët, mbasi nuk shihen. Ama, jo çdo gjë që nuk shihet nuk ekziston.

Në anën tjetër, mot edhe sot, ka njerëz të cilët mirë se u besojnë xhindëve, por edhe ua kanë frikën. Madje shumë prej tyre u luten e u përgjërohen duke u kërkuar ndihmë. Kështu, xhindët bëhen mendjemëdhenj e kapadainj tek i shohin njerëzit të nënshtuar ndaj tyre, madje ua fusin frikën në palcë që t'i përkushtohen edhe më shumë. Motmoti, kur ndonjë karvan kalonte përmes ndonjë lugine të shkretë, bërtisnin me të madhe nga frika: *"Kërkojmë mbrojtje prej xhindit që zotëron këtë luginë nga mendjelehtët e fisit të tij!"* Do u mjaftonte të thoshin lutjen që na ka mësuar i Dërguari, alejhis-salam, dhe asgjë s'do u kish ndodhur. *"Eudhu bi kelimetil-lahi tammati min sherri me halek!"* (Mbrohem me fjalët e përsosura të Allahut nga sherri i asaj që ka krijuar)"

Sidoqoftë, nuk janë të gjithë xhindët njëlloj. Në mesin e tyre ka xhindë muslimanë, jomuslimanë, të mirë e të ligj. Të ligjtë nga mesi i tyre, shejtanët siç u thuhet janë armiqtë e përbetuar të njeriut. Për më tepër janë edhe të padukshëm për syrin. E si t'ia bëjmë me ta, pyesin të frikësuar të paditurit, kur as nuk i shohim? Mjafton ta adhurojmë Allahun e Lartësuar, t'i zbatojmë porositë e Tij dhe ta lusim të na mbrojë prej shejtanit, mbasi edhe shejtani është nën pushtetin e Tij. Asgjë nuk lëviz, as në qiej dhe as në Tokë, vetëm se me lejen e Allahut.

Prandaj ne lutemi duke thënë: *"O Allah i Lartmadhërishëm, na ruaj nga armiku ynë i përbetuar, ngase nuk e shohim dot, kurse Ti e sheh atë, ndërsa ai nuk të sheh Ty!"*

Djali dhe mbreti

Një kohë e një mot na ishte një mbret zullumqar, ballaban që e mbante veten për zot. Thuhet se quhej Dhu Nuvas dhe sundonte krahinat e Nexhranit. Ai kishte arritur ta mashtronte njerëzinë se ishte i plotfuqishëm nëpërmjet një magjistari që ia mbante krahun. Ama koha kalonte dhe magjistari filloi të plakej. Mjekra iu bë bardh si bora, por zemra e zezë si nata pa yje. Në vend që të pendohej për ligësitë që kishte gatitur gjatë jetës, një ditë prej ditësh i tha mbretit: *"Unë kam filluar të plakem, ndaj ma gjej një djalosh t'ia mësoj magjinë, se përndryshe s'e ke të gjatë!"*

Mbreti organizoi një garë ku morën pjesë gjithë rinia. Mbas shumë e shumë lojrash, dyluftimesh dhe marifetesh, fitues doli një rinok nga cepi më i largët i qytetit, një djalosh me shtat të hedhur, sapo i kishte dalë pushi faqeve. Ishte i ri, ama zemrën e kishte trime dhe mendjen e hollë.

Kështu filloi djali mësimin e magjisë. Përditë vinte nga skaji i qytetit në oborrin e mbretit dhe takohej me magjistarin që i mësonte me zell zanatin e lig. *"Pushteti dhe fuqia arrihet duke mbjellë frikë në zemrat e njerëzisë nga e panjohura,"* e mësonte magjistari. *"E panjohura e magjeps njeriun dhe njeriu i magjepsur është lodër në duart e tua, o djalosh,"* i thoshte djaloshit dhe faqet e zhubrosura nga pleqëria i zhyteshin ndërmyet nofullave. *"Magjia dhe nënshtrimi i njerëzve është puna e jonë, ndaj tregohu i bindur ndaj meje se do t'i kesh njerëzit në pëllëmbë të dorës!"*

Hajde ditë e shko ditë, djaloshi vinte nga skaji i qytetit që të mësonte të ligën. Me shkathtësi përvetësonte marifetet e magjisë, por magjistarin nuk ia donte zemra se ishte i vrazhdë dhe përherë i ngrysur. Mbreti dhe magjistari përpiqeshin ta bënë djaloshin mik të shejtanit, por i Madhi Zot dëshironte tjetër gjë për të. E kështu djaloshi u udhëzua drejt së vërtetës, megjithëse ishte në krahët e magjistarit dhe përkujdesjen e mbretit. E si ndodhi kjo mund të thuash ti?

Një ditë prej ditësh, përgjatë rrugës së tij drejt pallatit mbretëror, djaloshi takoi një murg të thyer në moshë, megjithatë i mbajtur dhe i plotë nga shtati. Pamjen e kishte fisnike, fytyrën nur, mjekrën e bardhë e vetullën e trashë si degë bredhi.

– Urdhëro, – i tha murgu, – ulu të kuvendojmë, se të solli Zoti!

U ulën këmbëkryq në lëndinën me bar që ulej e ngrihej nga filladi mëngjesor si valë deti. Murgu e pyeti hollë–hollë se kush ishte, prej nga vinte dhe ç’e mirë e kish sjellë nga ato anë, ndërkohë djali i rrëfente gjithçka me çiltërsi. I tregoi fillim e mbarim se ç’ndodhte në qytet dhe se si kish filluar të mësonte magjinë në pallat. Teksa djali fliste, plaku i mençur e dëgjonte me durim dhe pa e ndërprerë. Pasi e mbaroi fjalën djaloshi, murgu i tregoi se dikur edhe ai kishte jetuar në qytet, por ishte larguar që andej kur mbreti e kishte kërcënuar me vdekje, ngase u mësonte besimin e drejtë njerëzisë.

– E ç’është besimi i drejtë, o plak bujar? – i tha djali. – A s’ma tregon?

– Të besosh Allahun, Krijuesin e gjithësisë, o bir, e të mos adhurosh askënd veç Tij. Ai është një Zot i vetëm. Ai nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë, ndërkohë çdokush e çdo gjë ka nevojë për Të. Ai nuk ka fëmijë, as bashkëshorte, as prind dhe askush nuk është i ngjashëm me të.

Mandej plaku i foli për të Dërguarit, për librat qiellorë dhe Ahiretin e djalit iu ngroh zemra. *Mendje ndritur e zemërflori duket.*”, thoshte djali me vete, *“Fjalën e paska mjaltë e kaluar mjaltës.”*

– *Do vij të të takoj edhe një herë kur të kthehem, o njeri i mirë!* – i tha djali. – *Tash po të përshëndes se më presin në pallat.*

Kur mbërriti në pallat, djali shkoi drejt e te magjistari, i cili po e priste me kohë. *“Ku ishe?”*, e pyeti me inat dhe e vështroi sikur desh ta përpinte me sy. *“Rrugë e gjatë mjeshtër.”*, u përgjigj djaloshi me kokën ulur. *“Rrugë e gjatë, ëëëë....?”*, ia ktheu me inat magjistari dhe e goditi fort në kokë me bastun. Gjaku ia lau ballin e ndritur djaloshit, por ai u mbajt e nuk bëri zë. Gjithë ditën qëndroi me magjistarin e në të ngrysur u largua nga pallati. Rrugës për shtëpi, e takoi përsëri murgun fisnik.

“Ç’të paska ndodhur vallë, o bir?”, e pyeti plaku djaloshin, kur vuri re plagën sipër ballit.

“Më goditi magjistari, o plak bujar”, ia ktheu djaloshi, *“se vonova pak.”*

“Nuk e kam hall plagën, jo”, tha djali, *“por, nuk di se si do t’ia bëj nesër, se ma do zemra të rri pak me ty, o njeri i mirë?”*

Murgu ngrysi ballin dhe vrau mendjen, mandej i tha: *“Dëgjo, bir! Nëse ke frikë magjistarin thuaji se më vonuan prindërit dhe nëse ke frikë prindërit thuaji se më vonoi magjistari.”*

Kështu djali sa herë që shkonte tek magjistari dhe kurdo që kthehej në shtëpi ndalej tek murgu dhe kuvendonte me të për besimin e drejtë.

Sot kështu e nesër ashtu ikën e kaluan muajt pa u ndjerë. Ama, një ditë prej ditësh, teksa djali kthehej për shtëpi, vuri re në shpatin e malit për nga i binte rruga një grup njerëzish, që as nuk bënë para dhe as nuk ktheheshin.

"Si e keni hallin o udhëtarë?", u thirri djali, "Përse nuk na bëni rrugë e të kalojmë shpatin?"

"Eja, eja o djalosh!", ia pritën njëzëri, "Eja e shih nga afër pse nuk kalojmë shtegun!"

Afrohet djali, kur ç'të shohë! Një kafshë e madhe kishte zënë rrugën dhe askujt nuk ia mbante të kalonte pranë saj. Djali bëri të ecte, por bisha skërmiti dhëmbët dhe u bë gati për sulm. Fytyra e djalit u errësua mandej për çudi iu çel prap. Iu afrua edhe më bishës dhe tha me vete: *"Sot do ta kuptoj se cili është në rrugën e drejtë: magjistari apo murgu."*

Shtrengoi një gurë me të djathtën, mori nishan dhe tha: *"O Allah! Nëse ajo që më mëson murgu është më e dashur për Ty sesa çfarë më mëson magjistari, atëherë vrite këtë kafshë që të kalojnë njerëzit!"* Bismilah, e goditi kafshën dhe ajo ra e ngordhur sa gjerë gjatë sikur ta kishte goditur rrufeja. Njerëzit mbetën gojëhapur. Nuk iu besonin syve. Si është e mundur që një bishë e tillë të vritet me një gur? Të mahnitur iu afruan djali... kush ia rrahi shpatullat, kush ia ngriti burrërinë, kush trimërinë, kush kështu e kush ashtu, ama djali nuk lëvizte vendit. Fjalët e lëvdatat nuk e ngazëllyen aspak. *"O njerëz!", jehoi zëri i djalit, "Bishën nuk e mbyta unë, jo."*

"Si nuk e mbyte ti? Ne të pamë kur i re me gur."

"Ju më patë tek gjuajta me gur, por s'më dëgjuat kur iu luta Allahut. A mendoni se një bishë e tillë vritet me një gur petashuq? Allahu caktoi vdekjen e saj. Allahu na e liroi shtegun."

"Po kush është Allahu, o djalë?"

"Allahu është Krijuesi i Gjithësisë, Zoti im dhe i juaji, Mirëbërësi i Urtë dhe i Gjithëditur."

Tërë nata i kaloi zgjuar djaloshi. I zhytur në mendime, mezi priti agimin që t'ia kallëzonte murgut ndodhinë. Si përherë doli

me terr nga shtëpia. I dha këmbëve dhe me një frymë arriti tek murgu, të cilin e lajmëroi për ndodhinë në shteg.

"O djalosh! Sot ti je më i aftë se unë.", i tha murgu zemërbardhë.

"Me sa shoh, bujaria e Allahut ndaj teje është e madhe, por mbaj vesh: ti me siguri do të sprovohesh. Nëse ndodh kjo, mos i trego njeriu për mua!"

Që nga ajo ditë djali nuk shkeli më në pallatin mbretëror dhe as që u takua më me magjistarin. Me mish e me shpirt iu përkushtua adhurimit të Allahut dhe nxënies së diturisë, ndaj Allahu e ngriti lart e më lart. Emri i tij mori dhenë. Ditë për ditë djaloshi priste e përcillte mysafirë... kush vinte për të mësuar besimin e drejtë, kush vinte për të kuvenduar me të e kush për shërim. U hap fjala se djali shëronte të verbërit, lebrozët dhe lloj-lloj sëmundjesh përmes lutjeve.

Këto fjalë ranë në vesh vezirit të mbretit. Ai ishte i verbuar qëmoti ndaj vendosi të shkonte tek djaloshi çudi-bërës. Kështu u nis me shërbëtorë dhe dhurata të shumta. Me të hyrë veziri përshëndeti me dorë në zemër, me trup që përkulej para dhe me sy të perënduar: *"Mirëse të gjej o djalë bujar!", iu drejtua djaloshit.*

"Mirëse vjen o burrë fisnik!", ia ktheu djali me përzemërsi, "Ç'e mirë të solli tek unë?"

"Sytë, mor djalë, sytë...", tha burri, "Më është shuar drita, a nuk më sheh?"

"Nëse ti do t'më shërosh", tha veziri, "të gjitha këto do të jenë të tuat."

"Unë nuk jam i aftë të shëroj askënd", iu përgjigj djali, "Allahu është Ai që shëron. Nëse beson në Allah, unë do ta lus të të shërojë."

"E ç'duhet të besoj, o djalë?"

"Të besosh se nuk meriton të adhurohet askush veç Allahut, sepse Ai na ka krijuar, Ai na fali jetën, Ai na dërgoi shpallje e Pejgamberë që të udhëzohemi në rrugën e mbarë, Ai na ushqen dhe na e shuan etjen me begatitë e tokës dhe qiellit, Ai na shëron kur sëmuremi, Ai do të na ringjallë në Ditën e Gjykimit dhe do na marrë në llogari për punët tona."

"Sa të vlera qenkan fjalët e tua, o djalë!", tha veziri, "Unë dëshmoj, pra, se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush veç Allahut, i Cili është i vetëm dhe pa ortakë!"

Pasaniku besoi, djali u lut dhe Allahu e shëroi. Për një çast drita u ndez edhe një herë në sytë e vezirit. I qeshi fytyra burrit si të ishte diell kur del nga retë. Mos pyet për gëzimin e tij! E përqafoi me mallëngjim djaloshin, e falenderoi dhe u nis për udhë...Me t'u kthyer në pallat veziri shkoi tek dhoma e kuvendit. Kur hyri, i bënë vend në ndenjë si ishte zakoni e ky u ul pranë mbretit. Mbreti i habitur i tha: *"Kush ta riktheu shikimin, o vezir?"*

"Allahu", iu përgjigj burri, "Zoti im."

"Si the?", ia ktheu mbreti, duke vërtitur kokën si gjarpri, "A ke ti zot tjetër veç meje?"

"Ti nuk je zot.", i tha veziri, "Allahu është Zot, Zoti im dhe i joti."

Kur pa trimërinë e vezirit, mbreti u xhindos e u ngrit në këmbë. U mundua ta frikësonte ashtu si e kanë zakon mbretërit, por ai nuk trembej. Mbreti e pyeste e veziri ia kthente me gjuhë të hollë. Kështu iu sos durimi ballabanit dhe urdhëroi ta torturonin... Kaq shumë e torturuan, fisnikun, sa nuk mbajti më dhe u tregoi për djalin.

"T'ma gjeni patjetër djalin!", bërtiti tirani, "T'ma sillni shpejt gjallë a vdekur!"

Fjala e mbretit ishte ligj. Kështu, ushtarët e gjetën djalin, e morën dhe ia sollën mbretit. Kur e futën djalin në dhomën e mbretit, askush nuk fliste. Ballabani mjekër gjatë rrinte hundë e buzë përmbi fron. Mbas fronit qëndronin rojet si statuja të frikshme ndërsa nga e majta dhe e djathta oborrarë e vezirë të veshur e të stolisur. Qetësinë e prishi zëri i trashë i mbretit.

"O djalosh! Afrohu, afrohu!"

Djali iu afrua qetë-qetë.

"Kaq mirë e paske përvetësuar magjinë sa arrin të shërosh edhe të verbërin?!"

"Unë nuk shëroj askënd, o mbret." ,iu drejtua djaloshi, "Allahu është Ai që shëron."

"Allahu?", bërtiti ballabani, "E kush është Allahu?"

"Allahu është Zoti im dhe i joti, o mbret.", ia ktheu djali.

"Si theeee? Ti paske Zot tjetër veç meje?"

"Ti nuk je Zot, o mbret. Ti je njeri si të gjithë ne. Ti je i dobët, ti sëmuresh, ti ke vevojë për ushqim që ta mbash frymën gjallë, ti je vdekatar... Ti as nuk ekzistojë derisa Allahu të solli në jetë. A nuk mendon?!"

Mbreti s'u mbajti dot.

"Lidheni dhe torturojeni siç bëtë me shokun e tij!", briti me të madhe.

Xhelatët e torturuan aq shumë, sa nuk mbajti më dhe u tregoi për murgun. Kështu mbreti urdhëroi ta gjenin sa më parë e t'ia sillnin murgun bashkë me vezirin besimdrejtë. Kur ia sollën të lidhur e të prangosur mbreti i tha murgut: *"Hiq dorë nga feja e jote, ose do të të vras!"* Murgu ishte trim e kaluar trimit, kurrësesi nuk pranoi ta braktiste fenë e drejtë. Atëherë mbreti urdhëroi t'a lidhnin mirë plakun dhe t'i sillnin një sharrë. Me t'ia sjellë ia vendosi tehun e mprehtë në ballin fisnik për t'a frikësuar.

"Hiq dorë nga feja e jote, ose të vrava me duart e mija, o plakush!"

"Më mirë i vdekur se i pafe, o mbret!", ia ktheu plaku i mençur.

Kështu mbreti ia çau kokën më dysh, që të frikësoheshin veziri dhe djali. Me sharrën që pikonte gjak iu drejtua vezirit: *"Hiq dorë nga feja e jote, o mik, se do kesh fatin e plakut!"*

"E ç'më duhet jeta pa fé, o mbret?!", ia ktheu veziri.

Nga inati e sharroi edhe atë siç bëri me murgun. Mandej iu kthye djalit: *"Hiq dorë nga feja e jote!"* *"Kurrën e kurrës!",* ia ktheu djali.

"Merreni", urdhëroi mbreti ushtarët, *"dhe shkoni me të në mal. Pasi të ngjiteni në majën më të lartë, urdhërojeni të heqë dorë nga feja e tij dhe nëse s'pranon hidheni poshtë!"*

Ushtarët e morën djalin dhe ia mësynë malit. Ndërkohë djali filloi të lutej: *"O Allah më mbro prej tyre si të dëshirosh Ti, o Zot!"* Teksa i ngjiteshin shpatit, teksa këmbët e tyre shkelnin buzët e humnerës, mali filloi të tundej e të shkundej pa pritur e pa menduar. Të zënë në befasi ushtarët rrëshkitën njëri pas tjetrit e ranë në thellësitë e greminës. Kështu djaloshi u kthye tek mbreti. Kur e pa, ballabani nuk u besonte syve.

"Kush, kush je ti?" e pyeti i shushatur, *"Ku janë ushtarët e mi?"*

"Allahu më ruajti prej tyre, o mbret, ata i përpiu humnera.", u përgjigj djali.

"Allahu! Allahu! Allahu! Ta tregoj un ty!", briti mbreti.

"Merreni përsëri dhe lundroni me të larg shumë larg bregut, shkoni në mes të detit po qe nevoja!", dha urdhër të prerë, *"Atje larg, urdhërojeni të heqë dorë nga feja e tij dhe nëse nuk pranon hidheni në det!"*

Ushtarët e mbretit e morën djaloshin për së dyti, dhe ia mësynë detit. *"O Allah më mbro prej tyre si të dëshirosh Ti!"*, u lut djali. Mbasi hipën në anije, vozitën rremat me të shpejtë deri ku nuk shihej më bregu. Ama, kur po bëheshin gati ta hidhnin në det djaloshin drita e diellit u zu nga re të zeza që lundronin në qiell si anije të frikshme. Nga veriu filloi të frynte tufani, që godiste aq fuqishëm faqen e detit sa e trazoi si kurrë më parë. U ngritën dallgët si kodra dhe e përmbysën anijen mbretërore, mandej një e nga një i kollofitën edhe ushtarët. Mbasi u mbytën të gjithë ikën retë, pushoi era dhe u qetësua deti. Allahu e kishte shpëtuar për mrekulli djalin, e ky tek shtrëngonte një copë direku të thyer rrahte valët me këmbë. Një të shtyrë ia dha fladi detar, krahun ia mbajtën dallgët e detit dhe për pak kohë djali shkeli bregun. Djaloshi u kthye përsëri tek mbreti. Ai ishte i mençur, i matur dhe i duruar. Kur e pa përsëri shëndosh e mirë, mbreti u shastis dhe mbeti si i gozhdur në vend.

"Ku janë ushtarët e mi, o ditëzi?!", briti i lemeritur.

"Allahu më ruajti prej tyre, o mbret, ata i përpiu deti.", u përgjigj me qetësi djaloshi. *"Dhe dije mirë se kurrë nuk do të mund të më vrasësh derisa të bësh atë që them unë."*

"E çfarë duhet të bëj more djalë? Fol çfarë të bëj?"

"Mblidhi njerëzit në një shesh të gjerë.", ia ktheu djaloshi, *"Pasi të mblidhen, mua të më lidhësh në trungun e një palme. Më pas merre një shigjetë, vendose në hark. Tërhiqe fort gjalmin dhe merr shenjë me kujdes. Mandej thirr me zë të lartë: "Bismil-lahi, me emrin e Zotit të djaloshit!" Lëshoje shigjetën mbi trupin tim, se vetëm kështu mund të më vrasësh."*

Ashtu bëri mbreti. E mblodhi njerëzinë në sheshin e madh të qytetit, e lidhi djalin në trungun e palmës, nxori shigjetën nga kapistra dhe e vendosi në hark. Në shesh ra qetësi e frikshme si ajo para fortunës. Ballabani mori shenjë dhe tha

me të lartë: *"Bismil-lahi, me emrin e Zotit të djalit!"* E lëshoi shigjetën dhe ajo goditi trupin e trimoshit, i cili ndërroi jetë sa hap e mbyll sytë.

Bir i dashur! Imani e shtyn njeriun drejt të mirës. Besimtari ua do të mirën njerëzisë, ai dëshiron udhëzimin e të tjerëve në dynja dhe shpëtimin e tyre në Ahiret. Djaloshi ishte i gatshëm të flijonte shpirtin e tij për këtë mision. A nuk ka ardhur koha që edhe ti të flijosh pak nga koha e jote, ta mësosh diturinë e fesë dhe t'i thërrasësh shokët, mësuesit dhe ato që ke përreth për në rrugën e adhurimit të Zotit të Vetëm e të Pashoq?!

Njerëzia brohoriti njëzëri: *"I besojmë Zotit të djaloshit! I besojmë Allahut! I besojmë Zotit të djaloshit!"*

"A e sheh se çfarë bëre?", i thanë oborrтарët mbretit. *"Ndo-dhi ajo nga e cila frikësoheshe. Njerëzia i besuan Allahut!"*

Fytyra e ballabanit u bë prush nga inati. *"Kurrsesi! Kurrsesi nuk lejoj të adhurohet kush tjetër veç meje!"*, briti me zë të ngjirur, *"Kurrën e kurrës!"*

Kështu urdhëroi të hapej një hendek i thellë përgjatë qytetit dhe në brendësi të tij të ndizej zjarr flakërues. Më pas dha urdhër: *"Kushdo që nuk i kthen shpinën besimit në Allah, ta hidhni në hendek e të përcëllohet në zjarr!"* Ashtu bënë ushtarët, por Allahu i Lartësuar i trimëroi zemrat e besimdrejtëve dhe askujt nuk iu tremb syri. Kush e di se sa hodhën në zjarr, derisa morën një grua me foshnjen për gjiri. Kur pa flakën që bubullonte tek ngrihej lart dhe lepinte buzët e hendekut, iu njomën sytë dhe i rrëshkiti një sumbullë loti. Ngase i dhimbsej foshnja që shtrëngonte në gjoks bëri një hap mbrapa, por bebja i foli si në ëndërr: *"O nëna ime, duro se ti je në rrugën e drejtë!"* Atëherë bashkë me foshnjen u hodh në zjarr, për të ruajtur besimin e saj. E dha jetën e kësaj bote dhe fitoi përjetësinë.

Thuhet se në hendekun me zjarr ndërruan jetë mbi njëzetetre mijë besimtarë. Mirëpo ky krim mizor nuk mbeti pa u ndëshkuar. Negusi, mbreti i Etiopisë së asaj kohe, kur mori vesh për lajmin e kobshëm, dërgoi një ushtri prej shtatëdhjetë mijë trimash kundër Dhu Nuvasit gjakatar. Ushtria etiopiane vërshoi si lumi i tërbuar mbi krainat e Nexhranit. U tund toka dhe u shpartallua ushtria e ballabanit. Dhu Nuvasi vrau veten kurse paria e tij u skllavërua. Thuhet se për të marrë hakun e besimdrejtëve të djegur një e treta e burrave të Nexhranit kaloi në tehun e shpatës dhe një e gjashta e grave u skllavërua. Ky është fundi i tiranëve që mundohen të shuajnë dritën e Allahut, ndërkaq dënimi i Ahiretit do jetë më i dhembshëm dhe i përhershëm.

Elefanti

Bir i dashur! Gjashtë vite mbas vendosjes në Medinen e Ndritshme, Profeti Muhamed, alejhis-selam, pa një ëndërr të mirë. Iu shfaq që bashkë me sahabët e vet kishte shkuar në Qabe, kishte marrë çelësat e saj dhe kishin bërë tavafin dhe umren. Siç ta kam mësuar, ëndrrat e Pejgamberëve janë shpallje nga i Madhi Zot, prandaj i Dërguari i Allahut u gëzua tej mase. Menjëherë mbloodhi sahabët dhe i lajmëroi për ëndrrën e mirë. Mos pyet për gëzimin e sahabëve! Që prej gjashtë vitesh nuk e kishin parë Shtëpinë e Allahut, që prej gjashtë vitesh nuk kishin bërë tavafin rreth Saj. Më të mallëngjyerit ishin muhaxhirët, që kishin lindur e ishin rritur në Mekë, por u larguan prej saj që të adhuronin Allahun të lirë dhe të pasonin të Dërguarin e e dëlirë, alejhis-selam.

Kështu u nis Pejgamberi, alejhis-selam, drejt Mekës Fisnike, me muslimanët që i vinin pas, kush në këmbë e kush në deve. Rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme, mirëpo dashuria për Shtëpinë e Shenjtë sikur ua ëmbëlsonte udhëtimin. Gjithçka u shkoi bukur e mirë, derisa mbërritën afër kodrës Thenijeh, mbi të cilën shtrihej rruga drejt Mekës. Për çudi, deveja e Pejgamberit e ndali hapin. I bërtisnin me të madhe: *"Hal! Hal! Hal!"*, por ajo hiç, sikur të ishte e gozhduar në vend.

Sahabët u inatosën me devenë e Pejgamberit, alejhis-selam, kush e tërhoqi, kush e shtyu e kush i bërtiti, por deveja nuk donte t'ia dinte. *"Eeeeh!"*, turfulluan, *"Kasvaja, nuk bindet dhe nuk dëshiron të lëvizë përpara."* Atëherë Profeti, alejhis-

selam, i buzëqeshur ia ktheu qetë e qetë: *"Nuk është kryeneçe Kasvaja, jo, nuk e ka zakon të mos bindet, por e ka ndalur Ai që ndali elefantin."*

Për cilin elefant bëhet fjalë e ç'lidhje ka me Mekën, mund të pyesësh ti?

Po ja, para se të lindte Profeti Muhamed, alejhis-selam, atje larg në tokat e Jemenit, sundonte një mbret i zi. Ebreha i thonin, i krishterë ishte. Thuhet se vinte nga tokat e rreshkura të Abisinisë. Ebrehaja mahnitej me peligrinazhin e arabëve drejt Qabes së Shenjtë ndaj urdhëroi të ndërtohej një kishë e stërmadhe në kryeqytetin e Jemenit, San'asë, dhe ashtu u bë. Mos fol për bukurinë dhe madhësitinë e saj: me shtylla të larta, me dysHEME mermeri, me mure të zbukuruara dhe lloj-lloj pikturash!

"Shpresoj që në të ardhmen kjo kishë t'ia marrë pahun Qabes bashkë me pelegrinët!", mendonte sundimtari. Ama motet kaluan dhe arabët as që e kishin ndër mend të linin Qaben për kishën e San'asë. Kështu mbretit iu sos durimi. *"Po a krahasohet vallë kjo kishë madhështore me një ndërtesë prej guri, pa kolona, pa dritare, pa mermer e pa stoli?"*, mendonte sundimtari, *"Do ta shkatërroj atë ndërtesë pa vlerë! Betohem se do të marshoj drejt Mekës me ushtrinë time e do ta shohin arabët se ç'do t'iu punoj!"*

Brenda pak ditëve përgatiti ushtarët, dhe të kapardisur u nisën drejt Mekës. *"Askush s'më del dot para, jo!",* mendonte mbreti. *"Do ta marrin vesh arabët se kush është Ebrehaja."* Kështu ushtria e arapit të zi nisi marshimin drejt Qabes. Kolorës e këmbësorë të armatosur me shpata, mburoja, ushta dhe hanxharë u derdhën mbi tokat arabe. Me vete kishin marrë edhe një elefant gjigant, me lëkurë të trashë e të zhubrosur, me noçkën rrudha-rrudha, me dhëmbë të gjatë fildishi, me sy të kuq dhe shputa të rënda që shkundnin dheun sa herë përplaseshin mbi tokë.

Ama, edhe arabët ishin trima, ndaj nuk ndenjën duarkryq, por u hodhën në luftë. I pari që i doli në pritë Ebrehasë ishte Dhu Nufari me ushtarë. Megjithëse këta luftuan si burrat, ushtria e Jemenit ishte e shumtë si mizat, ndaj e thyen pritën. Dhu Nufari luftoi si luan e nuk iu dridh syri, mirëpo hasmi e rrethoi nga të gjitha anët dhe e zunë rob. E lidhën dhe e dërguan para mbretit të prangosur, nder për nder se kishte treguar trimëri të madhe. Kur u takua me mbretin, Dhu Nufari i tha: *"Nëse ma kursen jetën është më mirë për ty, o mbret, asgjë nuk duhet i vdekuri!"* Ebrehaja ia fali jetën, por urdhëroi të mbahej i lidhur. Thuhet se edhe fise të tjera u munduan ta ndalnin ushtrinë e Ebrehasë, por u thyen një nga një ...

Pas një marshimi të gjatë ushtria e Ebrehasë mbërriti në Taif, pak ditë larg Mekës. Atje e priti me nderime Mesud Mutalibi bashkë me burrat e fisit të tij, nga frika se mos u shkatërronte tokat dhe u përdhoste nderin. *"O mbret! – iu drejtua me frikë në shtat, – Ne jemi robërit e tu. Qabja nuk ndodhet në tokën tonë, por në Mekë, ndaj na kurse e mos na nënçmo. Nëse dëshiron ne dërgojmë me ty edhe një udhërrëfyes që i njeh mirë shtigjet drejt Mekës!"* Ebreha, pranoi dhe ata dërguan me të një rob të shkathët, të quajtur Ebu Rugal. Pas pak ditë udhëtimi rob i vdiq, ama tashmë qyteti i Mekës nuk ishte fort larg...

Bir i dashur! Burrëria të sjell nder, ndërsa frika turp e poshtërim. Mundohu ta mposhtësh frikën që të lind në zemër herë pas here mbasi kështu bën fisniku! Burri duhet të luftojë, për ta ruajtur atë që e ka të shenjtë në zemër, e jo t'i shtrëngojë dorën hasmit. Kështu vepruan arabët, kur u vu në rrezik shenjtëria e Qabes. Dhu Nufari dhe trimat e tij e dinin se nuk ishin asgjë përballë ushtrisë gjigante të Ebrehasë, megjithatë luftuan deri në frymën e fundit për ta mbrojtur atë që e çmonin, ndaj përmenden edhe sot e kësaj dite. Nga ana tjetër Ebu Rugali, mbeti i urryer dhe u bë simbol i tradhëtisë. Madje thuhet se,

për shekuj me radhë kush kalonte pranë varrit të tij e gjuante me gurë nga urretja për të vdekurin që dergjej nën dhé.

Kur iu afrua Mekes, Ebrehaja dërgoi Hunata el Humejrin tek vendasit. *"Shko në mesin e tyre dhe kërko njeriun më në zë."* i tha mbreti, *"Mandej tregoji se nuk kam ardhur për luftë, por vetëm të shkatërroj Qaben."*

Pasi hyri në qytet, i dërguari i mbretit pyeti për më të nderuarin në Mekë, e kështu e takuan me Abdul Mutalibin, gjyshin e të Dërguarit të Allahut. Mbasi kuvenduan kokë më kokë Hunata i tha: *"O plak i urtë, më ka dërguar mbreti i Jemenit, Ebrehaja, t'ju lajmëroj se nuk ka ardhur për luftë, por vetëm për të shkatërruar Qaben. Sapo ta realizojë dëshirën e tij, do largohet e do ju lërë të qetë në tokën tuaj. Ndaj askush të mos ia presë rrugën!"*

Abdul Mutalibi ishte burrë fort i matur dhe mendjemprehtë. Uli kokën mendueshëm e nuk foli. Pasi e bluajti kërkesën e mbretit, e ngriti kokën përsëri dhe i tha Hunatës: *"Epo, mirë. Ne nuk do luftojmë, por do largohemi nga qyteti. Nëse nuk e ndalon Allahu vërshimin e ushtrisë së tij, ne nuk mund ta ndalim. Ama edhe unë e kam një kërkesë për mbretin tënd. – i tha Abdul Mutalibi Hunatas, – A mund të takohem e t'i flas, o i dërguar?"* *"E pse jo?!"* ia ktheu Hunata. *"Nëse mbreti e pranon takimin me ju, mirë se të vini."*

Kështu Abdul Mutalibi e shoqëroi Hunatan deri tek kampi i ushtrisë së Jemenit. Tek ecte përmes kampit përplot ushtarë, i zuri syri Dhu Nufarin, me të cilin kishte miqësi të vjetër. Iu afrua dhe e përshëndeti me përzemërsi. Mbasi kuvendoi me të dhe e mori vesh si kish qenë halli i Dhu Nufarit, iu drejtua dhe i tha: *"O Dhu Nufar, a mund t'më ndihmosh karshi belasë që më ka rënë mbi shpinë?"*

"E si të të ndihmoj, kur jam i lidhur me pranga dhe nuk kam siguri as për jetën time, more mik i vjetër?" – ia ktheu

Abdul Mutalibit. *"Sidoqoftë, po flas me Enisin, kujdestarin e elefantit. Kam njëfarë miqësie me të, – tha Dhu Nufari, – atij i ecën fjala, kështu që po e porosis të të përmendi për mirë dhe të të takojë me Ebrehanë."*

Dhu Nufari e thirri Enisin dhe i tha: *"O Enis! Ky burrë është kryetari i kurejshve dhe pronari i karvanit të Mekes. Ky fisnik ushqen njerëzinë në lugina dhe egërsirat në male. Mbreti ia ka marrë 200 deve dhe nuk ia kthen. Nëse mund ta ndihmosh, ta di për nder, se e kam shok të vjetër!"*

Enisi i hodhi shikimin kryelakut të Mekes, uli kokën mendueshë, mandej tha: *"Do bëj më të mirën e mundur, o Dhu Nufar, mos kij merak!"*

Kështu, kujdestari i elefantit i foli mirë mbretit për Abdul Mutalibin e ky i dha leje për të hyrë në tendën e tij. Kur hyri, Ebrehaja u mahnit me pamjen e kryeparit. Trupin e kishte të mbushur, fytyrën të rreshkur, mjekrën të dendur, shikimin e thellë dhe hijen e rëndë. Kaq shumë i pëlqeu sa për pak sa nuk e uli në fronin e tij. Mirëpo Ebrehaja ishte mbret, e mbretërit janë krenarë, ndaj nuk lejojnë askënd t'u ulet mbi fron. Kështu, Ebrehaja zbriti vetë dhe u ul pranë Abdul Mutalibit.

– *Si e ke hallin, o burrë fisnik?! – i tha Ebrehaja me zë të trashë.*

– *O mbret! – ia ktheu Abdul Mutalibi, – Më keni marrë pasuri të madhe, plot 200 deve. Për to kam ardhur t'ju takoj.*

– *Si the? – iu drejtua Ebreha duke vrenjtur ballin, – Të pashë me sy të madh kur erdhe, por nuk qenke si mendova.*

– *Pse? – pyeti Abdul Mutalibi.*

– *Unë kam ardhur të shkatërroj Qaben, vendin që shenjtëroni ju dhe baballarët tuaj, kurse ti më flet për deve?*

– O mbret! – tha Abdul Mutalibi, – *Unë jam pronari i de-
veve, kurse pronari i Qabes është Allahu.*

– *Dije pra, se as Allahu nuk mund ta mbrojë dot prej meje,*
– ia ktheu mbreti.

Pas bisedës me të, Ebrehaja ia ktheu devetë Abdul Mutalibit, i cili u kthye me të shpejtë në qytet dhe i lajmëroi kurejshët për qëllimin e mbretit. Mandej, kryeplaku bashkë me kokat e fiseve iu afruan Shtëpisë së Shenjtë. Abdul Mutalibi shtrëngoi fort hallkën e derës së Qabes dhe së bashku me shokët e tij iu lutën të Madhit Zot për ndihmë kundër Ebrehasë dhe ushtrisë së tij. Pasi u lutën gjatë e gjatë, zbrazën shtëpitë dhe bashkë me të afërmit e tyre u nisën kodrave, prej ku mund të shihnin se ç’do bëhej me Qaben. Qyteti mbeti bosh. Kështu Ebrehaja nisi marshimin. Në krye u printe elefanti e nga pas vinte ushtria, që tek hidhnin hapat dridhnin tokën e ngrinin një re pluhuri.

Mirëpo, kur nuk u kish mbetur vetëm pak rrugë për në qytet, elefanti u ndal, e nuk bënte as edhe një hap përpara. Mirë që nuk ecte, por edhe u ul në gjunjë siç e kanë zakon kur duan të pushojnë. Ama, i lodhur nuk ishte, boll kishte pushuar... Ushtarët filluan t’i bërtisnin, e tërhoqën, madje edhe e goditën në kokë, por elefanti nuk donte t’ia dinte. Për çudi, kur e tërhoqën mbrapa, për nga Jemeni elefanti u ngrit e ia mori hapit, ama sapo e kthenin nga Meka ndalej në vend. Thuhet se ushtarët, të inatosur nga kokëfortësia e elefantit, e lëshuan dhe ai mori rrugë drejt maleve.

“Me elefant, a pa elefant, sot do ta rrënoj Qaben,” bërtiti mbreti dhe nisi marshimin. Mirëpo, kur ishin krejt afër qytetit, qielli u nxi dhe dielli e humbi shkëlqimin. Ushtarët ngritën shikimet, kur ç’të shihnin... tufa me zogj detarë kishin mbuluar qiellin si të ishin ré të zeza që sjellin shtrëngatë. Secili zog barte nga tre gurë: një në sqep, e dy i shtrëngonte me kthetra. Mos pyet për klithmat e shpendëve! Llahtari e vërtetë.

Kur ushtria e zogjve u mblodh fluturimthi mbi kokat e ushtarëve i lëshuan gurët njëherësh si rrebesh breshëri. E çfarë breshëri se! Gurët që binin nga lart, godisnin trupat e ushtarëve si të ishin plumba. Kushdo që goditej vdiste në vend me përjashtim të mbretit dhe disa fatlumëve, që ia mbathën andej nga kishin ardhur. Por më kot, nga plagët e marra trupi i Ebrehasë iu ligështua dhe e goditi një sëmundje e rëndë. I ranë thonjtë, iu gangrenizua mishi, qelbi ia mori trupin dhe kështu ra e vdiq sapo u kthye në Jemen... Në Mekë u bë festë e madhe.

Mbas kësaj ndodhie, kurejshët morën nam në mesin e arabëve. *"Ata janë populli i Allahut!– thuhej. – Allahu ua mbajti krahun dhe Allahu u mjafton atyre."*

Mbrojtja e Qabes dhe nderi që fituan kurejshët ishin shenja që lajmëronin për ardhjen në jetë të një njeriu të madh. Mos harro se sikur të luftonin kurejshët kundra Ebrehasë, sigurisht që do e humbnin betejën, do përdhoseshin e do robëroheshin. Kështu, i Madhi Zot e mori Vetë përsipër shkatërrimin e ushtrisë së elefantit në mënyrë që vula e Pejgamberëve të mos lindte në robëri, por i nderuar dhe krenar, në gjirin e një populli që kishte emër të mirë në mesin e të gjithë arabëve. E me të vërtetë, 50 ditë pas kësaj ndodhie lindi vula e Pejgamberëve, Muhamedi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin kurdoherë mbi të.

Tre shokët

Biri im! Tri dashuri të mëdha paska burri në jetë: pasurinë, gruan dhe fëmijët. Kushdo që për hir të Allahut dashuritë e tij i nënshtron, nderohet në dynja dhe kodra sevapesh fiton.

Na ishin një herë tre shokë: një çoban, një pasanik dhe një pronar i madh tokash. Ky çobani kishte një familje mbi shpinë që i priste të gjitha nga duart e tij. Pasaniku ishte rinok dhe i pashëm. Pasuri kishte sa të duash, ar e argjend plot. Ia thyente kokën kujtudo me qese. Kurse pronari, më i vjetri, ishte tregtar i regjur, ama i drejtë dhe i matur. Mos pyet për tokat që kishte trashëguar, për punëtorët dhe gjënë e gjallë që kullosnin bahçeve të tija.

Njëherë u nis me natë çobani, për të kullotur bagëtinë. Si gjithmonë, fill i vetëm me një torbë në krah dhe bastunin në dorë. Asohere ish pranverë, ndaj mali e fusha ishin veshur me të gjelbër. Dielli shkrepri majave, u ngrit lart e lart, po ky ecte pa e ndalur hapin... këmbëshpejtë si lepur. Ku gjente kullosë ndalej, mandej hajt, prap për rrugë. Nuk la shteg e lug pa shkelur, u largua shumë. Kështu, dielli filloi të fshihej pas maleve e ky as që e kish vënë re.

– O Allah! – psherëtiu çobani. – O Zot, sa larg paskam shkuar! Prindërit e familja presin qumështin, e unë kushedi kur mbërrij.

– O Allah! O Zoti im, ma lehtëso kthimin e ma shkurto rrugën se po më presin!

Mori rrugën e kthimit me të shpejtë. Vendin e dinte me pëllëmbë, ndaj nuk vonoi shumë dhe iu afrua shtëpisë. Sa dëgjuan zilet e këmborëve dolën ta pritnin me gaz, grua ja e fëmijët. Çobanit i qeshi zemra, por e mbajti buzën. Përshëndeti gruan dhe u nis e futi gjënë e gjallë në stan. Shpërvjeli mëngët shpejt e shpejt e filloi të milte delet. Fët e fët e mbushi shpejt një enë dhe u nis shigjetë e në shtëpi. Hyri me një frymë dhe i tha të shoqes:

– *Ku i kam nënë e babë, moj nuse?*

– *I mudi gjumi e po flenë, o burrë.* – ia ktheu fisnikja.

Oh, sa u mërzi çobani. Fëmijët e tij iu afruan të pinin pak qumësht, por ky u ngrit e u largua. Nga uria që kishin, filluan të qanin me të madhe e ia këputën shpirtin, ama baba u mbajt e nuk e dha veten.

– *Vëri në gjumë fëmijët, se mos zgjohen nënë e babë!* – ia priti nuses, e cila s’ia bëri fjalën dysh.

Me enën përplot në duar u shkoi tek dhoma, por ata flinin si foshnjat në djep. Sa u gëzua kur i pa! Iu afrua dhe u qëndroi tek koka derisa shkrepiti dielli majave. Rrezet e tij ia gudulisën fytyrat pleqve e ia fërkuan qepallat derisa i çelën sytë. Kur panë djalin tek koka u qeshi zemra e fytyra.

– *Po ti, mor bir!* – i tha nëna me buzë në gaz, – *A po na ruan prej gogolit?*

– *Jo, moj loke, jo!* – ia priti çobani. – *Por kisha merak të pinit ju të parët nga duart e mija, t’më bekonit me lutje, e ta merrnit vesh se askënd në botë nuk vë para jush.*

Iu ngrohën sytë pleqve e lotët iu varën nën qepalla.

– *Bekimet tona paç sa të kesh frymë mor bir, e të ruajt Allahu kudo të jesh!* – ia kthyen, e zëri u dridhej nën buzë.

Kaluan ditët, mirë sot e mirë nesër, e çobanit nuk iu nda e mira...

Ky rinoku pasanik, e kishte një zjarr që ia përvëlonte zemrën. Sevda ja ia kishte marrë mendjen dhe ia kish prishur gjumin. Një vashë i dilte në ëndërr, i buzëqeshte dhe e linte zgjuar. Nga bukuria nuk kishte shoqe, përmbi të gjitha ishte, bardhoshe si qumështi, syshkruar, e hollë dhe e gjatë selvi, mbështjellë me aq bukuri sa s'e shikoje dot dy herë. Pasaniku bënte t'i afrohej, por vasha ishte fisnike ndaj i largohej. Pasaniku e ndiqte pas, por vasha ishte turpshme ndaj shpejtonte hapin. Ai kurrësi nuk mundi t'i afrohej vashës, derisa një mot ajo ra vetë në duart e tij. Ishte kohë varfërie dhe zije për bukë. Uria e madhe e halli i familjes e shtyu vashën drejt derës së pasanikut. Kur e pa në derë, zemra e rinokut gati sa nuk plasi, mirëpo ky e mbajti veten.

– Urdhëro! Përse ke ardhur? – e pyeti, me krenari.

– Për bukë goje dhe për ndonjë kacidhe për nënë e babë.
– tha vasha me gjysmë zëri.

– Të jap 120 dinarë, – i tha pasaniku, – me kusht që të ma falësh trupin, përndryshe largomu nga dera!

Vasha u shastis, bëri të flasë por s'foli dot... Me zor të madh hyri në shtëpinë e pasanikut. Ky ia dha dinarët e iu afrua vashës i shtyrë nga zjarri i zemrës. Sikur të ishte yll i këputur nga qielli, vasha rrinte mendueshëm dhe nuk e ngrinte shikimin nga toka. Kur iu afrua krejt afër, vasha filloi të lotonte. “O rob i Allahut! Kije frikë Allahun e mos më prek pa të drejtë!” u dëgjua zëri i brishtë i saj. Kjo fjalë ia preku sedrën dhe ia fiku pasanikut zjarrin e zemrës. U largua menjëherë prej saj, ia ktheu shpinën, ia fali të gjithë dinarët dhe ajo u iku për të mos u kthyer më kurrë.

Kaluan ditët, mirë sot e mirë nesër, familja e vashës u pasurua, po ashtu rinokut nuk iu nda e mira.

Biri im i shtrenjtë! Të shfrytëzosh nevojat e të tjerëve për të marrë atë që e ka ndaluar Allahu është punë e poshtër. Ndaj

ki kujdes, ruaju se kështu do të të lartësojë Allahu. Tregohu fisnik e bëj mirë pa interes, se do të të nderojnë në dynja e do shpëtosh në Ahiret.

Kurse ky pronari i madh, ky tregtari i regjur, njëherë pajtoi një punëtor të shkathët, i cili punoi gjithë ditën si kalë barre, por pak para se të perëndonte dielli, iku dhe nuk e mori pagën. Pronarit i punonte mendja si uji i kroit, e kështu e nxirrte lekun nga guri i thatë. Pagën e argatit e futi në punë: blej e shit, blej e shit, blej e shit, pasuria i vinte lumë.

Kushedi mbas sa kohësh erdhi argati dhe i trokiti derës. Pasaniku u gëzua kur e pa dhe e priti me dorë në zemër, ama argati ishte për udhë e s'kish të ndenjur.

– *O rob i Allahut!* – i tha pronarit. – *Kam ardhur për pagesën time.*

– *Gjithsa sheh prej deveve, bagëtime dhe shërbëtorëve janë të tuat,* – iu përgjigj pronari.

Argati e vështroi një copë herë, mandej ia ktheu:

– *O rob i Allahut, mos u tall me mua!*

– *Nuk po tallem, jo,* – i tha pronari dhe ia tregoi fill e për pé se si kish qenë puna.

Me të dëgjuar fjalët e pronarit, argati e mori pasurinë, i graham gjësë së gjallë e nuk la asgjë për be të paktën. Ama pasaniku nuk u ligështua, se shpresonte shpërblimin e Allahut, i bëri rrugë e argati iku.

Kaluan ditët, mirë sot e mirë nesër, e pronarit nuk iu nda e mira...

Një ditë prej dite u bënë bashkë tre shokët, pasaniku, bariu dhe tregtari dhe morën rrugë për larg. Ec e ec, ra nata dhe ia plasi shiu. Ku të futeshin se? Shiko majtas e shiko djathtas syri u zuri një shpellë, ndaj vrapuan drejt saj dhe hynë brenda.

Venduan shtrojat, ndezën një zjarr bubulak dhe u ulën të kuvedojnë. Nuk kaloi shumë e të mundur nga lodhja u shtrinë të bënin një sy gjumë. Në të gdhirë u zgjuan të frikësuar nga një krismë e fuqishme në hyrje të shpellës. Ç'të kish qenë vallë? *"Na bëj dritë të shohim, se sikur kemi rënë në pus!"* ia priti njëri. Ndezën diç, kur ç'të shihnin?! Terr e ferr... një shkëmb i stërmadh, ish rrokullisur nga mali dhe u kish bllokuar shpellën. Bënë ta shtynin, por hiq... shkëmbi ishte i rëndë plumb. Megjithatë, nuk e humbën arsyen dhe as nuk u dorëzuan.

Bir i dashur! Kush beson në Allah nuk dorëzohet, por qëndron stoik, deri në fund lufton, mbasi është i bindur se e ka një Zot të plotfuqishëm që e përkrah dhe e ndihmon. Frika, ulërima, humbja e shpresave është cilësi e jobesimtarit, ngase nuk e njeh Allahun e nuk pret t'i ndihmojë. Tre shokët i bashkonte imani, ndaj u përpoqën e nuk u dorëzuan, ama kur e panë se përpjekja e tyre ishte e kotë, iu drejtuan Allahut me lutje.

– *Allahu ekber!* – foli njëri. – *Ngusht e kemi hallin. Edhe sikur të ishim dhjetë burra nuk do mund ta shtynim shkëmbin e mos pyet për tre.*

– *Pasha Allahun!* – u ngrit tjetri. – *Nuk na shpëton nga kjo dorë halli, veçse sinqeriteti. Prandaj secili prej nesh ta lusë Zotin me atë punë që e mendon të sinqertë për hir të Allahut, se ndoshta i Plotfuqishmi na e largon shkëmbin.*

U veçua bariu prej tyre e filloi të lutet: *"O Allah! Ti e di se kam pasur prindërit e mi të moshuar dhe fëmijët e vegjël. U siguroja jetesën duke ruajtur bagëtitë dhe kur kthehesha i milja ato dhe u jepja gjithmonë për të pirë prindërve përpara fëmijëve. Ti e di se si u vonova një herë dhe nuk u ktheva dot veçse vonë në mbrëmje, por kur i mola bagëtitë prindërit i kish mundur gjumi. O Allah, atë natë u qëndrova te koka duke mos dashur t'i trazoja. Mbaja enën me qumësht në duar duke pritur zgjimin e tyre, ndërkohë fëmijët qanin nga uria, por unë*

asnjëherë nuk u jepja atyre para prindërve të mi. Kështu qëndrova derisa gdhui dhe u zgjuan për të pirë hisen e mbrëmjes. O Allah! Nëse këtë e kam bërë për të arritur kënaqësinë dhe bekimet e Tua, të lutem, na liro prej këtij shkëmbi!"

Me të mbaruar lutjen bariu, shkëmbi lëvizi sikur ta shtynte dikush me dorë dhe atyre iu hap një vrimë, prej secilës shihej qielli, por nuk dillej dot.

Kur e vunë re se shkëmbi lëvizi, u ngrit pasaniku e filloi të lutej: *"O Allah! Ti e di se unë kam pasur një vashë, e cila ishte njeriu më i dashur për mua. Ti e di se disa herë i kërkova asaj të më afrohej, por ajo largohej edhe më shumë. Kështu m'u largua, derisa pllakosi thatësira. Ti e di mirë se si erdhi tek unë për të më kërkuar ndihmë. O Zot, unë i dhashë asaj 120 dinarë me kusht që të ma falte trupin e saj dhe ajo pranoi, por kur iu afrova, më tha me gjysmë zëri: "O rob i Allahut! Kije frikë Allahun e mos më prek pa të drejtë!" Atëherë unë u largova prej saj dhe e lashë të lirë të shkonte, duke ia falur të gjithë floririn, megjithëse e kisha më të dashur se shpirtin. O Allah! Nëse këtë e kam bërë nga frika prej Teje, të lutem largoje shkëmbin e na shpëto!"*

Shkëmbi lëvizi përsëri dhe vrima u zgjerua, por jo mjaftueshëm për të dalë.

Kështu ngriti duart tregtari dhe filloi të lutej: *"O Allah, o Zoti im! Unë kam marrë një herë një punëtor me mëditje, për disa kacidhe. Kur e mbaroi punën unë ia bëra gati pagesën, por ai nuk e mori dhe iku e u bë erë. Atëherë unë e përdora pagën e tij, bleva e shita me të e iu shtua pasuria. Mbas kushedi sa kohësh erdhi hyzmeqari dhe më tha: 'Më jep hakun tim'. Unë i thashë: "Gjithsa sheh prej deveve, bagëtime dhe shërbëtorëve janë të tua". Ai më tha: "O rob i Allahut, mos u tall me mua". Unë i tregova si ishte puna dhe ai, pa një pa dy, i mori të gjitha e s'la gjë prej gjëje. O Allah! Nëse këtë e kam bërë për*

të arritur kënaqësinë Tënde, të lutem na e largo shkëmbin e na shpëto!"

Pa e mbaruar mirë lutjen tregtari, lëvizi për së treti shkëmbi, aq sa mjaftonte. Dolën shokët një nga një, falënderuan të Madhin Zot dhe u nisën për udhë.

Biri im! Kapu pas singeritetit dhe çiltërsisë me Allahun se do të shpëtosh, ashtu siç shpëtuan tre shokët. Në mund të bësh adhurime apo bamirësi që nuk t'i di askush veç të Madhit Zot, lum për ty, do të të vyejnë shumë kur të përballesh me hallet e telashet e jetës. Mbaje të fshehtë punën e mirë e ruaju nga syfaqësia, se ta zhvlerëson punën e ta humb sevapin.

Për fund, ta lë amanet o bir, të shoqërohesh me besimdrejtët, me mirëpunuesit dhe ata që i frikësohen të Madhit Zot, e kurrë të mos ndahesh prej tyre, se bashkimi bën fuqinë. Mendo sikur të mos i pranohej lutja ndonjërit prej tre shokëve!

Kopshtari zemërmirë dhe retë

Biri im! Kur i Madhi Zot dëshiron që puna e një njeriu të mirë të pasohet nga të tjerët, e largon vellon e fshehtësisë, e kështu njerëzia bie në gjurmët e tij. E tillë është edhe historia e kopshtarit zemërmadh. Dëgjo me kujdes, se në rrëfimin e tij ka urti të shumta, për këdo që ka mend!

Teksa një shtegtar udhëtonte nën rrezet përvëluese të shkretëtirës, pa pritur e pa menduar, u mbulua nga hija e stërmadhe e një reje gjigante që lëvizte me të shpejtë. *"I Lartmadhëruar është Allahu,"* mendonte shtegtari, *"Ai dërgon retë përgëzuese para se të zbresë mëshirën e Tij. Ai zbret nga qielli ujë të kulluar, për të ringjallur tokat e vdekura, për të shuar etjen njerëzia dhe për të pirë bagëtia."*

I zhytur në mendime, iu bë se dëgjoi një zë. Ktheu kokën pas, majtas, djathtas, por askënd s'i zuri syri. *"O re!"* jehoi një zë nga qielli, *"Hidhe ujin tënd mbi kopshtin e filanit, të birit të filanit!"* Shtegtari u shastis e nuk i besonte veshëve. Pa një, pa dy, reja filloi të lëvizë e burri iu vu pas. Për çudi, reja e lëshoi të gjithë ujin mbi një zallishte me gurë të lëmuar. Prej aty, si të ishte urdhëruar, uji filloi të gjarpëronte si përrua që zbret nga mali. Me kureshtje të madhe, shtegtari e ndoqi pas vijën e ujit derisa mbërriti afër një bahçeje. Atje vuri re nga larg një burrë me këmishë të shkopsitur, trup-lidhur e faqe-rreshkur. Djersa

i rridhte valë-valë poshtë kurrizit, e ky me lopatë në dorë fap e fap i bënte udhë ujit, e uji nuk ndalej. Dheu i bahçes ishte i mirë, tul i zi dhe vija e ujit i shkonte përkrye. Pah, sa i bukur ishte ai rrip toke!

– O rob i Allahut, si të quajnë? – e pyeti shtegtari.

Kopshtari uli lopatën dhe i hodhi një vështrim nën vetullën që mezi ia mbante djersët.

– *Unë jam filani*, – u përgjigj dhe vuri buzën në gaz, – *i biri i filanit. Po ti kush je e nga na vjen o njeri i mirë?*

– *Udhëtar jam, nga dhé i largët*. – ia priti shtegtari.

– *A do bukë?* – i tha me përzemërsi kopshtari. – *Ujë për të shuar etjen a do?*

– *Të jam mirënjohës, o burrë bujar, por nuk më solli kësaj ane as uria dhe as etja, por një zë që vinte nga retë, teksa udhëtoja në shkretëtirë*. – i tha shtegtari dhe i rrëfeu ngjarjen.

Kopshtarit i qeshi zemra dhe i ndriti fytyra kur dëgjoi këto fjalë, por uli kokën e s'bëri zë. Mandej e ngriti shikimin dhe iu drejtua:

– *Po mirë, deri këtu vetëm për një emër, o njeri?*

– *Më shtyu kureshtja të njoh se kush je dhe të zbuloj sekretin e kësaj mirësie?*

– *Përderisa qenka puna kështu, po të tregoj.*

– *Mbaj vesh!* – tha kopshtari. – *Sa herë që vjel frutat e kopshtit tim, i ndaj në tre pjesë: njërën e jap sadaka për skamnorët, tjetrën e mbaj për vete e për të afërmit e mi dhe pjesën që mbetet e shpenzoj për mirëmbajtjen e kopshtit tim.*

"I qofshim falë Allahut!" mendoi shtegtari, *"Si pasojë e bamirësisë së këtij burri, Allahu kujdeset për kopshtin e tij."*

Kopshtari zemërmirë dhe retë

Jo vetëm që zbret shi me bollëk, por e lëshon larg kopshtit të bujarit, në mënyrë që shiu i rrëmbyer të mos ia dëmtojë të mbjellat. E zbret shiun mbi zallin e ngurtë, që të mos e thithë dheu e vija e ujit të shkojë e varfër drejt tokës së bujarit. Madje ia mundëson kopshtarit, që edhe rrjedhën ta drejtojë sipas nevojës. Ah, lum për kopshtarin, lum për bujarin!"



1000 Dinarët

Biri im! Njeriu është krijesë e dobët. Si i tillë herë pas here ka nevojë për mbështetje nga njerëzit e tjerë, mbasi i vetëm nuk ia del mbanë. Kur piqet e burrërohet jeta e përball me lloj-lloj sprovash: herë i varfër e herë i pasur, herë lart e herë poshtë, herë lë amanete e herë bart amanete, herë kështu e herë ashtu... sprova dynjaje thotë populli, s'ke ku i shkon. Sido që të të marrë jeta, kurrë mos harro se Allahu i Lartësuar e do njeriun amanetqar, burrin që e mban fjalën e dhënë dhe nuk e shkel besën. Dëgjo se ç' na rrëfen Profeti, alejhis-selam, për besnikun që mori borxh 1000 dinarë!

Një burrë besnik nga beni israilët i kërkoi borxh 1000 dinarë një shoku bujar. 1000 dinarë nuk janë fjalë goje, ndaj bujari u zu ngusht dhe i tha:

– *Shumë po më kërkon o shoku im! A ke dëshmitarë që dëshmojnë për këtë borxh!*

– *Mjafton Allahu për dëshmitar, – iu përgjigj besniku.*

– *Atëherë më sill një dorëzanë, se është goxha shumë, o mik! – i tha pasaniku.*

– *Mjafton Allahu për dorëzanë, – ia ktheu shoku.*

– *Ke të drejtë, – i tha pasaniku dhe i dha plot 1000 dinarë, duke i lënë një afat të caktuar për shlyerjen e borxhit. Besniku e falënderoi bujarin, i dha selam dhe iku e mori rrugë në dhé të largët.*

Atje iu përvesh punës. Allahu ia priu të mbarën e ky u pasurua si kurrkush. Shkuan ditët, javët, muajt, sosën vitet dhe u afrua afati i borxhit. Kur erdhi koha për shlyerjen e tij besniku, kushedi mbas sa motesh ia mësyu atdheut. Shkoi në portin e qytetit ku bënte tregti me shpresën se do të gjente ndonjë anije udhëtarësh, por nuk gjeti. Ah, sa u pikëllua!

– Më mirë i vdekur sesa besëshkelur! – tha me vete. – Mjerë për mua! Si t'ia bëj tani? Po afrohet dita për shlyerjen e borxhit, kurse unë mbeta në dhé të huaj!

Hodhi shikimin andej-këtej dhe gjeti në breg një cung që e kish sjellë dallga. E mori cungun, e gërreu përbrenda, futi në të dinarët dhe një letër për shokun e tij. Mandej hoqi nallanet dhe iu afrua detit. Valët thyheshin në këmbët e tij, ndërsa puhizat ia shpupurishnin mjekrën. Besniku e hodhi cungun në det me sa fuqi pati, ngriti duart lart nga qielli dhe iu lut Allahut: *“O Allah, o Zot i Lartmadhërishëm! Ti e di se unë i kam marrë borxh shokut tim 1000 dinarë. Kur më kërkoi dëshmitar unë të bëra Ty, o Zot, e kur më kërkoi dorëzanë të bëra përsëri Ty, e kështu ai pranoi të ma jepte borxhin. Unë u mundova të gjej një mjet lundrimi për t'ia kthyer floririn, por nuk arrita, prandaj po t'i lë amanet Ty!”* Kështu ia la dinarët në mirëbesim valëve të detit. Ata ia lanë amanet dallgëve, dallgët erës së perëndimit e kjo me urdhrin e Allahut e shtyu cungun larg e larg, deri matanë detit. Nga bregu tjetër kishte dalë bujari. Kështu e kishin lidhur besën para disa vitesh.

“A do ketë ardhur vallë shoku im?” mendonte, *“A thua i ka rënë ndër mend borxhi, apo e ka harruar tashmë?”* Prit e prit, por asnjë anije nuk shihej në horizont. Edhe porti ishte bosh, nuk kish mbetur askush, veç disa lundëtarëve që shprishnin rrjetat e peshkut. I lodhur dhe i zhgënjyer ia mësyu bregut. Diku larg i bie në sy një cung që e kishin nxjerrë dallgët nga kush e di se ku. U afrua dhe mori cungun. *“Goxha cung!”* mendoj, *“Borxhin nuk e mora, ama duarbosh s'po kthehem. Po marr këtë cung për dru zjarri, më mirë pak se hiq.”*

Me t'u kthyer në shtëpi, mori sëpatën dhe filloi të godiste cungun, që ta copëtohte e të merrte ashkla për oxhak. Ama tek copëtohej, sytë i zunë një torbë. *"Torbë, në zemër të cungut! Hajt ta shohim se ç'ka brenda?"* Kur e hapi nuk u besonte syve: plot 1000 dinarë dhe letra e palosur. *"Allahu të mëshiroftë kudo të jesh o shoku im!"* psherëtiu bujari, *"Paske qenë besnik e kaluar besnikut."*

Kaluan motet. Buzë molos erdhi e hodhi spirancën një anije, që vinte nga larg, përtej detit. Me të ankoruar, zunë e zbritën udhëtarët e rraskapitur nga rruga e gjatë. Në mesin e udhëtarëve ishte edhe borxhliu besnik. Si rrallëherë, bujari kaloi andejpari, megjithëse nuk e kishte zakon të endej rrugëve të portit. Teksa ecte mbi kalldrëmin e lagësht, ia tërhoqi vëmendjen fytyra e një udhëtari mjekërdendur. Iu duk fytyrë e njohur, ndaj iu afrua, kur ç'të shihte... shoku besnik.

– *Es-selamu alejke, o shok i vjetër!*

– *Alejkes-selam, o mik bujar!* – ia ktheu shoku, që nuk ia kish harruar zërin.

– *Pasha Allahun, jam munduar për ta kthyer borxhin, por nuk pata mundësi, ndaj ja ku të erdha.* – iu drejtua borxhliu shokut me gjysmë zëri. – *Ja edhe borxhi, o vëlla i dashur!*

– *A mos më ke dërguar diç para disa motesh?* – i thotë bujari buzagaz. – *Të thashë se nuk pata mundësi, ndaj erdha sot nga dhé i largët.*

– *Allahu ta ka kryer porosinë e ta ka shlyer borxhin me dinarët që m'i dërgove në dru, o mik besnik!* Borxhliut i ndriti fytyra si dielli kur shkrep mes maleve.

– *Falënderuar qoftë Allahu!* – tha besniku. – *Ndërsa ti rrofsh e qofsh, e mos t'u ndaftë e mira, o shok i vjetër!*

Bir i dashur! Ky rrëfim dëshmon, se me iman dhe besnikëri njeriu tejkalon çdo pengesë.

Qypi me florinj

Bir i dashur, Profeti, alejhis-selam, ka thënë: *"Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë, por ndërmjet tyre ka gjëra të dyshimta që nuk i njeh shumica e njerëzve. Ama ai, që tregohet i kujdesshëm ndaj të dyshimtave, e ruan fenë dhe nderin e tij"*.

Kushdo që ruhet nga haramet e të dyshimtat, Allahu i Madhëruar ia lartëson emrin dhe i dhuron bereqet. Dëgjo se ç'rrëfëhet për burrin e devotshëm që gjeti qypin me flori!

Shumë kohë para nesh, na ishte një njeri i mirë, burrë me namuz që i shkonte nami tejpertej. Besimtar ishte miku, sabërli, i urtë dhe i matur. Punëtor n'e moti, e fitonte bukën vetëm me djersën e ballit. Puno sot e puno nesër, burri na ndau ca dinarë mënjanë për të blerë një copë tokë. E ujdisi punën me një mik dhe ky ia shiti një rrip toke, për merak. Me të lindë ditë e re besimdrejti hodhi shatën e ia nisi punës. E kishte ëndërr ta lëronte e ta mbillte tokën me drithë, por tek gërmonte shati goditi diç të ngurtë. Burri mendoi se ishte gur, ndaj e ndali punën. U ul në gjunjë, zgjati duart e futi gishtërinjtë në dhë që të nxirrte gurin e të pastronte tokën, mirëpo ç'të shihte! Nga dheu nuk doli një gur, por një goxha shtambë përplot me florinj.

"Hajde sprovë, hajde!" mendoi burri, *"Po tani? Ç' të bëj? Ta mbaj për vete e të mos bëj zë, apo ta kthej te miku që ma shiti tokën?"* Gjithë ai flori ia turbullonte mendjen, megjithatë

mori vendim të prerë t'ia kthente shtambën mikut. Burri ishte besimdrejtë e ia kishte frikën Zotit. *"Me të vërtetë kam familje mbi shpinë, e gjithë ky flori kryen punë të madhe,"* mendonte burri, *"ama më mirë pak e hallall".* Mori shtambën me flori dhe u nis te miku.

– *Mirë se na erdhe e të lumshin këmbët, o burrë fisnik!* – ia priti miku sapo e pa në derë të oborrit.

– *Mirë se të gjej, o mik bujar!* – ia ktheu burri. – *Urdhëro e fol... Ç'e mirë të solli?*

– *Eh, more mik,* – i tha burri, – *tek punoja tokën gjeta këtë shtambë përplot flori, por unë të pata blerë vetëm tokën e jo dinarët.*

– *Ja ku t'i solla, o lum miku! Merri, të dhëntë Allahu bereqet në ta!* – e ia vendosi shtambën mu para këmbëve.

– *Paske qenë burrë e kaluar burrit.* – ia priti miku. – *Hallall të qoftë, por unë ta shita tokën me gjithë ç'ka brenda, ndaj shtamba është e jotja. Ta mbash e ta përdorësh si të të dojë e bardha zemër!*

– *Jo, jo, nuk më takon mua,* – ia ktheu shoku-shokut.

Jo të takon, jo s'të takon... Atëherë vendosën të marrin mend nga një plak i urtë, adhures i Zotit e njeri i ditur.

– *Urdhëroni, ju gjettë e mira, o shokë besnikë!* – u tha plaku butë e butë. – *Ç'e mirë ju solli tek unë, a s'ma tregoni?*

Shokët ia rrëfyen ngjarjen fill e për pé, e plaku i dëgjoi me vëmendje.

– *A keni fëmijë, o shokë besnikë?* – u tha plaku, mbasi mbaruan.

– *Posi jo,* – u përgjigj njëri, – *unë kam një djalë.*

– *Po ti tjetri?* – iu drejtua plaku. – *Pse nuk flet?*

– Unë kam një vajzë, një vajzë të vetme, o plak i urtë, – u përgjigj tjetri.

Kur i dëgjoi të dy, plakut i qeshi fytyra, si të ish diell në perëndim.

– Puna është e lehtë, – u tha urtaku. – Ta martoni djalin me vajzën. Një pjesë të floririt t'ua dhuroni atyre të ngrenë çerdhe e të rehatohen, e pjesën tjetër ta jepni sadaka për skamnorët e jetimët!

Burrat sikur e zunë qiellin me dorë nga gëzimi. U gëzuan të afërmit e të largët. U bë dasmë gojaplot dhe morën pjesë i madh e i vogël. Çifti u trashëgua e jetuan të lumtur, sa patën jetë. Përfundimi i mirë është gjithmonë për të devotshmit.

Shitësi i verës

Bir i dashur! Ebu Hurejrah, një nga shokët e shquar të Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na tregon se njëherë Pejgamberi doli në tregun e madh të Medinës. Përshëndet njërin, jepi selam tjetrit, buzëqeshi këtij dhe shtrëngoja dorën atij tjetrit, dikur u ndal para tezgës së një tregtari që shiste grurë buke. E përshëndeti ashtu si e kish zakon dhe iu afrua njërit prej thasëve përplot me grurë. Se ç'u trazua shikimi i tregtarit kur e pa se Pejgamberi, alejhis-selam, zgjati dorën nga thesi. Edhe më shumë iu mjegullua shikimi kur Profeti, alejhis-selam, e zhyti dorën dhe iu lagën gishtërinjtë e bekuar. Pasi e nxori dorën, Pejgamberi iu drejtua shitësit:

– *Ç'është kjo, o pronari i grurit?*

– *E ka lagur shiu, o i Dërguari i Allahut.* – foli shitësi me gjysmë zëri.

– *Pse nuk e ke nxjerrë sipër që ta shohin njerëzit?* – i tha për së dyti Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të.

– *Ai që na mashtron nuk është prej nesh.*

Biri im! Dije se mashtrimi dhe tradhtia janë vese të ulëta, që të turpërojnë në dynja, të poshtërojnë në Ahiret dhe t'ia humbin bereqetin pasurisë, siç ia humbin netët shkëlqimin hënës, derisa nuk i mbet nga nuri vetëm se pak. Shumë rrëfime kam dëgjuar të tregohen për hilen e hileqarët, por të mjafton

ty njëra prej tyre, e shkurtër, e lehtë për t'u mbajtur në mend, ama kuptimplote.

Na rronte një herë e një kohë, në një fshat buzë detit, një burrë i varfër, që kërkonte pasurinë. Thuhet se ky miku na u lidh me disa marinarë që merrnin detet për tregti e kështu filloi udhëtimet sa në lindje e në perëndim. Lundrimin e pati të vështirë në fillim, por shpejt u mësua dhe nuk e turbullonin më valët as dallgët. Kush e di se sa ishuj, sa porte e mole shëtiti miku. Shit këtu e blej mall me leverdi atje, burri filloi të pasurohej. Diku larg, në një ishull nga lindja, thuhet se vendasit ia dhuruan një majmun të vockël, qimeshkurtër e bishtgjatë. Burri u kujdes për të, e rriti dhe majmuni iu bë shok i pandarë në udhëtime. Kaq shumë u mësua me tregtarin, saqë mjaftonte një fjalë e tij e fap, majmuni i bindej urdhrit. Koha kalonte, pasuria i shtoej e kështu burri vendosi të ndahej nga ekuipazhi e t'ia fillonte tregtisë i vetëm. E bluajti mirë punën në mendje e filloi të shiste verë. (Thuhet se vera atëherë na ishte e lejuar me kusht që të mos e kaloje masën e të deheshe) Port më port e mol më mol iu hap nami se kishte verë e kaluar verës... mjaltë e ëmbël. Fito sot e fito nesër, pasuria i hyri në gjak. Kur u marros mbas derhemit e dinarit, shejtani filloi t'i frynte në vesh, e ç'bëri miku? Ia filloi hiles: verën e përziente me ujë, si e si të fitonte më shumë. Ama nuk vonoi shumë e u kthjellua. Po kush e ktheu nga e mbara mund të thuash ti? Askush tjetër veç majmunit bishtgjatë. Allahu i Lartësuar e udhëzoi majmunin që të merrte mësim prej tij tregtari, ashtu siç pat udhëzuar korbin të varroste korbin, që të merrte mësim biri i Ademit, Kabili.

Një ditë pranvere, kur deti u qetësua e u bë vaj, tregtari ankoroj anijen pranë molit, uli velat dhe ia filloi shitjes. Porti gumëzhinte nga njerëzia, si zgjua bletësh. Blej njëri e blej tjetri, miku e mbushi qesen plot, mirëpo teksa binin në ujdin me një klient, majmuni fap ia merr qesen e kacavirret shpejt e shpejt

në direk derisa arrin majën. I foli majmunit me të butë, majmuni hiq, i bërtiti me të madhe, majmunit s'iu bë vonë. Kështu i hipën kacabunjtë dhe bëri t'i ngjitej vetë direkut... i thonin një qese plot me argjend e jo lojë. Me ta parë majmuni, hapi qesen dhe filloi të hidhte monedhat fët e fët. Një në det pllue, e një në anije tring, një në det e një në anije derisa shteroi qesja. Tek shihte monedhat se si zhyteshin e humbnin në thellësi, u kthjellua. E kuptoi si shenjë nga i Madhi Zot, e i vuri gishtin kokës. Prej asaj dite punoi me ndershmëri miku, i kënaqur me atë që i kish caktuar Allahu i Lartësuar, qoftë edhe pak. E kuptoi se pasuria e vërtetë është ajo që fitohet me djersë e mund dhe jo me hile e dredhi...

Udhëtari dhe geni

Profeti, alejhis-selam, na tregon se një ditë të nxehtë vere, një udhëtar nga dhé i largët ecte përmes një trualli të shkretë. Era i kishte shtyrë retë kush e di ku, dielli kish zbritur poshtë dhe ishte bërë si vatër prushi. Toka ishte nxehur furrë. Udhëtarit i ishte tharë qiellza, kurse balli dhe trupi i digjeshin zjarr. Mezi merrte frymë miku. Donte të shuante etjen, po me se? Bota i rrotullohej nga sfiljtja, por rrotullo e rrotullo i ra në sy një si oaz diku tej. U nis me hapa të rëndë për nga oazi e për fat të mirë, përveç hijes gjeti edhe një pus ku freskoheshin udhëtarët. Vetëm Allahu e di se sa u gëzua burri! E falënderoi të madhin Zot që i shpëtoi jetën dhe filloi të zbriste në pus për të shuar etjen. Filloi të pinte si i babëzitur. Po a ka kënaqësi më të madhe se uji i freskët kur ta lag gurmazin, zbret teposhtë dhe ta freskon shtatin?!

Burri duke qeshur me vete, i zhytur gjer më gju, i hodhi ca grushte fytyrës, kokës dhe qafës... Por papritur e pa menduar, kënaqësinë ia preu një hungërimë si me të qarë. Kush të ishte vallë? Ndoshta ndonjë bishë? Lloj-lloj mendimesh i shkrepën në tru. Gjithsesi qetë-qetë, që të mos pikasej, filloi t'i ngjitej pusit përpjetë që të përgjonte. Nxori me kujdes kokën gjeri tek sytë, kur ç'të shihte! Një goxha qen tek lëpinte rërën e njomë rreth pusit. *"I shkreti qen!"* mendoi udhëtari, *"E paska tharë etja ashtu si mua."* Atëherë, e mposhti lodhjen, mblodhi tërë fuqitë dhe u kthye edhe një herë në fund të pusit. Zbathi opingën prej lëkure dhe mbushi me ujë të freskët. Mandej e shtrëngoi

fort me dhëmbë fundin e saj që të mos derdhej uji e filloi të ngjitet lart. Kur doli mbi buzët e pusit, qeni ngriti veshët dhe nisi të lehte. Ama burri e shihte me dashamirësi, kështu që lehja u bë angullimë e mbytur derisa pushoi. Burri doli nga pusi, u ul para qenit dhe e ledhatoi në qafë e në supe duke i rënë lehtë mbi shpinë. Mandej hoqi opingën nga goja dhe ia zgjati qenit të etur. Fyti i vlonte të mjerit, hunda dhe buzët i dridheshin. Teksa pinte, e shikonte drejt e në sy me habi dhe mirënjohje udhëtarin. Pasi e shoi etjen, qeni mbylli gojën si shenjë se nuk donte më dhe u largua.

Pejgamberi, alejhis-selam, tregon se Allahu ia vlerësoi punën udhëtarit dhe ia fali gjynahet.

Biri im! Mëshira ndaj krijesave është shenjë e butësisë së zemrës dhe butësia e zemrës është shenjë e imanit... kurse imani është dera e mirësive të dynjasë dhe të Ahiretit. Ndaj edhe Profeti, alejhis-selam thoshte: *"Mëshironi ata që janë në Tokë, t'ju mëshirojë Ai që është mbi qiej!"* Nëse për mirëbërjen ndaj një qeni, Allahu të mëshiroka e t'i falka gjynahet, paramendo nëse tregohesh bamirës ndaj njerëzve!

Plaka e urtë

Bir i dashur! Devotshmëria ndaj Allahut dhe përkujtimi i Ahireti e lartësojnë njeriun nga nevojat e kësaj bote drejt kënaqësive të përtjetësisë.

Lidhur me këtë, Ebu Musa el Eshariji, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, na rrëfen: Njëherë, Profeti, alejhis-selam, shkoi mik te një beduin. Ai e nderoi Pejgamberin sa më s'ka. Për t'ia kthyer të mirën me të mirë i Dërguari, alejhis-selam, i tha: *"Kur të biesh në Medine, të presim të na vizitosh!"* Nuk kaloi shumë e beduini ia mësyu qytetit. Pyeti për Pejgamberin, alejhis-selam, e pa u lodhur shumë e gjeti. Një rrezatim ia përndriti fytyrën Profetit, alejhis-selam, sapo e pa mikun e shkretëtirës. Mbasi u çmallën, i Dërguari i Allahut e pyeti:

– Çfarë nevojash ke o mik?

– Kam nevojë për një deve të shaluar; – i tha beduini pa teklif, – dhe disa dhi për t'i mjelë e të mbaj familjen.

– Ah sikur të ishe edhe ti si plaka e beni israilëve, o njeri i mirë?! – tha, dhe buzëqeshi Profeti, alejhis-selam.

Sahabët përreth e pyetën Pejgamberin, alejhis-selam, me kureshtje:

– Po si është puna e plakës së beni israilëve, o i Dërguari i Allahut? A s'na e tregon?

Ndërkohë që shokët e tij i kishin bërë veshët katër, Profeti, alejhis-selam, u tha:

– Kur Musai, alejhis-selam, u nis në errësirë me beni Israilët drejt Palestinës, e humbi rrugën dhe u shqetësua. Sikur të mos mjaftonte kjo, burrat e urtë i thanë: “O i Dërguar i Zotit, e kemi për detyrë të të tregojmë se Jusufit, birit i Jakubit, kur i erdhi vdekja, na mori besën para Allahut që të mos dalim nga Egjipti pa marrë trupin e tij me vete.”

Atëherë Musai, alejhis-selam, u vrenjt, u mendua. “Kush prej jush e di se ku është varri i Jusufit?” bubulliu zëri i të Dërguarit. “Këtë nuk e di askush veç plakës më të moçme të në mesin tonë, o biri i Imranit, ia kthyen urtakët.

“Thirrmani atëherë, zonjën nënë, të flas me të!” u tha Musai. I bënë zë dhe plaka erdhi.

“A s’më tregon, se ku është varri i Jusufit, moj nënoke?”, i tha i Dërguari, alejhis-selam. Ajo e vështroi në sy dhe ia ktheu: “Pasha Allahun, nuk tregoj derisa të më japësh atë që dëshiroj.” Musai, e pyeti me kërshtëri:

“E çfarë dëshiron, moj urtake?”.

“Dëshiroj të jem me ty në Xhenet,” i tha ajo.

Musai, alejhi selam, u zu ngushtë. Xheneti është pronë e Allahut, ndaj askush nuk guxon t’i thotë tjetrit se do jetë banor i Xhenetit. Kështu i Madhi Zot i shpalli Musait, alejhis-selam:

“Premtoja plakës atë që dëshiron, se me të vërtetë ajo do jetë prej banorëve të Xhenetit.”

Me ta marrë premtimin, plakës iu çel fytyra dhe i ndritën sytë. U nis plaka me ta drejt një pellgu të vockël me ujë të ndenjor.

“Largojeni ujin!” u tha. “Pasi ta largoni ujin gërmoni me kujdes, se bash këtu prehet trupi i Jusufit!”

Me të vërtetë, teksa largonin dheun e lagur zbuluan trupin fisnik të birit të Jakubit. Të kujtohet besoj, se Allahu Fuqiplotë

ia ka ndaluar dheut të tretë trupat e Pejgamberëve, apo jo?! Kështu e nxorën trupin e Pejgamberit Jusuf dhe e morën me vete. Atëherë rruga u ndriçua si me dritën e ditës."

Biri im! Dije, se jeta e kësaj bote është lojë e dëfrim, mburrje për bëma dhe përpjekje për shtimin e pasurisë dhe evladëve, ama shpejt vjen pleqëria e njeriun e pret varri, mandej përjetësia, ndaj mos u mashtro me bukuritë e dynjasë, por adhuro Allahun e bëj punë të mira! Shembulli i dynjasë përngjan me shembullin e farës që mbin, lëshon shtat dhe e mahnit bujkun. Por, ajo shpejt thahet, zverdhet, vyshket dhe tretet. Kështu pra, le të jetë shembull për ty plaka e urtë e beni israilëve dhe qëllimi yt Ahireti e përjetësia.

Porositë e Jahjas

Bir i dashur! Përgjatë historisë, Allahu i Lartmadhërishëm dërgoi tek çdo popull Pejgamberë, që të nxirrnin njerëzinë nga errësirat në dritë. Kishte raste kur tek një popull dërgoheshin dy e më shumë Profetë njëherësh. Po pse mund të pyesësh ti? Sepse disa popuj ishin më të prishur se të tjerët, prandaj, ngaqë detyra e përcjelljes së porositve të Zotit i bëhej e rëndë të Dërguarit, Allahu i Lartësuar e përforconte me të Dërguar të tjerë që ia mbanin krahun. Kjo është arsyeja pse i Madhi Zot u dërgoi beni israilëve shumë Pejgamberë. Me të vërtetë ata ishin popull i prishur, kryeneç dhe i pabindur. Ata i përtallën të Dërguarit, i përgënjeshtruan, madje derdhën edhe gjakun e shumë syresh.

Këtu e njëzet shekuj më parë Lartmadhëria e Tij ia zbriti shpalljen Jahjas, të birin e Zekerijas, alejhime-selam, që ta përkrahte të atin në përcjelljen e fesë. Asokohe Allahu i Lartësuar dërgoi në mesin e israilitëve edhe Isain, të birin e Merjemes, alejhis-selam, që t'i përkrahte babë e bir.

Një herë i Madhi Zot i shpalli Jahjas, alejhis-selam, pesë porosi dhe e urdhëroi t'i zbatonte së bashku me popullin e tij. Mirëpo ai nuk ua përcolli shpalljen beni israilëve menjëherë, ngase i njihte mirë se kush ishin. Isai, alejhis-selam, meqë dëshironte që e mira dhe e dobishmja të përhapej sa më shpejt në mesin e njerëzve, i tha: *"O Jahja! Allahu të ka dhënë pesë porosi që t'i zbatosh dhe t'i urdhërosh beni israilët me ta. Tash nuk pret më puna, ose t'i urdhërosh ti, ose t'i urdhëroj unë!"*

Jahja, alejhi selam, e dinte se fjala nuk çon peshë në kandar të njerëzisë nëse nuk shoqërohet me vepra, ndaj nuk i përcolli porositë derisa të ishte ai i pari që punonte me ta. Ai dëshironte të ishte shembull në zbatimin e tyre, mandej t'ua kumtonte beni israilëve. Nga ana tjetër edhe Allahut ia kishte drojën, kështu i tha Isait, alejhis-selam: *"O biri i Merjemes! Druhem se nëse do ta bëje ti para meje, Allahu do të ma shembë tokën poshtë këmbëve, apo mund të më dënojë rëndë. Ndaj unë do t'ua përcjell porositë e Allahut."*

Kështu, Jahja, alejhis-selam, i mbledhi beni israilët në Bejtul-Makdis dhe xhamia u mbush përplot. U ngrit i Dërguari i Zotit në mesin e tyre dhe u foli me të lartë: *"O beni israil! Allahu më ka shpallur pesë porosi, që t'i zbatoj dhe t'ju urdhëroj edhe juve t'i zbatoni. Mbani vesh e më dëgjoni me vëmendje!"*

1 - Të adhuron Allahun dhe të mos adhuron të tjerë veç Tij! Shembulli i atij që adhuron të tjerë veç Allahut është si shembulli i një burri që ka blerë një rob dhe i thotë atij: *"Këtu është shtëpia ime dhe kjo është puna jote. Puno dhe më sill prodhimin, që të të shpërblej! Robi punon, ama prodhimin ia dërgon një tjetri, i cili nuk është pronari i tij. A do e pranonte kush nga ju një rob të tillë?! Atëherë pra, mos harroni se Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi juaj, prandaj adhurojeni Atë të Vetëm e të Pashoq!"*

2 - Allahu ju ka urdhëruar të falni namazin. Ama, kur të faleni, mos e ktheni kokën sa andej këndeje, sepse Allahu e drejton Fytyrën e Tij nga fytyra e robit të Tij kur lidhet në namaz, derisa rob nuk e kthen kokën.

3 - Allahu ju ka urdhëruar për agjërim. Shembulli i agjëruetit është si shembulli i atij që bart me vete misk dhe përzihet me njerëz. Të gjithë kënaqen me aromën që përhapet në mesin e tyre. Dijeni pra, se aroma që buron nga goja e agjëruetit është më e këndshme për Allahun se aroma e miskut.

4 - Allahu ju ka urdhëruar për sadaka. Shembulli i atij që u jep të tjerëve i përngjan një njeriu të zënë rob. Armiqtë ia lidhin duart pas qafe dhe e sjellin për t'i prerë kokën, atëherë ai u thotë: "A mund ta shpaguaj gjakun tim me pasuri?" Ata pranojnë e ky paguan. Kështu shpëton kokën e fiton lirinë.

5 - Allahu ju ka urdhëruar ta përmendni shumë. Kush e përmend Allahun shumë i shëmbëllen atij që i qepet pas armiku. Ama ai strehohet brenda një kështjelle të fortifikuar si mos më mirë. Kurrë nuk mund të shpëtoni, nga shejtani, armiku i përbetuar, veç në e përmendshi Zotin shumë!"

Biri im! Nga porositë e Jahjas na bëhet e qartë se shtyllat e Islamit kanë themele të thella. Të gjithë Pejgamberët kanë thirrur njerëzinë të kapen pas tyre. Edhe Profeti ynë, alejhis-salam, na ka mësuar se feja e drejtë ngrihet mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit. Ti mund të thuash, "Po, Jahja, alejhis-salam, përmend si porosi të pestë përmendjen e Allahut, ndërsa Profeti, alejhis-salam, haxhin!" Po, a nuk është haxhi adhurim ku përmendet shumë Allahu i Lartmadhërishëm?!

Shoku i mirë

Shumë kohë para nesh na ishin dy shokë besimtarë. Kishin ngrënë një thes me kripë bashkë, thotë populli. Lloj-lloj mysibetesh e të papriturash kishin kaluar shoqi me shoq, hallet edhe më shumë ua kishin ndezur dashurinë. Rrodhi jeta, e dallgët e saj i ndanë shokët; njëri ra në një fshat në lindje e tjetri në perëndim.

Hajde ditë e shko ditë, e mira nuk u ndahej shokëve, ama edhe malli për njëri-tjetrin nuk u shuhej. Se ç'e ndjenin zemrën bosh burrat... nuk ia mbushte as fëmija, as bahçja, dhe as pasuria. E kuptoi njëri se ku e kishte hallin. Kështu, një mëngjes, përshëndeti grua e fëmijë, hodhi krahaqafë krahoshin me bukë dhe u nis për udhë të largët. Kushedi se sa e sa shtigje kaloi miku! Sa e sa vështirësi shijoi në rrugëtim, një Zot e di, mirëpo idhëtinë e udhëtimit ia ëmbëlsonte takimi me shokun. Ec e ec përpjetë një kodre, në krye të një shtegu i del një burrë i gjatë, fort i bukur, i veshur me të bardha. Rreze drite kish përreth fytyrës. Si njeri dukej, por jo i kësaj bote. Miku e pa me bisht të syrit dhe u tremb, por nuk e dha veten. I dha tungjatjetën dhe bëri të ecte më tej, ama burri i foli:

– Mbaje hapin, o njeri i mirë, se kam për të të thënë dy fjalë! Për nga je nisur, o udhëtar? – i tha i panjohuri, me zë të butë, por si i prerë.

– Kam marrë rrugë nga dhë i largët për të takuar një mik të vjetër, – ia ktheu burri.

- A e ke të afërm për nga gjaku? – i tha i panjohuri.
- Jo, nuk e kam në farë e as në fis, – ia ktheu burri.
- Mos të ka bërë ndonjë nder e dëshiron t'ia kthesh nderin?
- Jo, more i panjohur.
- Po pse ke marrë udhë nga lindja në perëndim pra?
- E dua për hir të Allahut, o i panjohur.
- Atëherë, pra, – iu drejtua i panjohuri, – unë jam një melek, më ka dërguar Allahu i Lartësuar tek ti, që të të lajmëroj se i Madhi Zot të do ty, se e deshe tjetrin për hatër të Tij.

Kur i dëgjoi fjalët e të panjohurit, burri u mallëngjye kaq shumë sa iu njomën sytë. Ktheu kokën të vështronte melekun, por ky i humbi lart në qiell. E kështu burri vazhdoi udhën me gëzim të madh.

Bir i dashur! Pejgamberi, alejhis-salam, na mëson se kurdo që një musliman viziton vëllain e tij të besimit për hir të Allahut, një zë thërret nga qielli: “I bekuar qofsh, se e fitove Xhenetin!” Ndërsa Allahu thotë: “Robi im viziton vëllanë e besimit për hatrin Tim, ndaj është detyrë për Mua ta mirëpres. Kështu, Unë nuk kënaqem ta shpërblej ndryshe, veçse me Xhenet.”

Sadakaja e natës

Bir i shtrenjtë! Të kam treguar se në Ditën e Kiametit dielli do t'i afrohet krejt pranë njerëzisë, një milje mbi koka, aspak më larg. Njerëzit do mbulohen nga djersa, ngase atëbotë nuk ka hije ku të mund të flladiten. Në këtë ditë përvëluese, tetë melekë të jashtëzakonshëm do zbresin Arshin e Zotit. Vetëm nën Arsh njerëzia mund t'u shpëtojë rrezeve përvëluese, që ua rreshkun lëkurat. Ama, nuk mund të strehohet gjithkush nën hijen e Arshit, vetëm fatlumët që përzgjedh Allahu i Lart-madhërishtëm. Profeti, alejhis-selam, na ka lajmëruar se ndër të përzgjedhurit do jenë ata që e japin sadakanë aq fshehtas, sa nuk merr vesh e majta çfarë dha e djathta. Sadakaja është një ndër punët më të vlerësuara në mbretërinë e qiejve dhe një adhurim shumë i hershëm me të cilin njerëzit kërkonin kënaqësinë e Allahut të Lartësuar...

Tregohet se sot e kushedi sa mot më parë, na ishte një njeri i mirë, me din dhe me iman. Adhuronte të madhin Zot me përkushtim dhe në mendje kishte gjithmonë Ahiretin. Me askënd nuk kishte hasmëri, por vetëm miqësi. E njihte këtë njeri të mirë i madh e i vogël, megjithëse atij nuk i interesonte aspak nami. Kalonte një jetë të thjeshtë, me devotshmëri, ashtu siç i takon një besimtari.

Njëherë, tek po perëndonte dielli, i erdhi në mendje shpërblimi i madh i sadakasë. E pleqëroi punën dhe tha me vete: *"Kur të vishet me terr qyteti, do të dal të jap sadaka, që të mos më njohë kush veç Zotit tim, se kështu ruhëm nga syefaqsia*

dhe kam shpërblim më të madh!" Mbushi një qese me dinarë dhe mori rrugicat e qytetit. Me të vënë re një njeri që ecte me ngut në krahun tjetër të rrugicës, iu afrua me një frymë, i zgjati dorën papritmas, i hodhi qesen, ktheu kokën dhe u largua vetëtimthi. Mirëpo, ç'ndodhi të nesërmen se? U hap fjala se, një natë më parë, dikush i kish dhënë sadaka të majme një hajduti. Kur i ra në vesh lajmi, burrin e mbështolli një hije trishtimi, por s'hoqi dorë nga puna e mirë. "O Allah!" tha me vete, "Ty të takon lavdia. Unë do jap përsëri sadaka sonte." Priti miku deri sa u la hëna në argjend. Me të rënë terri, doli fshehurazi rrugicave kur ja, diku atje larg vuri re një grua të mbështetur në avllinë e një shtëpie. Iu afrua me një frymë, i zgjati dorën papritmas, i hodhi qesen, ktheu kokën dhe u largua vetëtimthi. Mirëpo, ç'ndodhi të nesërmen se? U hap fjala se, një natë më parë, dikush i kish dhënë sadaka të majme një të përdale. Kur i ra në vesh lajmi, burrin e kaploi mërzia, mirëpo s'hoqi dorë nga sadakaja. Sapo trokiti në derë nata e tretë dhe terri mbuloi qytetin, doli burri përsëri rrugicave... Ec e ec i kapi syri një madhosh tek ecte qetë-qetë. Kështu, e shpejtoi hapin, e mbërriti, ia zgjati qesen, ktheu kokën dhe u largua, derisa e përpiu errësira. Priste miku me padurim të nesërmen të merrte vesh ndonjë të re, kur ja! Fjala se një i pasaniku i kishin dhuruar një qese përplot dinarë, kish marrë dhenë. "O Allah! – tha burri me vete, – Ty të takon lavdia. Jam i kënaqur me caktimin Tënd për mua, o Zot."

Atë natë burrin e mundi gjumi dhe ra në ëndërr, e çfarë ëndrre se? Një melek e përgëzoi se sadakaja i ishte pranuar nga i Madhi Zot. "O njeri i mirë!" iu tha, "Hajduti që i dhe sadaka, ndoshta nuk do të vjedhë më. E përdala ndoshta do t'i largohet turpit, kurse pasaniku ndoshta do i vërë gishtin kokës e do u japë të varfëve siç i dhe ti atij."

Biri im! Allahu i Lartmadhërishëm i shpërblen punët me nijetin e mirë dhe gabimet e paqëllimta nuk e pakësojnë se-

vapin. Mandej, mos harro, se shumë njerëz u jepen punëve të liga, ngase i ngushton varfëria dhe shumë të tjerë nuk u japin skamnorëve, ngase u mungon shembulli i mirë. Kështu urtaku duhet të tregohet bamiresh ndaj gjynahqarit me shpresën se do largohet nga e keqja, por edhe me pasanikun me shpresën se do ta shtyjë nga e mira.

I verbri, qerosi dhe lebrozi

Na ishin tre shokë nga beni israilët: njëri i verbër, tjetri qeros, ndërsa i treti lebroz. Jetonin në mesin e popullit të tyre, por askush nuk i qaste dhe nuk u ecte fjala. Kështu Allahu i Lartmadhërishëm u dërgoi një melek me pamje njeriu, me fytyrë që i shkëlqente nur dhe me rroba më të bardha se bora e maleve. I doli në shteg lebrozit, i dha tungjatjetën dhe i tha:

– Mbye hapin, o njeri, se kam për të të thënë dy fjalë!

– Urdhëro, o i panjohur! – ia ktheu lebrozi me gjysmë zëri.

– A ke ndonjë dëshirë? – i tha përsëri meleku.

– Ah, do të doja të më largohej lebra e të kisha lëkurë të shëndetshme, me ngjyrë tërheqëse, e të mos neveriteshin njerëzia nga unë! – ia ktheu.

Pa e mbaruar mirë fjalën lebrozi, meleku ia preku lëkurën dhe sa hap e mbyll sytë ky u shërua. Burri sa s'fluturoi nga gëzimi. Sikur të mos mjaftonte kjo, meleku iu drejtua përsëri:

– Po pasuri, gjë të gjallë, çfarë të do zemra?

– Devetë! – ia ktheu burri shend e verë.

Një përplasje qepallash dhe ja... deveja përpara. E ç'deve se! E bukur, madhoshe, madje edhe mbarsë.

– Paç bereqet e t'u shtofshin devetë, o njeri! – i tha meleku dhe u largua.

I doli në shteg meleku qerosit. I dha tungjatjetën dhe i tha:

- *Mbaje hapin, o njeri, se kam për të të thënë dy fjalë!*
- *Urdhëro, o i panjohur!* - ia ktheu qerosi me gjysmë zëri.
- *A ke ndonjë dëshirë?* - i tha meleku.

- *A nuk më sheh si jam? Do të doja të shërohesha, të kisha flokë e mjekër të dendur e të bukur, e të mos neveriteshin njerëzia nga unë!* - ia ktheu.

Pa e mbaruar mirë fjalën qerosi, meleku ia preku kokën dhe sa hap e mbyll sytë burri u shërua. Koka iu mbush me flokë, kurse mjekra vù. Burri sa s'fluturoi nga gëzimi. Sikur të mos mjaftonte kjo, meleku iu drejtua përsëri:

- *Po pasuri, gjë të gjallë, çfarë të do zemra?*
- *Lopët!* - ia ktheu burri shend e verë.

Një përplasje qepallash dhe ja... lopa përpara. E ç'lopë se! E bukur, madhoshe, madje edhe mbarsë.

- *Paç bereqet e t'u shtofshin lopët, o njeri!* - i tha meleku dhe u largua.

I doli në shteg meleku të verbrit. I dha tungjatjetën dhe i tha:

- *Mbaje hapin, o njeri, se kam për të të thënë dy fjalë!*
- *Urdhëro, e fol!* - ia ktheu i verbri butë e butë.
- *A ke ndonjë dëshirë?* - i tha meleku.

- *Do të ëndërroja që të ma kthente Allahu shikimin e të mund të shihja njerëzinë!* - ia ktheu i verbëri.

Pa e mbaruar mirë fjalën, meleku ia preku fytyrën dhe sa hap e mbyll sytë burri u shërua. Sikur të ishte në ëndërr, burrit iu ndez drita e syve e filloi të shihte. I qeshi fytyra të shkretit dhe iu bë zemra mal. Sikur të mos mjaftonte kjo, meleku iu drejtua përsëri:

– *Po pasuri, gjë të gjallë, çfarë të do zemra, fol?*

– *Delet!* – ia ktheu burri me gaz.

Një përplasje qepallash dhe ja... delja përpara. E ç'leve sel!
E bukur, më e bardhë se qumështi, madje edhe mbarsë.

– *Paç bereqet e t'u shtofshin delet, o njeri!* – i tha meleku dhe u largua.

Lutja e melekut u pranua. Kaluan vitet dhe e mira nuk iu nda tre shokëve. Bereqet i madh, gumëzhinte gjëja e gjallë, si zgjoi i bletës, një luginë me deve për njërin, një luginë me lopë për tjetrin dhe një luginë me dele për të tretin.

Mirëpo ç'u ndodhi burrave? Mbas pak kohësh i erdhi përsëri meleku atij që kish qenë lebroz. Ama, jo me pamjen e dikurshme, por si rreckaman e i sëmurë me lebër, teksa ky po sodiste devetë. Iu afrua dalëngadalë dhe i tha me gjysmë zëri:

– *O njeri, më ka zënë halli. Më janë mbaruar rezervat e kam udhë të gjatë. E kam të pamundur rrugëtimin veç në mëndihmoftë Allahu, mandej ti. Të lutem në emrin e Atij që të ka falur këtë lëkurë kaq të bukur të ma japësh një deve e të mbërrij atje ku jam nisur!*

– *Ehhh!* – psherëtiu burri, duke perënduar sytë, – *Kam detyrime të shumta more udhëtar, nuk mundem!*

– *Ti më dukesh si fytyrë e parë,* – iu drejtua i panjohuri,
– *më duket se dikur ishe lebroz, i neveritshëm, madje edhe varfanjak, por Allahu të pasuroi!*

– *Jo more mik!* – ia ktheu burri, duke i kthyer shpinën me mendjemadhësi, – *Gjithsa sheh e kam trashëguar brez pas brezi.*

– *Në qofsh gënjeshtar, të ktheftë Allahu siç ishe dikur, pra!*
– i tha i panjohuri.

Nuk kaloi shumë dhe i erdhi meleku atij që kish qenë qe-

ros. Ama, jo me pamjen e dikurshme, por si qeros i rreckosur, teksa burri po sodiste lopët. Iu afrua dalëngadalë dhe i tha me gjysmë zëri:

– O njeri, më ka zënë halli. Më janë mbaruar rezervat e kam udhë të gjatë. E kam të pamundur rrugëtimin veç në më ndihmoftë Allahu, mandej ti. Të lutem në emrin e Atij që të ka falur këto flokë të mahnitshëm të ma japësh një lopë e të mbërrij atje ku jam nisur!

– Ehhh! – foli si ndër hundë pasaniku. – Kam detyrime të shumta more udhëtar, nuk mundem!

– Shiko, shiko! Po unë të njoh ty. – iu drejtua i panjohuri.
– Më duket se dikur ishe qeros, i neveritshëm, madje edhe varfanjak, por Allahu të pasuroi!

– Jo more mik! – ia ktheu pasaniku, duke i kthyer shpinën me mendjemadhësi. – Gjithsa sheh e kam trashëguar brez pas brezi.

– Në qofsh gënjeshtar, të ktheftë Allahu siç ishe dikur, pra!
– i tha i panjohuri.

Nuk vonoi dhe i erdhi meleku atij që kish qenë i verbër. Ama, jo me pamjen e dikurshme, por si një varfanjak i rreckosur, teksa burri po sodiste delet. Iu afrua dalëngadalë, duke fërkuar dheun me bastun, gjoja se nuk shihte mirë dhe i tha me gjysmë zëri:

– O njeri, më ka zënë halli. Më janë mbaruar rezervat e kam udhë të gjatë. E kam të pamundur rrugëtimin, veç në më ndihmoftë Allahu, mandej ti. Të lutem në emrin e Atij që të ka falur dritën e syve të ma japësh një dele e të mbërrij atje ku jam nisur!

Bariu i deleve e kishte derën e zemrës të hapur për këdo, ndaj e priti me fjalë të mirë.

– Oh more lum miku! – i tha të panjohurit. – Ta dish ti, se dikur isha i verbër, më qe shuar drita e syve, por Allahu ma ndezi prapë. Dikur isha i varfër, por i Madhi Zot më pasuroi.

E pushtoi udhëtarin për krahu dhe filloi të ecte bashkë me të, mes për mes kopesë.

– Tash, – i tha burri me buzën në gaz, – merr sa të të dojë e bardha zemër, se unë as do ta përmend atë që ma kërkove në emër të Allahut!

Papritmas të panjohurit iu ndez drita e syve. I hodhi një vështrim bariut dhe i tha:

– Mbaje gjithsa ke, more bari. Unë jam melek. S’kam nevojë për dele dhe as më lodh udhëtimi, por Allahu më dërgoi të të sprovovj ty dhe shokët e tu.

Bariu mbeti i shtangur në vend.

– Përgëzohu, o bari bujar, e mos ki frikë! – i tha meleku.
– U kënaq Allahu nga bujaria jote dhe u hidhërua me shokët e tu.

Foshnjat e Beni Israilëve

Biri im! Të kam treguar, se nuk ka popull që kanë dëshmuar mrekulli më shumë se beni israilët. Allahu u shfaq mrekulli të lloj-llojshme, që të përkujtonin fuqinë e të Madhit Zot dhe t'i përudheshin rrugës së besimit, por shumica prej tyre ia kthyen shpinën përkujtimit.

Ndër mrekullitë që Allahu i Lartësuar ua mundësoi t'i shihnin me sytë e tyre ishte e folura e foshnjave. Fëmijët e djepit, jo vetëm flisnin urti, por rrëfenin lajme të fshehta që shushatnin mendjet e të pranishmëve. I Madhi Zot disa herë i thyente ligjet e zakonshme të vendosura në Gjithësi, për të ruajtur të paprekur nderin e robërve të Tij të dalluar.

Dëgjo se ç'na rrëfen Profeti, alejhis-selam: Na ishte një burrë nga beni israilët me emrin Xhurejxh. I përkushtohej Allahut me adhurime në një faltore të vogël. Një ditë prej ditësh nënën e tij e merr malli për të birin dhe shkon tek faltorja. Ndërkohë ai po falte namaz në katin e dytë të faltores. Vuri dorën si strehë mbi ballë plaka, ngriti pak kokën dhe filloi ta thërrasë nga jashtë:

– O Xhurejxh, o Xhurejxh! Nëna jam, o bir, përgjigjimu! – Xhurejxhi e dëgjoi, por ishte duke u falur.

– O Zot! – tha me vete. – Namazi apo nëna?

Kështu vazhdoi namazin derisa e ëma u largua. Të nesërmen, nëna përsëri shkoi ta takonte, por ai prapë duke u falur.

– O Xhurejxh! – e thirri. – O Xhurejxh, nëna jam. Përgjigjmu, o bir!

– O Zot! – tha me vete Xhurejxhi, – Namazi apo nëna?

Kështu vazhdoi namazin derisa e ëma iku edhe ditën e dytë.

Përsëri të nesërmen plaka shkoi ta takonte të birin, por ai po falte namaz.

– O Xhurejxh! – e thirri. – O Xhurejxh, nëna jam. Përgjigjmu, o bir!

– O Zot! – tha me vete Xhurejxhi. – Namazi apo nëna?

Edhe këtë herë ai vazhdoi namazin, ama kjo e hidhëroi plakën. “O Allah!” filloi të lutej e ëma, “Xhurejxhi është im bir. Unë e thërras dhe ai nuk më përgjigjet, ndaj mos ia merr shpirtin derisa t’i shohë me sytë e tij surratin të përdalave!”

Nuk kaloi shumë dhe një ditë, teksa beni israilët flitnin për përkushtimin e Xhurejxhit, një e përdalë që bënte gisht për bukurinë e saj, u tha: “Nëse dëshironi, unë mund ta sprovaj Xhurejxhin!” “Dëshirojmë ta sprovosh!”, thanë njëzëri. Kështu gruaja pranoi dhe shkoi drejt e tek Xhurejxhi. Mirëpo ai u largua dhe as që ia hodhi sytë. Atëherë ajo iu fur një çobani që strehohej tek faltorja e Xhurejxhit dhe e joshi për paturpësi. Ai ra në gjynah dhe ajo mbeti e rëndë. Kaluan muajt dhe gruaja lindi. Një ditë të bukur, e mori foshnjën në krah dhe shkoi në kuvendin e beni israilëve. Tek pleqëronin hallet, gruaja u hyri në mes dhe u tha: “Ja pra ku e keni foshnjën e Xhurejxhit!” Morën flakë beni israilët. U ngritën nga ndenja dhe u nisën tok drejt faltores së Xhurejxhit, me sopata e lopata ndër duar. Ai si zakonisht po falej në katin e dytë, ndaj këta e thirrën: “O Xhurejxh! O dyftytrësh! Zbrit poshtë, zbrit!” Ai nuk ua vuri veshin dhe vazhdoi adhurimin, por ata filluan të goditnin muret e faltores me sëpata. Kështu Xhurejxhi zbriti të kuvendonte me

ta, mirëpo beni israilët, sapo iu afrua, ia hodhën litarin në qafë. Ia shembën faltoren dhe e tërhoqën të lidhur përmes turmës duke e sharë dhe duke e goditur si mos më keq.

– *Ç'keni me mua o njerëz?* – u tha Xhurejxhi, – *Pse po silleni kështu?*

– *Edhe hiqesh sikur nuk ditke asgjë zotrote ëëë?* –, ia kthyen me përtallje. Mandej u ndezën prush dhe i bërtitën me të madhe:

– *Ke rënë në zina me këtë grua të përdalë, madje paske edhe një djalë me të... Ndërkohë që hiqesh si burrë i mirë.* – Për çudi, Xhurejxhit i qeshi fytyra, mandej u tha:

– *Ku është djali? Ma sillni ta shoh!*

Bir i dashur! Thonë të moçmit se gjuha dhe zemra qenkan të lidhura fort njëra me tjetrën. Kështu, kur njeriu është i pafajshëm, zemrën e ka të qetë dhe gjuha nuk i dridhet, ndërsa kur është fajtor, zemra i tutet dhe gjuha i dridhet e belbëzon gënjeshtër. Ndaj edhe Xhurejxhi nuk e humbi toruan, por u mbështet në Allah dhe i qeshi buza se ishte i pafajshëm e s'kish pse të frikësohej.

Kur ia sollën djalin përpara duarve, Xhurejxhi u tha beni israilëve: *"Më lini të falem!"* Ata e lanë. Kështu ai mori abdes, u fal dhe filloi të lusë Allahun Fuqplotë. Pastaj iu kthye foshnjës, ia fërkoj kokën dhe e thumboi me gisht në bark, mandej i tha:

– *Pash Allahun, more djalë, kush është babai yt?* – Për çudi foshnja filloi të fliste, gjë që nuk ish parë ndonjëherë.

– *Babai im është çobani i deleve.*

Turma e njerëzve fërkuan sytë të shastisur. Iu kthyen Xhurejxhit të mrekulluar, duke e puthur e duke i kërkuar falje.

– *Na fal, o njeri i mirë!* – i thanë. – *Na fal e na thuaj, si ta do zemra faltoren që ta shembëm? Prej ari apo argjendi?*

– Nuk kam nevojë për një faltore të tillë. – ia ktheu Xhurejxhi me fjalë të butë, – Ma ndërtoni me baltë, ashtu si ishte!

Kështu kaluan motet e Xhurejxhi adhuroi Allahun në faltore deri sa pati frymë.

Biri im! Meqë po flasim për foshnjat, e shoh të udhës të të rrëfej edhe për një tjetër foshnje gjiri që i foli të ëmës, krejt si Isai, alejhis-selam.

Teksa një foshnje e beni israilëve pinte gji nga e ëma, kaloi pranë tyre një kalorës kryelartë, i veshur e stolisur si mos më mirë, mbi një hamshor që shpejtonte si shigjeta. Nëna u mahnit nga kalorësi, ndaj e luti të Madhin Zot duke thënë: *“O Allah! Bëje djalin tim, kur të rrisë shtatin, si ky kalorës!”* Për çudi foshnja e la gjirin, ktheu shikimin e brishtë nga kalorësi dhe foli: *“O Allah, mos më bëj kurrë si ai!”*. Nëna u shtang në vend. Foshnje që flet, kjo nuk bënte vaki. Megjithatë foshnja u kthye edhe një herë nga e ëma dhe filloi të thithte gjirin, kështu gruaja nuk e bëri të madhe. Pas pak kaluan pranë nënës një grup njerëzish, që tërhiqnin me forcë dhe e goditnin një robërëshë abisinase. Duke e goditur, i bërtisnin: *“E përdalë! Hajdute!”*. Ajo thoshte: *“Më mjafton Allahu, Ai është Kujdestari më i mirë!”*, asgjë më shumë. Kur e pa këtë skenë, nëna iu drejtua përsëri të Madhit Zot me lutje: *“O Allah! Mos e bëj kurrë tim bir si kjo grua!”*. Fëmija e la gjirin, ia hodhi vështrimin skllaves dhe foli për të dytën herë: *“O Allah! Më bëj si ajo kur të rritem!”* E shastisur, nëna iu kthye foshnjës: *“M’u thaftë goja more bir! Iu luta Allahut të të bënte si kalorësi i hijshëm, ndërsa ti iu lute të kundërtën. Mandej iu luta Allahut mos të të bënte si robërëshë që e shanin njerëzia, kur ti prapë u lute të kundërtën.”* Atëherë Allahu e bëri të flasë për së treti. *“O nënoka!, – tha foshnja si të ishte plak i urtë, – Kalorësi me veshjen e stolisur ishte tiran, mendjemadh. Kështu ti u lute që Allahu të më bënte prej banorëve të zjarrit, prandaj unë të kundërshtova. Kurse skllavja që po e goditnin dhe e qortonin për zina dhe hajni,*

tekta ajo i drejtohej Allahut, ishte e pafajshme, prandaj e luta Allahun të më bënte si ajo."

Bir im! Kjo foshnje na mëson që të mos nxitohemi kur vlerësojmë të tjerët. Nga pamja e jashtme shumë njerëz mund të na duken të mirë e në fakt s'janë të tillë. Ndoshta të tjerë na duken të ligj e mund të jenë bimirës të pashok. Ndaj, tregohu i matur e mos jep gjykime për të tjerët pa i njohur mirë, si thotë populli: nuk njihet njerëzia, vetëm pasi të kesh ngrënë një thes kripë me ta!

Kulaçi

Na ishte dikur një murg, i thyer në moshë, por i fortë dhe i mbajtur si djalë i ri. Ditët dhe netët i kalonte në adhurim, tek një faltore në kodrat larg qytetit. Thuhet se jetonte larg njerëzisë, larg të mirave dhe saltaneteve që prej 70 vitesh. Shumë rrallë zbriste në qytet, sa për të takuar të afërmit apo për të marrë pak ushqim. Mirëpo njëherë, teksa dielli po falej mbi male, murgu ra në qytet. Ec e ec i ranë sytë mbi një grua syzezë që ia përvëloi zemrën. Qepallat e gjata që i rrihte si flatra fluturë ia morën mendtë murgut, i cili iu qep pas dhe filloi të fliste me të. Fjala sjell fjalën dhe ja, rrëshqiti burri në zina. Jo një natë, por shtatë rresht.

Mbas një jave u kthjellua murgu dhe iu zhदारarit mjegulla me të cilën ia kish mbuluar shejtani sytë. U pendua e ra me fytyrë në sexhde. U ngrit dhe iku. Po për ku se? As vetë nuk e dinte. Për çdo hap që hidhte bënte një sexhde, mirëpo brenga nuk i tretej. Ec e ec e zuri nata bri një shpelle në trupin e një kodre të vjetër, në të dalë të qytetit. Hyri brenda dhe gjeti një grup fukarenjsh, të lodhur e të rraskapitur, të cilët as nuk pyetën kush hyri. Secili për hesap të vet strukej në cepat e shpellës. Murgu hyri thellë duke mos bërë zë dhe duke mos trazuar askënd. I numëroi me sy gjithsa ishin në shpellë dhe i dolën plot njëmbëdhjetë hallexhinj. Zuri një qoshk, lidhi duart pas kokës si jastëk dhe u shtri, por gjumi nuk e zinte.

Kur ra nata e thellë, papritmas hyri në shpellë një burrë me disa kuleçë të sapobërë. Ishte një plak që u sillte natë për natë

ushqim hallexhinjve që strehoheshin aty. “Ngrihuni burra, se erdhën kuleçtë, të butë pambuk!” ushtoi zëri i tij, teksa i vendosi stivë në mes të shpellës. Mirëpo papritmas briti njëri:

– Ku është kulaçi im, o njeri i mirë?”

– Njëmbëdhjetë kuleçë për njëmbëdhjetë burra solla, por mos ka marrë ndokush dy! – ia ktheu plaku. Me të vërtetë ashtu ishte; murgu e kish marrë kulaçin se i qe bërë barku një me shpinën. Ama, kur dëgjoi hallexhiun, iu dhembës dhe ia hodhi kulaçin të paprekur.

Thuhet se murgu ra e vdiq po atë natë. Kështu iu peshuan murgut punët në mbretërinë e qiejve. Shtatë net zina vinin më rëndë në peshore se shtatëdhjetë vite adhurim, e për pak përfundoi në dënimin e zjarrit. Mirëpo kur u vendos në peshore bujaria me hallexhiun, rënduan të mirat dhe shpëtoi murgu për një kulaç.

Mos nënvlerëso nga punët e mira asgjë pra, more bir! Thuaje fjalën e mirë, zgjatja dorën skamnorit, largoje gurin, gastaret e pengesën nga rruga, me nijet të mirë se ku i dihet! Një punë e vogël që as mendja s’ta pret, të shpëton prej dënimit të madh në Ahiret.

Pasaniku bujar

Bir i dashur! Feja e jonë na nxit të jemi bujarë me skamnorin dhe të mëshirshëm me hallexhiun, se ç'të mbjellësh në dynja do të korrësh në Ahiret... Bujaria me bujari dhe mëshira me mëshirë.

Dëgjo se ç'na rrëfen Profeti, alejhis-selam: "Na ishte dikur një pasanik bujar. Nevojtarin e mirëpriste dhe hallexhiun e ndihmonte. Sa herë që i kërkonin borxhe ua jepte e nuk kursehej. Madje kur plotësohej afati e dërgonte shërbëtorët e tij për të marrë borxhet, e kishte zakon t'u thoshte: *"Mos i rëndoni borxhlinjtë e mi! Nëse nuk kanë mundësi t'na e kthejnë borxhin shtyjani për më vonë, e nëse i kanë mbuluar hallet, faljani me shpresën që edhe Allahu të na e falë ne!"*

Si të gjithë bijtë e Ademit edhe pasaniku ndërroi jetë, ama në Ditën e Gjykimit Allahu nuk ia harron të mirën. Kështu, kur të sillet para Lartmadhërisë së Tij për të dhënë llogari, do t'i thuhet: *"Çfarë bërë me pasurinë që t'u dha në dynja?"*

– O Allah, o Zoti im! – do përgjigjet bujari – *Ti më dhurove pasuri të madhe dhe unë u jepja borxhe nevojtarëve. Kur nuk kishin mundësi t'ma kthenin borxhin ua shtyja afatin, kurse hallexhinjve ua falja. Nuk i dhashë askujt për t'mu përmendur emri e për lëvdata, por vetëm me shpresën që t'më falësh Ti, o Zot!*

– *Atëherë të kam falur o njeri i mirë!* - do t'i përgjigjet Allahu i Lartmadhërishëm. Kështu do t'i jepet libri nga e djathta e do të bëhet prej banorëve të Xhenetit, në tokën e të cilit do të jetojë përgjithmonë. ”

Musai dhe shkëmbi

Bir i dashur mos të të mashtrojë bota e të mendosh se zhveshja e trupit është përparim dhe zhvillim! Sado që të përhapet zhveshja kurrë mos harro se lakuriqësia ka qenë dhe është kurth i shejtanit, kurse mbulesa e trupit ka qenë dhe do jetë vlerë dhe virtyt i lartë.

Benu israilët e mundonin shumë Musain, alejhis-selam. Ata ishin një popull i pabindur dhe keqbërës. E dinin se Musai është i Dërguari i Allahut megjithatë e lëndonin. Profeti Muhamed, alejhis-selam, ka treguar se burrat e këtij populli laheshin lakuriq, nuk kishin turp, dhe shihnin aurretet e njëri-tjetrit. Ndërsa Musai, alejhis-selam, ishte shumë i turpshëm, ndaj nuk lahej së bashku me ta. Një gjë e tillë i dukej e pahijshme dhe nuk donte të cënonte moralin e tij. Kështu, të prishurit nga mesi i popullit, filluan të përhapnin thashetheme për të. *"Ai e mbulon trupin për shkak të lebrës apo hernies që ka, kurse ne na hiqet si i turpshëm."*, shpifnin për të.

Kur i ranë në vesh këto shpifje Musait e lënduan shumë, por ai duroi dhe nuk e dha veten. Mirëpo Allahu i Lartmadhërishëm dëshiroi ta pastronte të Dërguarin e Tij nga kjo shpifje, ndaj një ditë Musai, alejhis-selam, shkoi të lahej. Ashtu si e kish zakon, u tërhoq pas një kaçubeje të ngarkuar me gjethe, zhveshi rrobat dhe i vendoi në kurrizin e një shkëmbi të dalë mbi ujë, krejt afër bregut. Mbasi u la e u freskua, u kthye nga shkëmbi për të marrë rrobat e për t'u veshur, por shkëmbi filloi të largohej bashkë me rroba. Musai i briti, por shkëmbi nuk u bind. Duke

menduar se nuk do e shihte askush, i Dërguari i Allahut mori bastunin e iu vu pas, ashtu i zhveshur. Hijen e kishte të rëndë plumb, sytë e ndezur flakë nga inati, trupin të lidhur me muskuj e pa kurrfarë të mete, gjoksin e gjerë, flokët me onde dhe mjekrën e dendur. Me të kaluar kaçuben shkëmbi u ndal, po ç'e do! Jo larg tij, po laheshin disa israilitë, të cilët e panë të zhveshur. Musai nuk i kishte vënë re, megjithatë u vesh shpejt e shpejt dhe filloi ta godiste shkëmbin me inat, duke mos e ditur se ky shkëmb e kishte pastruar nga ajo që shpifnin për trupin e tij. *"Betohem në Allah",* ka thënë Profeti Muhamed, alejhis-selam, *"se shkëmbi i mban akoma mbi shpinë shenjat e goditjes: tre, katër apo pesë vraga!"*

Frika prej Allahut

Bir im! Ruaju gjynaheve kur të përzihesh me njerëz dhe kur të jesh në vetmi se Allahu të vështron dhe melekët shkruajnë! Dije se kush i druhet Allahut në dynja, i Madhi Zot e shpëton dhe i fal siguri në Ahiret. Por kush ndihet i sigurtë, e nuk do t'ia dijë për Allahun në dynja, i Madhi Zot e tmerron dhe e dënon në Ahiret.

Profeti, alejhis-selam, na rrëfen se: "Kur një burri, që i ishte dhuruar pasuri e madhe dhe evladë të shumtë në dynja, iu afrua vdekja i mblodhi fëmijët e tij tek koka.

– *O bijt e mi!* – u foli baba, e zëri i dridhej nga grahmat e vdekjes – *Çfarë babe kam qenë për ju, a s'ma thoni?*

– *Veç mirë mbajmë në mend prej teje, o babë!* – ia kthyen njëzëri për t'i dhënë plakut gajret.

– *O bijt e mi!* – u foli plaku me shpirt ndër dhëmbë – *Nuk kam qenë si mendoni ju, jo. Ndaj po jua lë amanet, që kur të vdes të ma digjni trupin derisa të bëhem hi. Mandej kur të fryjë erë e egër dilni në breg të detit, hidheni hirin tim në gjirin e sqj, që ta marrë me vete e ta shpërndajë nëpër tokë e det, sepse po u ringjalla kam frikë se do më dënojë Allahu si askënd në botë!*

– *Betohuni në Allah, se do ma çoni amanetin në vend!* – u tha plakui, e zëri sa vinte e i mbytej.

– *Betohemi, o babë!* – ia kthyen bijtë.

Burrit iu ngrohën sytë e dy sumbulla loti iu varën në cepa të qepallave. U hodhi shikimin e fundit djemve, mandej i mbylli sytë për të mos i hapur më.

Pejgamberi, alejhis-selam, na ka treguar se në ditën e Kijametit, kur njerëzia të dalin nga varret për të dhënë llogari, Allahu Fuqiplotë do të urdhërojë grimcat të bashkohen e do krijohet ky burrë ashtu si ishte në dynja. Do mirret nga mesi i njerëzve dhe do sillet për të dhënë llogari.

– *Pse urdhërove të ta djegin trupin, o njeri?* – do ta pyes i Madhi Zot.

– *Pata frikë të madhe prej këtij takimi, o Zot!* – do përgjigjet burri me kokën ulur.

Kur Allahu dëgjon fjalët e burrit do t'ia fali dhe do ta mëshirojë me mëshirën e Tij të pakufishme. Kështu, burri do të shpëtojë nga dënimi i Ditës së Madhe, do bashkohet me turmën e mirëpunuesve, e do lumturohet për jetë të jetëve.

Pendimi

Na ishte një burrë nga beni israilët që i kish marrë jeta për keq dhe kishte vrarë 99 veta. Hijen e kishte më të rëndë se plumbi, shokët më të ligj se ujku, por zemrën s'e kish të keqe. Kaluan motet dhe brenga e vrasjes ia pushtoi zemrën burrit. I vinin ndër mend fytyrat e të vrarëve dhe ia helmonin shpirtin. Mendonte për dënimin që e priste në Ahiret: zjarri i madh që të djeg e nuk të tretë. Iu frikësua zemra kaq shumë, saqë mori rrugën e pendimit. Pyeti njerëzinë se ku mund të gjente një njeri të urtë e të qante hallët e zemrës, kështu e lajmëruan për një murg asket, që jetonte diku në cep të qytetit.

Mirëpo ç'ndodhi? Sapo mbërriti te murgu i dha tungjatjeta me fjalë të mirë dhe ia tregoi brengën që ia rëndonte gjoks. Murgu e dëgjoi në heshtje, pa bërë zë. Mbasi ia tregoi hallin hollë e hollë, burri iu drejtua e i tha:

– *A thua më pranohet pendimi për gjithçka që kam bërë, o murg?*

– *Përderisa ke vrarë 99 veta, mos prit të të pranohet pendimi, – ia ktheu murgu, i vrerosur.*

I hipën kacabunjtë burrit dhe e humbi toruan. Pa një pa dy nxori shpatën dhe e vrau murgun. I hipi kalit, edhe një herë drejt e në qytet. Kaluan ditët, por nuk gjente prehje zemra e tij. Pyeti edhe një herë njerëzinë se ku mund të gjente një burrë të urtë e të qante hallin e zemrës, kështu e lajmëruan për një dijetar të thinjur mbi libra. Nuk vonoi trimi dhe trokiti në derë

të dijetarit. Burri i dha tungjatjeta me të egër e plaku ia ktheu me të butë. Jo se kish frikë, por e kish zemrën e madhe.

– *Urdhëro e mirë se të solli Zoti, o hallexhi!* – iu drejtua plaku.

– *Mirë se të gjej, o plak urtak!* – ia priti burri.

– *Ç’e mirë të solli tek unë, o njeri?* – e pyeti dijetari.

Filloi trimi të qante hallet fill e për pe. Plaku e njihte fjalën që del nga zemra, ndaj ia dëgjoi hallin. Mbasi e mbaroi rrëfimin, burri i hodhi plakut një shikim të ashpër, mandej e pyeti:

– *A thua më pranohet pendimi për gjithsa kam bërë, o plak?*

– *E si nuk t’u pranoka pendimi, o njeri?! – ia ktheu plaku me të butë. – Po a nuk e di ti, se dyert e pendimit janë kurdoherë të hapura e nuk mbyllen kurrë?! –*

Burrit iu ngroh zemra dhe një rreze shprese ia përndriti fytyrën.

– *Ama, largohu nga ky qytet dhe nga shokët e ligj!* – i tha plaku, – *Shko tek filan qytet, sepse atje ka njerëz të mirë që e adhurojnë Allahun. Shoqërohu me ta, se do të të bëhen krah! Adhuroje të Madhin Zot atje e mos u kthe nga këto anë!*

U pushtuan trimi e plaku gjoks më gjoks dhe u ndanë për mirë. O burra, i hipi kalit trimi dhe kali u bë furtunë, se rruga ishte e gjatë. Iku nga sytë këmbët e as nuk e ktheu kokën pas të shikonte vendin ku kish lindur e ish rritur, se i kujtohej e kaluara. Mirëpo gjatë rrugës i erdhi exheli. Meleku i vdekjes e ia mori shpirtin papritur e pa menduar. Sakaq zbritën melekët e mëshirës radhë-radhë e iu afruan melekut të vdekjes. Pak pa e marrë shpirtin e trimit në krahët e tyre zbritën melekët e dënimit dhe u thanë prerazi:

– *Mos e prekni shpirtin e tij, se do e marrim ne, ai nuk ka bërë kurrë punë të hairit!*

*- Po ai është penduar: - iu drejtuan melekët e mëshirës, -
Ai u nis në kërkim të faljes së Gjithëmëshirshmit.*

Teksa debatonin shoqi me shoqin, Allahu i Lartësuar u dërgoi dy grupeve një melek me pamjen e njeriut, i njohur për gjykim të drejtë. Kështu të dyja palët ranë dakord ta linin gjykimin në dorën e tij.

*- Të matet largësia mes qytetit të keq dhe qytetit të mirë!
- urdhëroi gjykatësi. - Mandej të shihet se me cilin vend është
më afër shpirti i tij! Nëse është afër qytetit të mirë, e mira do ta
qiejë dhe nëse është më afër qytetit të keq, e keqja e pret!*

Atëherë Allahu i Lartësuar e urdhëroi tokën e qytetit të mirë të afrohej, ndërsa trojet e këqija i urdhëroi të largoheshin. Prandaj kur e matën rrugën, zbuluan se shpirti i trimit ishte një pëllëmbë më afër qytetit të mirë. Kështu melekët e mëshirës e morën shpirtin e tij me gaz të madh dhe fluturuan bashkë me të drejt mbretërisë së qiejve.

Bir i dashur! Kurrë mos harro, se njeriu që pendohet për gjynahet e tij dhe i përgjërohet të Madhit Zot t'ia falë, Ai ia fal sado të mëdha qofshin. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Pejgamberit, alejhis-selam, se Allahu i Madhëruar ka thënë: *"O bir i Ademit, përderisa ti më lutesh dhe shpreson tek Unë, t'i fal gabimet dhe s'më bëhet vonë aspak. O bir i Ademit, sikur gjynahet e tua të arrijnë lartësinë e qiellit, mandej ti më kërkon falje, Unë t'i fal. O bir i Ademit, nëse (Ditën e Gjykimit) vjen dhe më takon me gjynahe që peshojnë sa Toka, mirëpo askënd nuk ke adhuruar veç Meje, do të të takoj me po aq falje."*

Fund

Përmbajtja

Parathënie	5
Haruti dhe Maruti	8
Ringjallja	12
Uzejri	15
Dëshira e Ibrahimit	19
Dy bijtë e Ademit	22
Dita e shtunë	26
Banorët e shpellës	31
Dy komshinjtë	41
Dhulkarnejni	48
Porosia e Babës	57
Besimtari	61
Shpirti i njeriut	68
Pronarët e kopshtit	76
Gjykimi	79
Xhindët	85
Djali dhe mbreti	94
Elefanti	105

Tre shokët	112
Kopshtari zemërmirë dhe retë	119
1000 Dinarët	122
Qypi me florinj	125
Shitësi i verës.	128
Udhëtari dhe qeni.	131
Plaka e urtë	133
Porositë e Jahjas.	136
Shoku i mirë	139
Sadakaja e natës.	141
I verbri, qerosi dhe lebrozi	144
Foshnjat e Beni Israilëve	149
Kulaçi	154
Pasaniku bujar.	156
Musai dhe shkëmbi.	158
Frika prej Allahut	160
Pendimi.	162
Fund	164